

**RAPORT I MONITORIMIT TË  
ZBATIMIT TË BUXHETIT 12-MUJORI I VITIT 2019  
BASHKIA SHKODER**

*Shkurt 2020*

## Përmbajtja

### **REALIZIMI I BUXHETIT TË VITIT 2019 .....4**

#### **I. REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR VITIN 2019.....8**

#### **II. REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË VITIT 2019.....25**

Transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore	31
Transferta e pakushtezuar sektoriale	41
Transferta e kushtëzuar	45
Shpenzimet nga fondet e trashëguara	47
Detyrimet e prapambetura	48

#### **FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE .....51**

Programi 01110 - Planifikim, menaxhim dhe administrim	51
Programi 01170 - Gjendja Civile	74

#### **FUNKSIONI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE .....75**

Programi 03140 - Shërbimet Policore Vendore	75
Programi 03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	80

#### **FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE.....84**

Programi 04130 - Mbështetja për zhvillim ekonomik	84
Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	97
Programi 04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	100
Programi 04240: Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit	106
Programi 04260 - Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	110
Programi 04520 - Rrjeti rrugor rural	118
Programi 04570 - Transporti publik dhe lëvizshmëria	124
Programi 04760: Zhvillimi i Turizmit	128

#### **FUNKSIONI 5: MBROJTJA E MJEDISIT.....142**

Programi 05100 - Menaxhimi i mbetjeve	142
Programi 05200 - Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve	146
Programi 05320 – Programet e ndotjes së mjedisit	150
Programi 05630 - Ndërgjegjësimi Mjedisor	154

#### **FUNKSIONI 6: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT .....158**

Programi 06140 – Planifikimi Urban	158
Programi 06260 – Shërbime publike vendore	162
Programi 06330 - Furnizimi me ujë	167
Programi 06440 - Ndriçimi i rrugëve	171

#### **FUNKSIONI 7: SHËNDETËSIA .....174**

Programi 07220 - Shërbimet e kujdesit parësor 174

**FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA.....179**

Programi 08130: Sport dhe argëtim 179

Programi 08220 - Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore 189

**FUNKSIONI 9: ARSIMI.....205**

Programi 09120: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor 205

Programi 09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm 214

Programi 09240 - Arsimi Profesional 220

**FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE.....226**

Programi 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 226

Programi 10220 - Sigurimi shoqëror 233

Programi 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 236

Programi 10661 - Strehimi social 263

**MATRICA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2019, SIPAS PROGRAMEVE**

..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

## Realizimi i buxhetit të vitit 2019

Raporti i monitorimit të realizimit të buxhetit vjetor ka për qëllim të analizojë dhe vlerësojë punën e bërë në drejtim të arritjeve të vizionit dhe objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër për vitin 2019.

Bashkia Shkodër e ka të qartë vizionin e saj për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit, duke e kthyer Shkodrën në një qendër të përparuar social – ekonomike.

Në përmbushje të vizionit të strategjisë së zhvillimit, janë hartuar 5 objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Sa më sipër Bashkia Shkodër ka fokusuar përpjekjet e saj në drejtim të garantimit të barazisë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Jo pa qëllim objektivat e strategjisë së zhvillimit kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2020, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Secili program buxhetor është i lidhur me një grup aktivitetesh të matëshme, duke treguar qëllimin, aktorët përgjegjës, rezultatet e pritshme, treguesit dhe buxhetin përkatës.

Duke e konsideruar zbatimin e buxhetit vjetor si një proces të rëndësishëm, Bashkia Shkodër ka ngritur një sistem menaxhimi efikas për përdorimin e fondeve publike. Paisja e një sistemi të tillë kërkon transparencë, llogaridhënie, shërbesa me etikë dhe përgjegjshmëri, ndërhyrje me efikasitet, dhe qeverisje me pjesëmarrje. Këto mjete kanë shërbyer dhe do të vijojnë të shërbejnë si udhërrëfyes në punën tonë për përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligj dhe në akte nënligjore.

Procesi i ecursisë së arritjeve të objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër mbështetet në dy elemente kryesore:

- monitorimi i Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkisë Shkodër.
- monitorimi i realizimit të buxhetit vjetor.

*Monitorimi i Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkisë Shkodër* është një mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë.

Burimet kryesore të informacionit për mbledhjen e të dhënave zyrtare janë: informacioni i siguruar nga drejtoritë dhe drejtoritë e varësisë dhe raportimi i zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të vitit 2019 të Bashkisë Shkodër.

Monitorimi i zbatimit të projekteve u bë duke u mbështetur në një shkallë vlerësimi prej tre vlerash kryesore:

- E ulët - Programet që kanë më pak se 10% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi.
- E mesme - Programet që kanë nga 11% deri në 50% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi.
- E mirë - Programet që kanë mbi 51% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mirë zbatimi.

Për të adresuar 5 objektivat strategjike të planifikuara në këtë plan janë parashikuar 198 projekte.

Nga 198 projekte të monitoruara, të cilat kanë një afat zbatimi 2015-2030, konstatohet se:

- 65 % projekteve janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi, rreth 129 projekte;
- 28 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi, rreth 55 projekte;
- 7 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të lartë zbatimi, rreth 14 projekte.

Referuar një vlerësimi krahasimor të zbatueshmërisë së 5 objektiveve strategjike rezulton me ecuri të mesme zbatimi objektivi strategjik 2 Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses nga 11% deri në 50% të projekteve të zbatuara. Pjesa më e madhe e projekteve të parashikuara në matricën e projekteve strategjike janë projekte infrastrukture.

E njëjtën linjë është ndjekur edhe për *procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm 2019 -2021*. Gjatë 3 viteve në vazhdim, Bashkia Shkodër ka mundur ndarjen e të ardhurave dhe parashikimin e shpenzimeve mbi bazën e politikave zhvillimore dhe funksioneve të parashikuara me ligj.

Konkretisht për vitin 2019, synimi i punës sonë ka qënë mbulimi i të gjithë territorit me shërbime cilësore, ndër të tjera ven të pëmendet puna e bërë në drejtim të:

- Përmirësimit të ofrimit të shërbimit për qytetarët;

Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore ku qytetarët kanë mundësinë që të aplikojnë dhe përfitojnë shërbimin në çdo Njësi Administrative, lagje dhe Bashki qendër dhe përmes web-it. Numri i shërbimeve të ofruara nga zyrat me një ndalesë është 83 shërbime. Gjithashtu dy platforma janë integruar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe mund të aksesohen edhe në Mobile App, platforma e transparencës së buxhetit dhe Sistemit të Integruar të Tarifave dhe Taksave Vendore (SiTTV).

- Përmirësimit dhe modernizimit të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke mundur akses të plotë për të gjithë;

Shumë punë është bërë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale. Gjatë vitit 2019 janë bërë 91 ndërhyrje në ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore, me fonde të bashkisë.

- Përmirësimit të impaktit mjedisor nëpërmjet stimulimit të transportit publik dhe traditës së përdorimit të bicikletës;

Janë ndëmarrë disa nisma në drejtim të përdorimit të rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar një kulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik.

- Përmirësimit të infrastrukturës turistike dhe promovimit të territorit të Bashkisë Shkodër; Një vëmendje e veçantë i është kushtuar pritjes së turistëve dhe marketingut të ofertës turistike. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe botuar disa materiale promocionale dhe janë organizuar aktivitete të ndryshme për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.

- Promovimit të produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Janë ndërmarrë disa nisma në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

- Mbrojtjes së mjedisit, parandalimit të rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve; Punë është bërë në drejtim të përmirësimit të mjedisit dhe të përbërësve të tij, rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara dhe ndërgjegjësimit të banorëve për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

- Përmirësimit të menaxhimit të shërbimit të ndriçimit;

Garantimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe përmirësimi i ndriçimit të mjediseve publike. Për këtë vit është realizuar ndriçimi në 22 rrugë në qytet dhe fshatra. Janë zbatuar 3 projekte në ndricim rrugor/ pershtatur me ndricim LED për të kursyer energji elektrike.

- Projektimit, përmirësimit të kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirë administrimit të infrastrukturës së ndërtuar;

Punë është bërë në drejtim të krijimit të kushteve të përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, ristrukturimi i tyre dhe planifikimi e projektimi i ndërhyrjeve ka qënë prioritare për Bashkinë Shkodër. Bashkia e Shkodrës tashmë ka krijuar një database të qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje.

- Rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimit të sportit në komunitet; Organizim i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet ku të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni kanë garuar në mes tyre duke zhvilluar traditën.

- Ruajtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore;

Gjallërimi i jetës kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit. Për vitin 2019 numri i aktiviteteve kulturore të miratuar nga bashkia për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare është 35 aktivitete. Gjatë këtij viti janë mbështetur teknikisht mbi 50 projekte, te individëve apo subjekteve te ndryshme, te cilat kane patur ne fokus promovimin dhe zhvillimin e ketij sektori.

- Ofrimit të shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor;

Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

- Krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj.;

Për një mbulim sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit, janë ngritur 12 Qendra komunitare "Për familjen", të shpërndara në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Këto qendra ofrojnë shërbimeve të përditshme për fëmijët, të rinjtë, gratë, të moshuarit, komunitetin rom dhe egjiptian dhe personat me aftësi ndryshe. Për vitin 2019 numri i përfituesve të shërbimeve në qendra është 6500 persona.

- Forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti;

Një nga objektivat e Bashkisë Shkodër është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve shoqërore për shtresat në nevojë. Bashkia Shkodër ka aktive 16 marrëveshje bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile të cilat në fokus të punës së tyre kanë edhe trajtimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut. Gjithashtu nuk ka munguar bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit. Numri i granteve të dhëna nga Bashkia për projekte të përbashkëta në partneritet me organizatat e shoqërisë c ivile është 18.

- Përmirësimit të kushteve të banimit për shtresat në nevojë

Punë është bërë në drejtim të vlerësimit, planifikimit dhe sigurimit të kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë.

- Administrimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Sistemi i ujitjes dhe kullimit vazhdon të jetë prioriteti i Bashkisë Shkodër në fushën e bujqësisë. Mbështetur në Planin e Veprimit për ndërhyrje në sistemin kullues për vitin 2019 janë hartuar projektet teknike për 59 kanale kulluese dhe përfunduar ndërhyrja e pastrim/mirëmbajtje. Gjatësia totale e ndërhyrjes prej 122.5 km

- Parandalimit të kundërvajtjeve administrative, forcimit, inspektimit dhe monitorimit të zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe këshillit bashkiak.

Rezultatet e këtij raporti do të përdoren dhe publikohen nga Bashkia Shkodër për të marrë vendime dhe për të siguruar transparencë për publikun e gjerë.

Realizimi i buxhetit të vitit 2019 është bërë duke respektuar nenin 64 të ligjit 139/2015 “ *Per veteqeverisjen vendore* “, ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ; ligjit nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “ *Per financat e veteqeverisjes vendore* “, ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “*Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njesive të qeverisjes vendore*”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*”; udhëzimit plotësues nr. 1 datë 17.1.2019 “Per zbatimin e buxhetit të vitit 2019” i ndryshuar ; ligjin 99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe VKB nr.82 dt 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër” të ndryshuar .

Zbatimi i Programit Buxhetor Afatmesëm është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës, dhe mbrotjen e mjedisit duke e kthyer Shkodrën në një qendër të përparuar social – ekonomike.

**Bashkia Shkodër, administron dhe menaxhon fondet, sipas 30 programeve të miratuara, të listuara me poshtë:**

**Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE**

Programi - 01110: Planifikim menaxhim administrim

Programi - 01170: Gjendjacivile

**Funksioni 2 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE**

Programi - 03140: Sherbimet e policise vendore

Programi- 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile”

**Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE**

Programi-04130: Mbeshtetja për zhvillimin ekonomik

Programi - 04160: Sherbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Programi – 04220: Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit

Programi – 04240: Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit

Programi – 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Programi –04520: Rrjetirrugor rural

Programi –04570: Transporti public

Programi - 04760: Zhvillimi i turizmit

**Funksioni 5 MBROJTJA E MJEDISIT**

Programi –05100: Menaxhimi i mbetjeve

Programi –05200: Menaxhimi i Ujrave të zeza dhe kanalizimeve

Programi –05320: Programet e mbrojtjes së mjedisit

Programi –05630: Ndergjegjesimi mjedisor

**Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT**

Programi –06140: Planifikim urban vendor

Programi –06260: Sherbimet Publike vendore

Programi –06330: Furnizimi me ujë

**Programi –06440: Ndricim rruges**

**Funksioni 7 SHENDETESIA**

**Programi –07220: Sherbimet e kujdesitparesor**

**Funksioni 8ARGETIMI KULTURA DHE FEJA**

**Programi –08130: Sport dhe argetim**

**Programi–08220: Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore**

**Funksioni 9 ARSIMI**

**Programi –09120: Arsimi baze perfshire arsimi parashkollor**

**Programi –09230: Arsimi i mesem i pergjithshem**

**Programi –09240: Arsimi profesional**

**Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE**

**Programi –10140: Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara**

**Programi –10140: Sigurimi shoqeror**

**Programi –10430: Kujdesi social per familjet dhe femijet**

**Programi –10661: Strehimi social**

Burimet e financimit te buxhetit të Bashkisë, vijnë nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione, grante nderkombetare dhe te ardhura qe trashegohen.

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara dhe transfertat e kushtëzuar.

## **I. Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2019.**

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, te ardhurat te tjera dhe donacione. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë vitit 2019 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi plotësisht të ardhurat buxhetore të parashikuara, të nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve të larmishme që bashkia ka.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Objektivat kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor



Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbeshtetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimit kryesisht i bizneseve të vogla, mbeshtetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulancat etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimeve nga viti në vit.

Keto politika të lehtësimit fiskal dhe inçentivues, shoqëruar paralelisht me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2019 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimi i regjistrave të sakte elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultate shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave.

Kujdes të veçantë gjatë vitit 2019 ju kushtua përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësisht dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Kështu u hapën module të reja për dixhitalizimin on-line të akt-kontrolleve të mbajtura në terren, u mundësua hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të IMT dhe Policisë Bashkiake, u mundësua llogaritja automoatike e kamatvonesave, u mundësua llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë ZIN për subjektet shfytëzuese të hapsirave publike, parkingjeve, ambulancat etj.

Vazhdoi përdorimi i aplikacionit për smartphone “Taksat e Mia Shkodër”, ku mundësohet llogaritja e taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore sipas adresave, vitit fiskal, dhe kategorisë familjare.

Gjatë vitit 2019 vazhdoi lidhja on-line me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, dhe ka filluar up-date-imi i të dhënave për subjektet dhe familjet.

Objekti kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara është realizuar 99%, duke përbushur pritshmëritë referuar planifikimit buxhetor. Mosrealizimi i planit fillestar buxhetor

të vitit 2019 ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila është realizuar në masën 24 % për arsye të mospërfundimit të procedurave në lidhje me hartimin e planeve të detajuara vendore në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor, por edhe nga mospagesat e Taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e ndërtimeve pa leje; mosrealizimi i taksës së tokës bujqësore e cila është realizuar në masën 20 % , si rrjedhim i mosregjistrimit të pronave të tokës bujqësore, problemeve me Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi; si dhe mos transferimit të masës 2 % të Tatimit mbi të ardhurat personale, i cili për të dytin vit radhazi nuk i transferohet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore nga Ministria e Financave sipas ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Referuar arkëtimeve mujore gjatë vitit 2019, është siguruar njëtrajshmëri në nivelet e të hyrave mujore, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor.

Të ardhurat e veta u realizuan nga administrata e bashkisë, Njësiti Administrativ, Institucionet dhe agjentët tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

### **Kategorizimi i të ardhurave**

- Taksat vendore:
  - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
  - Taksa e ndikimit në infrastrukturë
  - Taksa e fjetjes në hotel
  - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5-8 milion, agjent DRT Shkodër
  - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- Taksat e ndara:
  - Taksa vjetore e e qarkullimit të mjeteve
  - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ASHK
  - Taksa e rentës minerare
  - Tatimi mbi të ardhurat personale
- Tarifat vendore
  - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të shërbimit administrativ
  - Tarifa për parkimin e mjeteve të licensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura të mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa për zënien e hapësirave publike
  - Tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj
- Të ardhura të tjera:
  - Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
  - Të ardhura nga kundravajtjet administrative

- Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve
- Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime
- Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
- Grante nga ndihma nderkombetare
- Të ardhura nga donacione/sponsorizime
- Të ardhura të tjera (komision si agjent tatimor).

## I. Realizimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore 2019

**Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore** në/000 lekë **682,069**

**TOTALI**

Të ardhura nga taksat	268,810
Të ardhura nga Taksat e ndara	94,614
Të ardhura nga Tarifatat Vendore	287,610
Të ardhura të tjera	31,035

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2019 arritën vlerën 682,069 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga taksat e ndara, të ardhura nga tarifatat, të ardhura të tjera.


**Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin** mijë/lek

Realizimi i planit të të ardhurave në total është me realizim 99%


	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Krahasimi në % me planin 2019
<b>A</b>	<b>TË ARDHURAT E VETA</b>	<b>692,010</b>	<b>682,069</b>	<b>99%</b>
<b>A.I</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>313,463</b>	<b>268,810</b>	<b>86%</b>
<b>I.1</b>	<b>Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV</b>	<b>5,400</b>	<b>6,991</b>	<b>129%</b>
<b>I.1.0</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi BV</b>	<b>50</b>	<b>13</b>	<b>26%</b>
<b>I.2</b>	<b>Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	<b>153,912</b>	<b>160,312</b>	<b>104%</b>
<b>I.2.1</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat</b>	<b>119,676</b>	<b>142,135</b>	<b>119%</b>
<b>I.2.1.1</b>	<i>Ndërtesa banimi</i>	<i>60,003</i>	<i>63,516</i>	<i>106%</i>
<b>I.2.1.2</b>	<i>Ndërtesa të tjera</i>	<i>59,673</i>	<i>78,620</i>	<i>132%</i>
<b>I.2.2</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore</b>	<b>21,736</b>	<b>4,446</b>	<b>20%</b>
<b>I.2.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi truallin</b>	<b>12,500</b>	<b>13,730</b>	<b>110%</b>
<b>I.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel</b>	<b>13,200</b>	<b>19,756</b>	<b>150%</b>
<b>I.4</b>	<b>Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë</b>	<b>125,201</b>	<b>69,003</b>	<b>55%</b>
<b>I.5</b>	<b>Të ardhura nga taksa e tabelës</b>	<b>15,700</b>	<b>12,736</b>	<b>81%</b>
<b>A.II</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	<b>74,560</b>	<b>94,614</b>	<b>127%</b>
<b>II.1</b>	<b>Të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve</b>	<b>60,200</b>	<b>78,861</b>	<b>131%</b>
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë</b>	<b>8,670</b>	<b>15,722</b>	<b>181%</b>
<b>II.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa e rentës minerare</b>	<b>34</b>	<b>32</b>	<b>93%</b>
<b>II.4</b>	<b>Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale</b>	<b>5,656</b>	<b>0</b>	
<b>A.III</b>	<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE</b>	<b>287,428</b>	<b>287,610</b>	<b>100%</b>
<b>III.1</b>	<b>Te ardhura nga tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave</b>	<b>166,891</b>	<b>166,913</b>	<b>100%</b>
<b>III.1.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje</b>	<b>73,313</b>	<b>71,055</b>	<b>97%</b>
<b>III.1.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione</b>	<b>400</b>	<b>411</b>	<b>103%</b>
<b>III.1.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi</b>	<b>93,178</b>	<b>95,447</b>	<b>102%</b>
<b>III.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik</b>	<b>34,270</b>	<b>33,306</b>	<b>97%</b>

III.1.1	Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje	21,794	19,059	87%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione	125	130	104%
III.1.3	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	12,351	14,117	114%
<b>III.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin</b>	<b>21,510</b>	<b>22,272</b>	<b>104%</b>
III.1.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje	9,470	9,012	95%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione	125	133	106%
III.1.3	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	11,915	13,127	110%
<b>III.4</b>	<b>Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ</b>	<b>64,757</b>	<b>47,371</b>	<b>73%</b>
III.4.1	Nga tarifa administrative, kontroll territorit, AMTP, etj.	116	3,482	3002%
III.4.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura	114	219	192%
III.4.3	Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit	1,561	764	49%
III.4.4	Nga tarifa parkimi për mjetet	3,789	4,787	126%
III.4.5	Nga tarifë për dhënie licënsa për tregtimin e naftës	400	1,000	250%
III.4.6	Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	202	99	49%
III.4.7	Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1,944	1,535	79%
III.4.8	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	32,000	35,469	111%
III.4.9	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore	500	0	
III.4.10	Nga dokumentat për tender, ankand etj.	10	16	156%
<b>III.5</b>	<b>Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj</b>	<b>24,121</b>	<b>17,748</b>	<b>74%</b>
III.5.1	<i>Biblioteka "Marin Barleti"</i>	116	21	18%
III.5.2	<i>Muzeumet</i>	2,929	2,407	82%
III.5.3	<i>Teatri "Migjeni"</i>	3,535	1,105	31%
III.5.4	<i>Qendra Kulturore e fëmijëve</i>	163	0	
III.5.5	<i>Pallati sportit " Qazim Dervishi"</i>	578	630	109%
III.5.6	<i>Qendra Komunitare</i>	0	0	
III.5.7	<i>Nga mensat (konviktet)</i>	500	103	21%
III.5.8	<i>Nga kopshet</i>	12,000	8,652	72%
III.5.9	<i>Nga çerdhet</i>	4,300	4,831	112%
<b>A.IV</b>	<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>	<b>16,559</b>	<b>31,035</b>	<b>187%</b>
<b>IV.1</b>	<b>Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)</b>	<b>7,170</b>	<b>21,914</b>	<b>306%</b>
<b>IV.2</b>	<b>Të ardhura nga dhënia me qira</b>	<b>4,116</b>	<b>3,675</b>	<b>89%</b>
<b>IV.3</b>	<b>Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime</b>	<b>3,000</b>	<b>1,108</b>	<b>37%</b>
<b>IV.4</b>	<b>Grante nga ndihma nderkombetare</b>	<b>1,433</b>	<b>1,426</b>	<b>99%</b>
<b>IV.5</b>	<b>Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve</b>	<b>500</b>	<b>1,261</b>	<b>252%</b>
<b>IV.6</b>	<b>Të ardhura nga shitja e aktiveve</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
<b>IV.7</b>	<b>Të ardhura nga privatizimi</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
<b>IV.8</b>	<b>Të ardhura te tjera</b>	<b>300</b>	<b>320</b>	<b>107%</b>
<b>IV.9</b>	<b>Te ardhura nga donacione/sponsorizime</b>	<b>40</b>	<b>1,330</b>	<b>3326%</b>

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas kategorive kryesore.



Grafiku i mëposhtëm pasqyron përqindjen e realizimit të ardhurave për zërat kryesorë, në raport me planin.




Zërat kryesorë, që janë me tejkalim në krahasim me e planin e vitit 2019 janë të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat, të ardhurat nga taksa e truallit, të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel, të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura, të ardhurat nga taksa e e kalimit të drejtës së pronësisë, të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik, ndriçimit, gjelbërimit, të ardhura nga tarifa e parkimit të mjeteve të licensuara dhe parkimeve të rezervuara, të ardhurat nga kamatvonesat për subjektet, të ardhurat nga gjobat e IMT-së, si dhe të ardhura nga detyrime të prapambetura.


Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkalim si rezultat i zgjerimit së bazës taksapaguese si efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe realizimit të 1.600 akt-kontrolleve, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore rreth 2.500 bllokime llogari bankare dhe të hipotekave, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të takapagueve nëpërmjet realizimit të mbi 35 dëgjesave dhe njoftimeve në media, nëpërmjet dërgimit të rreth 5.900 njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyren me 1 Ndalesë, rivlersimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatmorë etj.

Në realizimin e planit kanë ndikuar gjithashtu edhe donacionet, të cilat nuk janë parashikuar në planin fillestar buxhetor, dhe janë përfituar gjatë vitit 2019, në kuadër të Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, dhe Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksat e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore, taksat e ndikimit në infrastrukturë si rezultat i numrit të ulët të aplikimeve për leje ndërtimi, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale dhe të ardhura nga biznesi i vogël që mbledhet nga agjenti tatimor DRT, si rezultat i mosplotësimit të kuadrit ligjor organik. Këto diferenca në të ardhurat buxhetore totale plotësohen nga zëra të tjerë me tejkalim dhe kanë ndikuar në realizimin e mbledhjes së të ardhurave në masën 99 %.

Grafiku paraqet planin dhe realizimin e të ardhurave për secilën Njësi Administrative më vehte.






### Analiza e peshës specifike sipas kategorive

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga tarifatat me 42% dhe të ardhurat nga taksat me 39% të totalit.

Grafiku i mëposhtëm peshën e të ardhurave sipas kategorive:




### Analiza e peshës specifike sipas zërave

Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2019 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me 25% të të ardhurave të veta, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesa me 21.2%, taksa e ndikimit në infrastrukturë 10.29%, taksa vjetore e mjeteve të përdorura 11.76 %, tarifa për zënien e hapësirës publike 5.29%, tarifa e ndriçimit publik 4.97%, tarifa e gjelbrimit 3.32%, taksa e tabelës 1.9 %, tarifa


nga institucionet e varësisë me 2.65 %, taksa e fjetjes në hotel 2.95%, gjobat 3.27%, taksa mbi truallin 2.1 %, etj.

Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara për vitin 2019.



### Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2019

Falë fokusimit për zgjerim të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitorë, etj., të ardhurat kanë ruajtur një nivelet konstant të arkëtimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe fluiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.



Referuar arkëtimeve të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Qershor, periudhë e përcaktuar për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi. Gjithashtu ka një rritje



në fund të vitit fiskal, falë efektit të njoftimit, sensibilisimit dhe ndjekjes së masave administrative shtërnguese të ushtruara ndaj subjekteve debitore.

### Realizimi i të ardhurave 2019, krahasuar me vitet e kaluara

/000 Lekë	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
<b>Totali</b>	<b>482.687</b>	<b>506.154</b>	<b>612.033</b>	<b>702.144</b>	<b>682,069</b>
<b>Taksat vendore</b>	244.549	195.811	278.096	280.071	268,810
<b>Taksat e ndara</b>	57.500	54.448	57.207	81.214	94,614
<b>Tarifat vendore</b>	171.122	239.277	241.838	305.624	287,610
<b>Të Tjera</b>	9.515	16.618	34.892	35.235	31,034


Krahasuar me vitin 2018, realizimi i të ardhurave ka një rënie me me rreth 20,075 mijë Lekë, ose **3 % më pak se viti i kaluar**.

Krahasuar me vitin 2017, realizimi i të ardhurave ka një rritje të dukshme me rreth 70,036 mijë Lekë, ose **11 % më shumë se viti 2017**.


Krahasuar me të ardhurat e vitit 2016, ka një rritje me rreth 179,915 mijë lekë, ose **26 % nga viti 2016**.

Krahasuar me të ardhurat e vitit 2015, ka një rritje me rreth 199,382 mijë lekë, ose **30 % nga viti 2015**.

Paraqitja grafike e realizimit të të ardhurave në vite



## Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë nga viti në vit



Detyrimi i taksës së pasurisë për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor.

Taksa e *ndërtesës*, krahasuar me vitin e kaluar, ka rritur dukshëm nivelin e arketimit me +26% më shumë ose 17,674 mijë lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 24,550 mijë Lekë nga nga banesat, dhe 6,876 mijë Lekë më pak ndërtesat për qëllime biznesi, me një total rritjeje prej +17,674 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.

Taksa e *truallit*, krahasuar me vitin e kaluar, ka rritur gjithashtu dukshëm nivelin e arketimit me +14% më shumë ose me + 212 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.


Taksa e *tokës bujqësore*, krahasuar me vitin e kaluar, nuk ka pasur ndryshim nga viti i kaluar. Për efekt të lehtësimit fiskal për fermerët, në gjithë bashkinë Shkodër niveli i taksës së tokës bujqësore është ulur me 30%, pra deri në nivelin e lejuar të refencës ligjore, me ndikim nxitjen e fermerëve, por dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve.

Rritja e të ardhurave ka ardhur si efekt edhe i procedurave të verifikimit të kapaciteteve, të ndjekjes së detyrime, bashkrendimit të punës ndërmjet Nj.A, drejtorisë së bujqësisë, agentit tatimor, zyrave me një ndalesë etj.


Në zgjerimin e bazës taksapaguese dhe realizimin e të ardhurave për taksën e pronës, ku përfshihet ndërtesa, trualli dhe toka bujqësore, ka ndikuar ushtrimi i rreth 1.600 kontrolleve në subjekte, me efekt rivlersimit e sipërfaqeve të ndërtesave dhe truallit, si dhe saktësimit të aktivitetit të tyre.

Janë përfshirë falë monitorimit të sistemit të Z1N në skemën e pagesave të taksave dhe tarifave familjare rreth 1.400 familje në qytet, dhe rreth 1.350 familje në Nj.A., në total rreth 2750 familje, të cilat janë faturuar në SiTTV e bashkisë.

Zgjerimi i bazës taksapaguese dhe rritja e arkëtimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terren me subjektet dhe familjarët, nxitjes së vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese, nxitëse e sensibilizuese të bashkisë.



Tatim fitimi i biznesit të vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, arkëtohet nga bizneset e vogla, dhe më pas i transferohet bashkisë nga drejtoria tatimore, në rolin e agjentit tatimor.



Kjo taksë zë një nga zërat më të rëndësishëm tek të ardhurat e veta të bashkisë. Në raport me vitin e kaluar kjo taksë ka një rënie në arkëtim me -30,428 mijë Lekë, si rezultat i kërkesave të ulta për ndërtime në territorin e bashkisë.



Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, konkretisht plazhi Velipojë, dhe faturohen bazuar në monitorimet dhe verifikimet e herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve në terren. Gjatë sezonit turistik janë kryer rreth 1.300 verifikime faktike të shfrytëzimit të hoteleve për efekt të taksës së hotelit. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat kanë një rritje prej 27 % ose e shprehur në lek 5,354 kjo ka ardhë si pasojë e administrimit më të mirë dhe shtimit të kontrolleve në terren kryesisht në sezonin turistik.

### Taksat e ndara


Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë administrohet nga Zyra e ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës), në rolin e agjentit tatimor. Taksa vendoset nga agjenti tatimor i cili ja transferon të ardhurat e grumbulluara bashkisë. Krahasuar me vitin e kaluar kjo taksë është realizuar me + 4,232 mijë Lekë, ose +27%. Rritja e të ardhurave lidhet me rritjen e procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga individë dhe biznese që aplikojnë pranë agjentit tatimor në këtë rast ASHK-ja.


Taksa vjetore e mjeteve të përdorura grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, ku përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimorë. Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton një rritje e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë +9,184 mijë lekë, ose +12%, që është krijuar si rezultat i rritjes së numrit të automjeteve që aplikojnë për regjistrim pranë zyrave të DRShTRr.

Taksa e rentës minerare që grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” nga agjenti tatimor DRT, rezulton me një rënie të të ardhurave nga viti i kaluar me një vlerë 15 mijë lekë, ose - 32 % .

Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si taksë e ndarë, duhet t’ transferohet 2% bashkisë. Ka 2 vite, që nga hyrja në fuqi e ligjit, që Ministria e Financave nuk transferon asnjë vlerë në favor të bashkive.


Në total të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar +15,400 mijë lekë më shumë se vitin e kaluar, ose +16%






Tarifat vjetore të pastrimit, që janë arkëtuar nga biznesi për vitin 2019 arrijnë në total vlerën e 95,447 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rënie me vlerë - 8,904 mijë si pasojë e rënie së arkëtimeve të vitetve të kaluara të mbledhura në vitet e mëparshme, ose -9%.

Gjithashtu edhe të ardhurat me vlerë 71.055 mijë Lekë nga tarifat vjetore të familjeve kanë një zbritje të lehtë krahasuar me vitin e kaluar me vlerë -790 mijë .Kjo zbritje ka ardhur edhe si rezultat i krijimit të mundesive për shlyerjen e detyrimit pranë zonave të banimit me këste në vitet e kaluara.




Tarifat vjetore të ndriçimit, që janë arkëtuar për vitin 2019 arrijnë në total vlerën e 33,306 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rënie me vlerë -1,522 mijë Lekë ose - 5 %, që vjen edhe si rezultat i nxitjes dhe ndjekjes së procedurave ligjore ndaj subjekteve debitore, krijimit të mundesive për shlyerjen e detyrimit pranë zonave të banimit, ndarjes së detyrimit në këste mujore në vitet e mëparshme.



Tarifat vjetore të gjelbërimit, që janë arkëtuar nga biznesi dhe familjarët për vitin 2019 arrijnë në total vlerën e 22,272 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rënie të lehtë me vlerë - 302 mijë Lekë ose -1.4%, që vjen edhe si rezultat i nxitjes dhe ndjekjes së procedurave ligjore ndaj subjekteve debitoare, krijimit të mundësive për shlyerjen e detyrimit pranë zonave të banimit, ndarjes së detyrimit në këste mujore të realizuara në vitet e mëparshme.

### Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë



Pavarësisht se institucionet nuk kanë qëllim në vetvete krijimin e të ardhurave, nëpërmjet grumbullimit të tyre dhe gjetjen e burimeve të reja, ato lehtësojnë dhe mundësojnë shërbimin më cilësor dhe më të standartizuar të vetë atyre ndaj qytetarëve.

Edhe pse tarifat për shërbimet që ofrojnë këto insitucione kulturore, arsimore, sportive etj. kanë pasur tendencë uljeje ose zerimi kryesisht për disa kategori të veçanta përfituese si nxënës, studenë, grupe rinore etj., gjithsesi falë përmirësimit të shërbimit me efekt rritjen e fluksit të përfituesve të shërbimeve, shfrytëzimit me efikasitet i ambienteve, si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve në përgjithësi, ka rezultuar që në total gjatë vitit 2019 janë krijuar rreth 65.119 mijë Lekë të ardhura.

Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar, kemi një rënie me vlerë - 6,139 mijë Lekë ose - 8%.

Tarifat e shërbimit administrativ, kontroll zhvillim territori, AMTP etj. kanë një realizim - 6,515 mijë Lekë më pak se vitin e kaluar, që vjen edhe si rezultat i numrit të ulët të aplikimeve për kontrolle fizike të ndërtesave të përfunduara, si dhe zvogëlimit të numrit të aplikimeve për AMTP, etj.

Tarifa e parkimit të mjeteve të liçensuara dhe parkimet publike ka një rritje të lehtë + 458 mijë Lekë, ose +10%, si rezultat i menzxhimit më të mirë të tarifës për vendqëndrim autobuzi sipas VKB nr. 84, dt. 26.12.2017.

Tarifat e shërbimeve që kryen MZSH kanë një zbritje prej - 661 mijë Lekë, si rezultat i zvogëlimit të numrit të kontrolleve të ushtruara nga inspektorët dhe detyrimit ligjor të gjithë subjekteve për rinovim të akteve kundra zjarrit.

Tarifat për zënien e hapësirës publike që janë arkëtuar për vitin 2019 arrijnë në vlerën 35,469 mijë Lekë, me një rritje prej + 543 mijë Lekë më shumë se vitin e kaluar, ose +2%, si rezultat i rritjes së kërkesës, por edhe nxitjes së shfrytëzimit në zonat periferike nëpërmjet uljes së tarifës me VKB nr. 84, dt. 26.12.2017. Rreth 78% e të ardhurave nga kjo tarifë u realizua në Plazhin Velipojë.

Kjo e ardhur e konsiderueshme për bashkinë u arrit falë evidentimit të vazhdueshëm të potencialit të kapaciteteve dhe aseteve, formalizimit transparent të marrëdhënieve me bizneset taksapaguese, krijimit të procedurave të sakta e të thjeshta, si dhe shfrytëzimit efikas të hapësirave publike kryesisht ranore.

Tarifat nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj që janë arkëtuar për vitin 2019 arrijnë në vlerën 17,748 mijë Lekë, me një zbritje prej - 912 mijë Lekë, ose - 5%, si rezultat i zvogëlimit të numrit të vizitorëve në muzeume, dhe nga tarifat e grumbulluara nga kopshtet dhe çerdhet.

### **Të ardhura të tjera**

Të ardhurat e tjera burojnë nga gjobat, kamatvonesat, qira etj,për vitin 2019 janë grumbulluar 29,704 mijë lekë, ndërsa donacionet në masën 1,033 mijë lekë.

Krahasuar me vitet e kaluar, të ardhurat kanë pasur një zbritje të vogël me vlerë - 4,201 mijë Lekë, ose - 12 %, si pasojë e shtimit të kontrollit dhe monitorimit në terren duke u ulur masa e gjobave, si dhe mbarimi i kontratës së qerasë me subjektin që kishte në shfrytëzim thertoren e qytetit.

## Analiza e realizimit të të ardhurave sipas Njësi Administrative

Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2019, të kategorizuar sipas klasifikimit Ekonomik në 000/lekë.

	LLOJET E TË ARDHURAVE	Bashkia Shkoder		Qyteti		Postribë		Guri i Zi		Bërdicë		Velipojë		Dajç		Ana e Malit		Rrethina		Pult		Shosh		Shalë	
		Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019	Plan viti 2019	Realizimi Viti 2019
A	<b>TË ARDHURAT E VETA</b>	692,010	682,069	479,908	461,865	13,223	12,532	17,167	13,148	19,023	13,626	91,588	131,716	16,926	10,070	10,893	9,149	34,968	25,632	2,135	843	2,838	1,260	3,339	2,227
A.J	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>	313,463	268,810	218,177	157,944	4,663	4,113	6,673	4,119	9,155	5,635	45,604	80,542	8,854	2,140	4,348	3,431	14,334	10,337	257	31	702	44	696	473
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	5,400	6,991	5,050	6,991	50	0	50	0	0	0	250	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
I.1.0	Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	50	13	50	13	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
I.2	Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	153,912	160,312	78,154	106,063	4,073	3,123	5,723	2,156	8,705	3,247	30,037	37,359	8,397	2,140	3,748	1,319	13,582	4,574	247	13	692	30	554	288
I.3	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	13,200	19,756	1,320	2,934	0	0	0	1	0	0	11,616	16,362	0	0	0	0	132	259	0	0	0	14	132	185
I.4	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	125,201	69,003	119,401	30,571	400	982	400	1,922	400	2,073	3,400	26,259	400	0	400	1,823	400	5,355	0	18	0	0	0	0
I.5	Të ardhura nga taksa e tabelës	15,700	12,736	14,202	11,372	140	8	500	40	50	316	301	562	57	0	200	288	220	150	10	0	10	0	10	0
A.II	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT ENDARA</b>	74,560	94,614	41,259	51,222	3,963	5,211	4,531	6,000	3,678	4,974	5,032	6,709	4,230	5,598	3,026	4,020	5,484	7,332	819	789	1,120	1,183	1,421	1,577
II.1	Të ardhura nga taksa vjetore për parkullimin e mjeteve të përdorura	60,200	78,861	30,100	39,430	3,612	4,732	4,214	5,520	3,311	4,337	4,515	5,915	3,913	5,126	2,709	3,549	5,117	6,703	602	789	903	1,183	1,204	1,577
Nr	Subjektet	Niveli vlerësimit te riskut	Llojet e auditimeve	Objektet të pa audituara mbi 2-vjet	Realizimi
1	ZIN		Tematik	✓	Perfunduar ne muajin Janar 2019
2	Drejtoria e Sherbimeve Publike Ndjekjes Investimeve te Infrastruktures, Njesia Monitorimit Sherbimeve Publike , Mirëmbajtja Pastrimit		Financiar	✓	Perfunduar ne muajin Janar 2019
3	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP	Mesem	Perputhshmeri	✓	✓
4.	Dega Ekononmike e Kultures	mesem	Kombinuar	✓	✓
5	Detyrimet e prapambetura, sipas kerkeses së Ministrise së Financave	I larte	Perputhshmeri	✓	✓
6	Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	I larte	Perputhshmeri	✓	✓
7	Teatri "Migjeni"	I larte	Kombinuar	✓	✓
8	Inspektoriati I Mbrojtjes Territorit Vendor	I larte	Perputhshmeri	✓	✓
9	Drejtoria e Kontrollit te Zhvillimit te Territorit	I mesem	Perputhshmeri	✓	✓
10	Drejtoria e Stumimeve e Planifikimeve te Territorit	I larte	Perputhshmeri	✓	✓

*Sa më sipër rezulton se:*

### 1. Dosjet e auditimit për subjektet e audituara përmbajnë

Bazuar ne programin vjetor te punes Drejtuesi i Njesise se Auditimit, ka pergatitur Autorizimin per fillimin e Angazhimit te auditimit për secilin subjekt (Dokumenta te paprotokolluara pasi janë brenda zyres)

Audituesit para takimit fillestar kanë plotësuar deklaratën e pavarësisë..

Me ane të shkresës përcjellëse për secilin subjekt është bërë Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit.

Është hartuar Programi i auditimit për subjektet, program i hartuar nga Përgjegjësi i AB.

Është bërë takimi fillestar me përfaqësuesit e subjektit pasi është njoftuar 10 dite para për takimin , ku janë prezantuar grupi audituesve dhe program auditimit të miratuar nga Titullari i Bashkisë.

Nuk janë mbajtur akt-verifikime me personat përgjegjës, por rastet e shkeljeve ligjore shënohen në gjetje duke percaktuar referencat ligjore.

Mbas përfundimit të auditimit në fund është bërë takimi përmbledhës.

Është hartuar projekt raporti për subjektin e audituar dhe është dërguar me shkresë përcjellëse sipas formatit të miratuar nga titullari i njësisë publike.



Brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e projekt raportit subjektiv të audituar, janë marrë në shqyrtim observacionet e paraqitura nga drejtuesit e subjekteve të audituara (në rastet kur kanë paraqitur).

Është hartuar raporti final i cili i është dërguar subjektivit të audituar, brenda 7 ditë pune pasi janë analizuar observacionet.

Është dërguar MEMO Kryetarit të Bashkisë me shkresë përcjellëse për secilin nga subjektet e audituara.

Jane lene Gjetje dhe Rekomandime sipas subjekteve te audituara , përkatesisht:

	<b>Gjetje</b>	<b>Rekomandime</b>
ZIN	7	4
Drejtoria e Sherbimeve Publike Ndjekjes Investimeve te Infrastruktures, Njesia Monitorimit Sherbimeve Publike , Mirëmbajtja Pastrimit	9	8
Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP	13	22
Dega Ekonomike e Kultures	27	15
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	13	15
Teatri "Migjeni"	34	30
Inspektoriati I Mbrojtjes Territorit Vendor	12	14
Drejtoria e Kontrollit te Zhvillimit te Territorit	12	20
Drejtoria e Stumimeve e Planifikimeve te Territorit	15	23
Detyrimet e mrapambetura	7	3

## Programi 01170 - Gjendja Civile

Ky program përfshin zyrat e gjendjes civile në Bashkinë qender dhe ne 10 Njesi Administrative.

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Qëllimi i programit është:

Gjendja Civile është sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara

Objektivi i programit është :

O1. Shërbime te deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre.


Përshkrimi i programit Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore

### Rezultatet e programit Gjendja Civile

Programi P01170	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 12-mujor 2019	14,920	662	53		15,635
Realizimi 12-mujori 2019	14,478	0	53		14,531

Realizimi i shpenzime korente dhe kapitale per kete program,duke e krahasuar me planifikimin është 93%, sipas zërave kryesorë si me poshtë:

Shpenzimet e personelit	97%
Shpenzimet e tjera operative	0 %
Transferta	100%
<b>Gjithsej</b>	<b>93. %</b>



Për vitin 2019 në programin 01170 “ Gjendja Civile ” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për 12 mujorin e vitit 2019 është përmirësuar shërbimi i Gjendjes Civile.

**P01170.O1.A1** Shërbimet e deleguara Gjendja Civile Është realizuar dhe përmirësuar rritja e të ardhurave të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave dhe realizuar shkurtimi i kohës së marrjes së shërbimit. 2286 Regjistrimi i lindjeve, 959 martesave dhe 1224 vdekjeve për Bashkinë Shkoder.

Aktivite/Projekte	Buxheti 2019 në mijë lekë	Realizim 12- mujori 2019
P01170.O1.A1 Shërbimet e deleguara Gjendja Civile	15,635	14,531

## FUNKSIONI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

### Programi 03140 - Shërbimet Policore Vendore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Policia Bashkiake

#### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Policisë Bashkiake është:

Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të Bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2019 kanë qënë:

O1. Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.


O2. Sigurimi i Shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e policisë

Programi	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
<b>P.03140</b>						
<b>Plani 2019</b>	17,951	1,100	0	150	8,663	27,864
<b>Realizimi 12 mujorit 2019</b>	15,143	1,031	0	150	8,614	24,938

Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 89.5%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzimet e personelit 84.4%  
Shpenzimet e tjera operative 93.7%

Transferime	100%
Shpenzimet kapitale	99.4%
<b>Gjithsej</b>	<b>89.5%</b>



**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

Periudha e Raportimit: 01.01.2019-31.12.2019

Kodi i Programit	3140	Emertimi i programit:	Shërbimet e Policise Vendore					Komente	
Qellimi 1	Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkise dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.						.....		
<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>							.....		
<b>*Objektivat e politikës*:</b>		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<b>Objektivi 1.1</b>	O1. Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësiive.	1	nr punonjës të Policisë bashkiake	24	24	24	22	92%	.....
		2	nr uniforma per punonjesit e Policise bashkiake	24	24	24	24	100%	.....
<b>Objektivi 1.2</b>	O2. Sigurimi i Shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e policise	4	nr automjete		1	1	1	100%	.....
		5	nr kamera te vendosura ne pika strategjike te qytetit		41	41	41	100%	.....
		.....	.....	.....					

**ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"**

<b>Emri i Grupit</b>	Bashkia Shkoder	<b>Kodi i Grupit</b>	141
<b>Programi</b>	Shërbimet e Policise Vendore	<b>Kodi i Programit</b>	3140

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/P roduktit	Njësia mates e	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	I		II			III			IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
					Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = I - II	
A	nr uniforma per punonjesit e Policise bashkiake	cope	24	408	17	24	500	21	24	500	21	24	467	19	2	-1	-1	.....
B	nr punonjës të Policisë bashkiake (paga dhe sigurime+ shp operative+ transferime)	numer	24	17,751	740	24	18,106	754	24	18,106	754	22	15,298	695	-44	-59	-59	.....
C	nr automjete	cope	0	0	#DIV/0!	0	0	#DIV/0!	1	2,000	2,000	1	2,000	2,000	#DIV/0!	#DIV/0!	0	.....
D	nr kamera te vendosura ne pika strategjike te qytetit	cope	0	0	#DIV/0!	0	0	#DIV/0!	41	6,663	163	41	6,614	161	#DIV/0!	#DIV/0!	-1	.....

Për vitin 2019 në Programin "Shërbimet Policore Vendore" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 6 aktivitete.

-Aktivitetet janë analizuar si më poshtë:

P03140.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

P03140.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake

P03140.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake

P03140.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë Bashkiake

P03140.O2.A4 Blerje automjete në funksion të policisë Bashkiake

P03140.O2.A5. Furnizim vendosje kamera sigurie për ambiente publike.

<b>Aktiviteti</b>	<b>Buxheti në mijë lekë</b>	<b>Realizimi 12-mujorit 2019 mijë lekë</b>
P03140.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	18,106	15,298
P03140.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	500	467
P03140.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake	555	555
P03140.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë Bashkiake	40	4
P03140.O2.A4 Blerje automjete në funksion të policisë Bashkiake	2,000	2,000
P03140.O2.A5. Furnizim vendosje kamera sigurie për ambiente publike.	6,663	6,614
<b>Totali</b>	<b>27,864</b>	<b>24,938</b>

## Programi 03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. MZSH

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është:

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2019 kanë qënë:


O1. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.

O2. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

Programi P.03280	Paga Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
<b>Plani 2019</b>	35,746	4,970	0	9,916	3,000	53,632
<b>Realizimi 12- mujorit 2019</b>	32,404	3,885	0	7,651	2,694	46,634

Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 91.0%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzimet e personelit	91.0%
Shpenzimet e tjera operative	78.2%
Transferime	77.2%
Shpenzimet kapitale	89.8%
<b>Gjithsej</b>	<b>87.0%</b>





**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

Periudha e Raportimit: 01.01.2019-31.12.2019

Kodi i Programit	3280	Emertimi i programit:	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile					
Qellimi 1	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile. 1. Përafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile. 2. Sigurimi i mbrojtjes civile në të gjithë territorin.							
		<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>						
*Objektivat e politikës*:	Kodi i Treguesit të Performancës/Produktit	Emertimi i Treguesit të Performancës***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin korent	Niveli i rishikuar në vitin korent	Niveli faktik në fund të vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit	
.....								
Objektivi 1.1	Krijimi i strukturave për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile	P03280.O1.A2.	Përballimi i ndihmave të menjehershme për familjet me raste fatkeqësie	1,520	3,000	9,861	7,601	77%
Objektivi 1.2	Shërbim i përmirësuar I MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.	P03280.O2.A1.	Shpenzime operative total	7,161	4,970	4,970	3,942	79%
Objektivi 1.3	Shërbim i përmirësuar I MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.	P03280.O2.A1.	Shpenzime transporti	2,819	3,370	3,370	3,188	95%

**ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"**

<b>Emri i Grupit</b>	Bashkia Shkoder	<b>Kodi i Grupit</b>	141
<b>Programi</b>	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	<b>Kodi i Programit</b>	3280

Kodi	Emertimi i Treguesite Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Kostone per Njesi			Komente		
					Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = I	V = I		V = I	
A	Shpërblim për familjet e dëmtuara nga fatkeqesitë natyrore etj	familje	59	1,520	26	40	3,000	75	40	3,000	75	19	1,540	81	55	6	6	.....
B	Shpenzime operative total	000/lek	9,301	7,161	1	7,111	4,970	1	7,111	4,970	1	3,509	3,509	1	0	0	0	.....
C	Shpenzime transporti	000/lek	3,033	2,819	1	5,050	3,370	1	5,050	3,370	1	3,188	3,188	1	0	0	0	.....

Për vitin 2019 në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 4 aktivitete.

-Aktivitetet janë realizuar si me poshtë:

P.03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie

P.03280.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë

P.03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

P.03280.O2.A2. Rikonstruksion i godinës së MZSH

<b>Aktiviteti</b>	<b>Buxheti në mijë Lek</b>	<b>Realizimi 12-mujorit 2019 në mijë Lekë</b>
P.03280.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër.		
P.03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie	9,861	7,601
P.03280.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë	1,000	1,000
P.03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	41,061	36,601
P.03280.O2.A2. Rikonstruksion i godinës së MZSH	1,710	1,432
<b>Totali</b>	<b>53,632</b>	<b>46,634</b>

## FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE

### Programi 04130 - Mbështetja për zhvillim ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në mbështetje të biznesit, si institucion realizojmë panairin e Punes dhe të Biznesit cdo vit brenda ambjenteve të Bashkisë si një mënyrë shumë efektive për të vënë përballë njëri tjetrit të gjithë aktorët e interesuar në proces. Qëllimi është krijimi i një network-u që lidh aktorët e interesuar, shkëmben informacionet me synim zbutjen e papunesisë.

Gjithashtu organizimi i panireve në njesite administrative nga ana jone me qëllim promovimin e vlerave artistike – kulturore dhe të produkteve të territorit të njësive administrative të Bashkisë si dhe në mbështetje të biznesit po hap gjithnjë me shumë mundësi të bashkëpunimit ndërmjet tyre.

#### I Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2019 në programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ka qëllim të programit të saj këto funksione zhvillimi:

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panire e reklama në vende publike
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12-mujorin e vitit 2019 janë:

O1. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.

O2. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.


O3. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promociionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.

O4. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

#### II Rezultatet e programit 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Programi 04130	Paga + Sigurime	Shpenzime operative	Subvencione	Transferta	Investime	Totali
Plani 2019	1.652	3.353	0	4.417	0	9.422
Realizimi 12-mujor 2019	1.152	992	0	4.004	0	6.148

## Realizimi ne % i shpenzimeve



**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

Periudha e Raportimit: 01.01.2019-31.12.2019

Kodi i Programit	4130	Emertimi i programit:	Mbeshtetja per zhvillim ekonomik					Komente
Qellimi 1	Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash.						.....	
			<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>					.....
<b>*Objektivat e politikës*:</b>	<b>Kodi i Treguesit te Performances/Produktit</b>	<b>Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit</b>	<b>Niveli faktik i vitit paraardhes</b>	<b>Niveli i planifikuar ne vitin korent</b>	<b>Niveli i rishikuar ne vitin korent</b>	<b>Niveli faktik ne fund te vitit korent</b>	<b>% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit</b>	
Mbeshtetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve zhvillimore lokale.	<b>01</b>	Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare	3	3	3	3	100%	Aktivitete te perfunduara sipas parashikimit si dhe te likujduara ne kohe
		Permiresimi i shërbimeve të ofruara ndaj biznesit DHE KOHA E PAISJES ME DOKUMENTACION NE QKB	1	1	1	1	100%	Aktivitete te perfunduara sipas parashikimit si dhe te likujduara ne kohe
Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.	<b>02</b>	Numri i panairove të organizuara në Bashkinë Shkodër.	12	10	10	8	80%	Aktivitete te perfunduara sipas parashikimit me perjashtim te 2 prej tyre. Likujduar ne kohe gjithashtu
Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale per nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.	<b>03</b>	Numri i materialeve informative të publikuara/botuara për zhvillimin ekonomik.	2	1	1	0	0%	Aktivitet i parealizuar

	Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.	<b>04</b>	Numri i inisiativave të mbështetura.	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	50%	<b>1 inisiativë e mbështetur dhe e likuajduar sipas marrëveshjes së parashikuar</b>
--	--	-----------	--------------------------------------	----------	----------	----------	----------	-----	---

### III Realizimi i treguesve te performancës

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

<b>Emri i Grupit</b>	Bashkia Shkoder	<b>Kodi i Grupit</b>	141
----------------------	-----------------	----------------------	-----

<b>Programi</b>	Mbeshtetja per zhvillim ekonomik	<b>Kodi i Programit</b>	4130
-----------------	----------------------------------	-------------------------	------

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësi matematike	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	I		II			III			IV	Luhatjet ne Koston per Njese			Komente	
					Kosto per Njese (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njese (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njese (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)		Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njese Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I		V = IV - II
A	Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare.	numër projektsh	3	1,831	610	3	1,177	392	3	1,268	423	3	1,268	423	-188	30	0	Treguesi ne fjale perfshin projektet e financuara nga programi jone ne bashkefinancim me RELOAD. Jane likujduar sipas marreve shjes 3



																		projektet fituese te thirrjes se dyte te cilat kane perfunduar realizimin e tyre.
<b>B</b>	Panaire te organizuara ne Bashkine Shkoder	nr panairesh	12	1,999	167	10	2,640	264	10	2,640	264	8	1,924	241	74	-24	-24	Tete aktivite te realizuara, shpenzimet e uleta faktike edhe si rezultat i ofertave te zbritura ne prokurime
<b>C</b>	materjale informativete botuara per zhvillim ekonomik	nr botimesh	2	630	315	1	300	300	1	300	300	0	0	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	Aktiviteti i parealizuar si rezultat i veshitjes se mbledhjes se informacionit
<b>D</b>	numer iniciativash biznesi te mbeshtetura	numeri	1	1,600	1,600	2	2,600	1,300	2	2,600	1,300	1	1,600	1,600	0	300	300	Eshte likujduar sipas marreveshjes me shoqatën BID Shkodra vlera perkates

																		e. Aktiviteti tjetër i përfunduar si pasojë e veshitjeve të hasura.
E	Permirësimi i shërbimeve të ofruara ndaj biznesit me anë të kohës së pajisjes me dokumentacion pranë QKB	dite	1	0	0	1	1,418	1,418	1	1,738	1,738	1	1,238	1,238	1,238	-180	-500	Eshtë likuiduar 100% e planit për vlerën e mbetur pa shpenzuar dhe është rezultat i raportit të lindjes së njërës nga punonjësit e stafit.

Gjatë vitit 2019 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04130.

#### **P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjise se zhvillimit të Bashkisë Shkodër**

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë. Qëllim është të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të matë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara.

#### **P04130.O1.A4. Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLOad)**

Pjesëmarrja në Programet Europiane është projektuar për t'u mundësuar shteteve, njohjen me metodat dhe politikat e Bashkimit Europian (BE). Anëtarësimi në Bashkimin Europian (BE) konsiderohet si një sfidë, por gjithashtu integrimi evropian është prioriteti kryesor për Shqipërinë dhe një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Shqipëria përfiton nga Programet Europiane dhe në këtë kuadër edhe njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësisve vendore në këtë proces. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde europiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është shpallur fituese në thirrjen lançar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër merr përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projekti ReLOaD. Bashkëfinancimi do të programohet i ndarë në dy vite buxhetore për periudhën e kohëzgjatjes së projektit 2018 – 2020. Bashkia Shkodër angazhohet që gjatë periudhës kohore 2018 – 2020 të organizojë tre thirrje publike, nga të cilat, dy të parat do të financohen nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë bashkisë. Thirrjet do të realizohen mbi bazën e dokumentave strategjike dhe prioriteteve që Bashkia Shkodër ka. I gjithë procesi do të konsultohet me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Për tre thirrjet e organizuara do të zbatohet Metodologjia LOD. Në muajin Shkurt të vitit 2019 u hap thirrja e dytë e projektit. Në përfundim të procesit të vlerësimit të projekteve të thirrjes së dytë është shpallur lista e fituesve për 3 projektet me të mira. Pasi është lidhur kontrata me projektet fituese është bere edhe likuidimi i financimit sipas marreveshjes. Nderkohe projektet kane organizuar dhe kane mbyllur aktivitetet e tyre sipas planifikimit.

#### **P04130.O1.A5. Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndëkomëtare.**

Procesi i integritimit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel

vendor varet nga angazhimi i njëjësive vendore në këtë proces. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE-së.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafuara europiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është aplikuese në disa nga programet e financuara nga BE-së dhe një ndër specifikat e thirrjeve për projekte është edhe bashkëfinancimi. Kështu për projektet e shpallura fituese nga Bashkimi Evropian, Bashkia Shkodër merr përsipër bashkëfinancimin e projekteve fituese sipas specifikave të programeve të BE-së. Në këtë kuadër lind e nevojshme parashikimi i një fondi për bashkëfinancim në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.

Nga kjo fishe me shkresë percjellese për shlyerje detyrimesh me nr.782, datë 20.03.2019 është bërë likuidimi i pagesës për tarifën e pjesmarrjes në aktivitete ndërkombetare me vlerë 165 000 leke, e cila është rimbursuar brenda 4-mujorit të dytë të vitit. Gjithashtu nga kjo fishe është bërë edhe pagesa e rregjistrimit të Markes Zyrtare të Bashkisë Shkodër, produkt ky i “Mandarina Project” financuar nga fondet e BE nëpërmjet projektit RELOAD. Pjesa tjetër e fondit ka mbetur e pashfrytëzuar për faktin se nuk është finalizuar akoma procesi i lidhjes së marrëveshjeve dypaleshe.

#### **P04130.O1.A7. Informimi në mënyrë periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integritimit Evropian, Kendi BE Shkodër**

Projekti “Bashkitë për në Evropë”, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, synon fuqizimin e pushtetit vendor në Shqipëri gjatë procesit të integritimit. Në kuadër të këtij projekti është ngritur zyra e çështjeve të BE-së pranë 61 bashkive. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor si dhe shërben si një urë për absorbimin e fondeve/programeve të BE. Këtu bëhet informimi në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integritimit evropian, për politikën e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistencën e Bashkimit Evropian, nëpërmjet këndit të Bashkimit Evropian, i cili është krijuar dhe funksionon brenda bashkisë.

Në këtë kuadër zyra e çështjeve të BE-së Shkodër do të sigurojë dhënien e informacionit të nevojshëm për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integritimit evropian, për politikën e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistencën e Bashkimit Evropian. Njëkohësisht do të bëjë shpërndarjen e materialeve promovuese mbi fondet, programet dhe projektet e BE-së. Numri i qytetareve që marrin informacion dhe shërbime nga Kendi i BE-së. Përgjithësisht kërkesat janë të lidhura me mundësitë e studimit jashtë vendi dhe mundësitë e financimit të projekteve.

#### **P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër**

Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktiviteteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër realizon panairin e punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Zyren Rajonale të Punësimit Shkodër, Qendren e Formimit Profesional, Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjërë. Ky panair synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të punës, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit midis autoriteteve vendore, institucioneve, partnerëve socialë dhe të sektorit privat, në një partneritet lokal të

qëndrueshëm për punësim. Ky aktivitet është realizuar çdo vit gjatë javës së dytë apo të tretë të muajit dhjetor. Këtë vit ndryshe nga vitet e tjera nuk patëm mundësi ta prokurorim për arsye të shkresës së MFE nr prot. 21920 datë 02.12.2019 “ Mbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqsisë natyrore”

#### **P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative**

Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet praninë e bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qëllim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse bashkia ka parashikuar organizimin e panireve të produkteve agropërpunuese. Në këtë panair prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional. Ky aktivitet është zhvilluar në muajin nëntor të vitit 2019, si dhe ka përfunduar procedura e likuidimit të këtij aktiviteti. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vendase pasi është gjithmone në rritje edhe kërkesa e fermerëve për të marrë pjesë në panair. Diferenca e mbetur pa shpenzuar vjen si rezultat i procesit të prokurimit meqenëse sipas ligjit prioritet ka oferta me e ulët.

#### **P04130.O2.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)**

Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimin të shpirtit njerëzorë përmes këngës. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet dhe kushtet natyrore të saj. Në këtë kuadër janë parashikuar panire në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Aty prezantohen pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional. Këto panire të organizuara edhe në vitet paraardhese janë vlerësuar si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyrore që vendi ka por edhe produktet e sektorit të agrobiznesit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë aktiviteteve kulturore e më shumë prodhime vendase. Ky aktivitet konsiston në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit. Organizimi i këtyre panireve është parashikuar të shpërndahet përgjatë muajve të vitit. Gjatë vitit janë realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara në fische me përjashtim të nja a. Shosh, kjo për arsye të terrenit shumë të thyer malor.

#### **P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB**

Pagesa e punonjësve të QKB pranë institucionit tonë bëhet në mbështetje të nenit 8, pika 1 dhe 2; dhe nenit 9, pika 2, të ligjit nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” .

Në zbatim ligjit, Bashkia Shkodër ka lidhur me QKB-në, marrëveshjen e bashkëpunimit nr 6074 date 25.05.2016 ku në nenin 5 pika 1 përcaktohet:

“Niveli i pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve në sportelet e shërbimit, pranë njësisë së qeverisjes vendore , përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak duke marrë në konsideratë fondin e deleguar nga QKB –ja për këtë qëllim.

Keto funksione te deleguara tashme kryhen nga Bashkia dhe gjithashtu me Vendimin e Keshillit Bashkiak Nr 6 datë 18.01.2019 “ Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe të institucioneve të varësisë”. janë përcaktuar disa nivele page në kategorinë e pozicionit ku paguhet nëpunësit e sporteleve të shërbimit të QKB-së.

Aktualisht janë dy punonjës që ofrojnë shërbimin pranë zyrës së QKB në Bashkinë Shkodër. Permirësimi i vazhdueshëm i shërbimit është një nga pikat e forta të QKB dega Shkoder. Sot cdo kerkese procesohet brenda 24 oreve dhe ka perfunduar procesi i likuidimit te pagave dhe sigurimeve shoqerore per 12 muajt e pare te vitit. Pjesa e mbetur e fondit e pashfrytezuar është si rezultat i raportave të lindjes së njerës nga punonjëseve, meqenëse keto likuidohen nga sigurimet shoqerore.

#### **P04130.O3.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web te Bashkise**

Bashkia Shkoder nëpërmjet faqes së saj të internetit ofron informacione të ndryshme për shërbime ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe informacione të ndryshme informative statistikore dhe social kulturore. Kjo faqe web është pasuruar dhe më tej në lidhje me rikonceptimin e strukturës së informacionit dhe shërbimeve që ofron ndaj të bërit biznes në Shkodër. Procesi i pasurimit të faqes web të Bashkisë Shkoder është i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit.

#### **P04130.O3.A4. Publikim i katalogut të produkteve të territorit të Bashkisë Shkoder**

Me ndarjen e re territoriale, territori i Bashkisë Shkodër është zgjeruar, duke rritur kështu edhe gamën e produkteve që ofron zona. Duke marrë parasysh kërkesat në rritje të tregut ndërkombëtar për këto produkte dhe larminë e produkteve që ofron ky territor, lind nevoja për një ofertë produktesh cilësore dhe të garantuara për konsumatorin vendas , por edhe rritjen e imazhit të këtyre produkteve ”Made in Albania” të destinuara për tregjet rajonale e me gjerë.

Panairët e organizuara gjatë vitit 2018 kanë nxjerrë në dukje nevojën për promovimin e produkteve tona bujqësore, blektorale, të artizanatit, industriale etj. Bashkia Shkoder është e pasur me shumëllojshmëri produktesh bujqësore dhe blektorale të cilat janë të pastra dhe pa kimikate dhe në konsiderojmë vlerë të shtuar të territorit tonë. Promovimi i kësaj larmie produktesh që territori jonë ofron është një mundësi shumë e mirë për prodhuesit që deshirojnë të gjejnë tregje të reja shitjeje. Në kuadër të këtij projekti ishte planifikuar të hartohet dhe publikohet një katalog i produkteve vendase, megjithatë patëm shumë vështirësi në mbledhjen e informacionit meqenëse deshironim që të kishte një game sa më të gjërë të produkteve.

#### **P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori**

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t’u konsoliduar, nëpërmjet permirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së permirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin. Nga ky bashkëpunim përfitojnë rreth 120 biznese. Në zbatim të programit të bashkëpunimit, me qëllim zhvillimin dhe permirësimin e klimës së biznesit në zonë është rishikuar marrëveshja për vitin 2019 dhe në kuadër të saj, Shoqata BID ka ofruar shërbime publike shtesë, ka

zhvilluar një sërë aktivitete kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Është perfunduar likuidimi i vlerës së planifikuar të justifikuar me faturat që janë depozituar tek ne nga ana e shoqatës.

#### **P04130.O4.A2. Krijimi i Zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër**

Në vazhdim të bashkëpunimit që Bashkia Shkodër ka me projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”, si dhe duke u nisur nga interesimi që bizneset shumë rugeve të tjera karakteristike të qytetit të Shkodrës, kanë shfaqur për të krijuar Zonen e Përmirësimit të Biznesit, Bashkia Shkodër do të mbështesë iniciativën e tyre për të krijuar një zonë të re. Rruge të ndryshme të qytetit të cilat përfaqësojnë historikisht Shkodren kanë përparësi që të mbështeten nga ky projekt.

Qëllimi kryesor është të krijojmë mundësi ekonomike të përmirësuara, siguri dhe një klimë të mirë biznesi mes anëtarëve të rruges tregtare të perzgjedhur.

Projekti u mendua se do të ketë një ndikim të rëndësishëm social-ekonomik për banorët e Shkodrës duke kontribuar në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve. Jemi përpjekur të bashkëpunojmë me aktorët e interesuar të rrugëve tregtare, pasi duhet dhe bashkëpunimi i tyre për reabilitimin e rrugëve. Në fakt procesi ka patur vështirësi për zbatimin e tij kështu që nuk kemi arritur ta realizojmë atë.

#### **P04130.O4.A3. Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekszistuese.**

Qytetet si qendra investimesh janë motorët e rritjes së zhvillimit ekonomik. Shkodra ka nevojë për rritjen e numrit të sipërmarrjeve, Start Up dhe SME-ve, si një mundësi për rritjen e zhvillimit ekonomik të 11 njësisve administrative të saj. Vihet re një rritje e numrit të këtyre sipërmarrjeve pas krijimit të programeve të ndryshme të ofruara përmes AIDA-s, por mungesa e burimeve njerëzore profesionale për përfitimin e burimeve të financimit nga këto programe sjell barriera që sipërmarrjet të përfitojnë nga këto fonde. Me qëllim nxitjen e investimeve dhe rritjen e aksesit për përfitimet e këtyre fondeve nga ndërmarrjet, Bashkia Shkodër ka krijuar paketa informuese për subjektet e interesuara dhe ofron shërbimin e informacionit dhe këshillimit të tyre.

#### **P04130.O4.A4. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.**

Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumentacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiare qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforsimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj. Në këto kuader bashkia shkodër jep asistencën e saj për plotësimin e dokumentacionit për aplikim për ato subjekte që kanë nevojë.

**V Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Buxheti ne mije lek</b>	<b>Realizimi 12-mujori 2019 ne mije lek</b>
P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjise se zhvillimit të Bashkisë Shkodër	-	Ne proces
P04130.O1.A4. Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLOad)	1.268	1268
P04130.O1.A5. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian, Organizata të tjera ndëkomëtare si dhe anetaresimi ne shoqata nderkombetare.	809	89
P04130.O1.A6. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Europian nepermjet Kendit te BE Shkoder,	67	29
P04130.O1.A7. Informimi ne menyre periodike per publikun dhe grupet e tjera te interesit per procesin e Integritimit Evropian, Kendi BE Shkoder,	-	Organizohen aktivitete te vazhdueshme gjate gjithë vitit
P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër	300	Aktivitet i perealizuar
P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative	900	862
P04130.O2.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)	1.440	1.062
P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB	1.738	1.238
P04130.O3.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web te Bashkise	-	Ne proces te vazhdueshem
P04130.O3.A4. Publikim i katalogut te produkteve te territorit te Bashkise Shkoder	300	Aktivitet i perealizuar
P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori	1,600	1.600
P04130.O4.A2. Krijimi i Zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër	1.000	Aktivitet i perealizuar
P04130.O4.A3. Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekszistuese.	-	Ne proces te vazhdueshem te mbeshtetjes se subjekteve te interesuara
P04130.O4.A4. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.	-	Ne proces te vazhdueshem te mbeshtetjes se subjekteve te interesuara



## Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

### I Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2019 ne programin 04160 “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” ka fokusuar përpjekjet e saj në 1 funksion zhvillimi

- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Objektivat për perbushjen e ketyre funksioneve per 12-mujorin e pare te vitit 2019 janë:

O1. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës

### II Rezultatet e programit: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Programi 04160	Paga + Sigurime	Shpenzime operative	Subvencione	Transferta	Investime	Totali
Plani 2019	0	500	0	0	0	500
Realizimi 8-mujor 2019	0	494	0	0	0	494

### III Realizimi i treguesve te performancës

Kodi i Programit	4160	Emertimi i programit:	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi					Komente
Qellimi 1	Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash.						.....	
**Treguesit e performancës/Produktet:								
*Objektivat e politikës*:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shijes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës.	O1	• Rehabilitim/ mirembajtje e tregjeve.	0	1	1	1	100%	
							Rehabilitimi i tregut i realizuar, likuidimi i shpenzimeve operative të planifikuara deri në fund të vitit i realizuar	

### IV Realizimi i produkteve për vitin 2019

Programi	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	Kodi i Programit	4160
----------	---	------------------	------

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
			Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia Faktike (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III				
B	rehabilitim I tregjeve	nr tregjesh	0	0	0	1	500	500	1	500	500	1	494	494	494	-6	-6	ka perfunduar dhe eshte likuiduar aktiviteti ne kohe

Gjatë vitit 2019 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04160 Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

**P04160.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve egzistuese**

Tregjet ekzistuese dhe ato të reja që do ndërtohen e kanë të domosdoshme mirëmbajtjen e tyre sepse ato amortizohen. Më shumë duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambienteve fizike të tregjeve duke parashikuar riparime në infrastrukture e tezgave, banakeve,lyerje. Mirëmbajtje të hapësirave për automjetet dhe këmbësoret gjithashtu duhen parashikuar mirëmbajtje te vazhdueshme në banjo publike, eletricitet, uje etj. Riparime në ambjentet e magazinimit te mallit etj. I njeiti model mirëmbajtje duhet të funksionojë pastaj edhe për tregjet e reja që do ndërtohen, në mënyrë që të qëndrojnë përherë brenda standarteve të mira të tregtimit. Per kete arsye eshte planifikuar edhe aktiviteti ne fjale, i cili eshte i shtrire edhe ne vitet ne vazhdim. Konkretisht eshte tenderuar dhe eshte likujduar aktiviteti i mirembajes se dyerve te tregut si dhe jane likujduar cdo muaj detyrimet e energjise eletrike.

**V Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Buxheti ne mije Leke</b>	<b>Realizimi 12-mujor 2019 ne mije Leke</b>
P04160.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve egzistuese	500	494

## Programi 04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve

Ky program përfshin institucionet:

1. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve

Qëllimi i programit:

1. Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera . Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e te kategorive te tjera te resurseve. Nxitja, përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të organizatave, shoqatave dhe kooperativave të prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare. Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore te granteve per zhvillimin rural te financuara nga buxheti lokal dhe /ose me bashkefinancim nga te trete.

Objektivat e programeve buxhetore për përmbushjen e këtyre qëllimeve për 8-mujorin e pare 2019 kanë qënë:

P04220.O1. Krijimi i sistemit te informacionit per administrimin, perdorimin e tokes mbeshtetur ne teknologji bashkekohore. Plotesimi i dokumentacioneve perkatese te pronesive private.

P04220.O2. Krijimi i databazës së informacionit bujqësor. Krijimi i struktures keshillimit bujqesor.

P04220.O3. Perthithja e granteve nga programet per zhvillimin e bujqesise dhe te zhvillimit rural.

P04220.O4. Trajtimi veterinar i kafsheve te rruges. Ngritja dhe funksionimi i strehezes per kafshet e rruges.

Programi P04220	Paga+ Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencione	Transferta	Investime	Totali
<b>Plani fillestar 2019</b>		2,424				<b>2,424</b>
<b>Plani i rishikuar 2019</b>		2,424				<b>2,424</b>
<b>Realizimi i vitit 2019</b>		972				<b>972</b>

Realizimi i shpenzimeve operative ne programin P04220 duke e krahasuar me planifikimin është 40%.

-Faktoret qe kane ndikuar ne mosrealizimin e fondeve te planifikuara.

1. Për krijimin e kadastrës bujqësore dhe arshivës ka qënë e nevojshme paisja /terheqja e dokumentacioneve nga Z.V.R.P.P. Shkodër, kundrejt pagesës, por nuk është arritur të finalizohet për arsye të mungesës së kapaciteteve në burime njerezore nga ky institucion. Jemi në pritje të përmbushjes së këtij objekti.

**ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"**

Emri i Grupit	.....	Kodi i Grupit	.....
Programi	Sherbimet Bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve	Kodi i Programit	4220

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/P roduktit	Njësia matedese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente		
					Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = I - I		V = I - II	V = I - II
A1	Nr. Qen te trajtuar ( trajtim, sterilizim, vaksinim)	Nr.	170	700	4	225	1,000	4	225	1,000	4	225	972	4	0	0	0	.....

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

Periudha e Raportimit: 01.01.2019-31.12.2019

Kodi i Programit	4220	Emertimi i programit:	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve					Komente
Qellimi 1	Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmje tprojekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokavebujqesore si dhe të kategorive të resurseve të tjera. Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës ekzistues, dhe zgjerimi i tyre në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Shkodër. Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve. Nxitja, përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të organizatave, shoqatave edhe kooperativave të prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare.						.....	
<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>								
<b>*Objektivat e politikës*:</b>	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<b>Objektivi 1</b>								
Perthithja e granteve nga programet per zhvillimin e bujqesise dhe te zhvillimit rural	O3.A1	Nr. i përfituesve (nr. përfitues individual, nr. Sh.B.B), nr. agropërpunues) në programet e mbështetjes nga donatorët për promovimin dhe bashkëpunimin në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural;	65	150	150	95	63%	.....
<b>Objektivi 2</b>								
Trajtimi veterinar i kafsheve te rruges. Ngritja dhe funksionimi i strehezes per kafshet e rruges.	O4.A1	Nr i qenve në rrugë qe perfitojne sherbime dhe trajtohen.	170	225	225	225	100%	

-Produktet për periudhen Janar-Dhjetor 2019 janë:

**P04220.O1.A1** Krijimi i kadastrës bujqësore dhe arshives së saj dhe futja në sistemin e zonave të parilevuara. Të dhënat në regjistrin e pronave bujqësore rezultojnë të jenë me mangësi dhe informacione të pjeshme në lidhje me të dhënat kadastrale. Në këtë kuadër është punuar për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm dhe është arritur të sigurohet rreth 80% e listës së familjeve përfituese të tokës në pronësi (Formulari 06) të Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër, gjithashtu është siguruar lista e pronarëve të trojeve dhe shtëpive (Formulari 01), Harta kadastrale 1: 5000 të Njësive Administrative malore etj.

**P04220.O1.A3** Mbeshtetja e regjistrimit të pronave me shpenzimet e Bashkisë.

Në zbatim të ligjit Nr. 111/2019 "Për kadastrën", VKM nr 994 datë 09/12/2015, VKM nr.253 datë 06.03.2013 dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, Drejtoria e Bujqësisë që në krijimin e saj ka nisur dhe vazhduar punën për procedurat e kalimit në pronësi të tokës bujqësore për ish kooperativat bujqësore dhe ish ndërmarrjet bujqësore.

Puna për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve funksionale ka konsistuar në:

Verifikim i kërkesave për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore dhe dërgim pranë Z.V.R.P.P. për regjistrim të pasurisë, arkivimi i kopjes së praktikës, regjistrimi në sistemin praktikës A.M.T.P. së përpunuar për çdo subjekt kërkuar që ka kryer aplikimin nëpërmjet Zyrës me Një Ndalesë (Z1N).

Krijimi, regjistrimi dhe azhurnimi i përditshëm i një databasë të të gjitha aplikimeve për verifikimin dhe përcjelljen e praktikave për regjistrimin në pronësi të tokës bujqësore pranë Z.V.R.P.P. Shkodër.

Për 8-mujorin 2019 numri i praktikave për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore të përpunuara nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP është:

- -aplikime të përpunuara 1108 praktika nga të cilat:
- -përcjellë pranë Z.V.R.P.P. Shkodër për regjistrim - 743 praktika
- -Kthyer përgjigje për plotësim të mëtejshëm dokumentacioni - 365 praktika

Për sa i përket zbatimit të ligjit Nr 171/2014 "Për përfundimin e Procedurave Ligjore të Kalimit të Tokës Bujqësore të Ish-Ndërmarrjeve Bujqësore në Pronësi të Përfituesve", V.K.M. 253 datë 06.03.2013 "për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish kooperativave bujqësore" afati përfundimtar i aplikimeve ka qenë data 31.12.2019, ku janë depozituar 935 kërkesa të përfituesve të cilët nuk janë paisur me A.M.T.P. pranë Njësive Administrative. Deri tani është kryer verifikimi paraprak i praktikave të dorëzuara dhe në rastet kur ka pasur pasaktësi në dokumentacionin e kërkuar aplikantit të plotësojë mangësitë si dhe kthyer përgjigje për rastet kur nuk plotësojnë kriteret për vazhdimin e procedurës (Dispononin AMTP etj.)

Gjithashtu përgjatë vitit, ka vijuar procesi për verifikimin dhe konfirmimin e kërkesave (sipas plan riveimeve) me institucione të tjera, mbështetur në hapat që përcakton V.K.M. Nr. 337, datë 22.04.2015 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve" i ndryshuar.

Në përfundim të afishimeve 15 ditore pranë Njësive Administrative, ripërpunimeve të materialeve hartografike, hartimeve të relacioneve përkatëse ka vazhduar plotësimi i detyrimit të përcaktuar në ligj për korespondencën me institucione (ATP, ALUIZNI, DAMT, ZVRPP, AREB etj). Në mbarim të kësaj faze, gjatë së cilës janë krijuar vonesa dhe mungesa në përgjigje nga disa nga këto institucione Drejtoria e Bujqësisë ka përgatitur materialin e plotë për paraqitje pranë Këshillit Bashkiak për miratim pjesor për 12 fshatra (Pentar, Mali i Gjymtit, Darragjat, Rrenc, Juban, Shtoj i Vjeter, Bardhaj, Grude e Re, Guci e Re, Berdice e Siperme, Berdice e Madhe, Berdice e Mesme)

Për këtë janë derguar në Këshillin Bashkiak për miratim Projekt-Vendimi dhe Relacioni përkatës për fshatin Pentar Nj.A. Dajç , me nr. 11216 Prot. datë 27.06.2019 , Projekt-Vendim i cili është marrë në shqyrtim por nuk është miratuar për mungesë kuorumi të Këshillit Bashkiak.

Ky projek-vendim u miratua në mbledhjen e muajit Tetor me V.K.B. Nr. 13 datë 09.10.2019.

Ky vendim është kthyer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër me nr. 1138/3 Prot. datë 23.10.2019 për përputhjen e pasurive sipas hartës dhe zërit kadastral të hartave të D.A.M.T.

( kolona shtesë)

Mbasi u kryen saktësimet e kërkuara projekt-vendimi është ridërguar për miratim në Këshillin Bashkiak me nr. 19428 Prot. datë 12.11.2019 në mbledhjen e radhës të datës 30.11.2019 , mbledhje e cila u ndërpre dhe do vijojë shqyrtimi dhe miratimi në një datë që do përcaktohet.

Është dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak relacioni dhe projekt-vendimi për fshatrat:

- Bardhaj

Relacion, projekt-vendim me nr. 17835 Prot. datë 21.10.2019

- Shtoj i Vjetër

Relacion, projekt-vendim me nr. 17835 Prot. datë 21.10.2019.

Projekt-vendimet u miratuan në mbledhjen e datës 30.11.2019.

Janë dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak me datë 21.10.2019 relacionet dhe projekt-vendimet për fshatrat:

- Darragjat

Relacion , projekt-vendim me nr. 17834 Prot. datë 21.10.2019

- Mali i Gjymtit

Relacion , projekt-vendim me nr. 17834 Prot. datë 21.10.2019

- Grudë e Re

Relacion , projekt-vendim me nr. 17836 Prot. datë 21.10.2019

- Guci e Re

Relacion , projekt-vendim me nr. 17836 Prot. datë 21.10.2019

- Bërdicë e Madhe

Relacion , projekt-vendim me nr. 17838 Prot. datë 21.10.2019

- Bërdice e Mesme

Relacion , projekt-vendim me nr. 17838 Prot. datë 21.10.2019

- Bërdicë e Sipërme

Relacion , projekt-vendim me nr. 17838 Prot. datë 21.10.2019

- Juban

Relacion , projekt-vendim me nr. 17837 Prot. datë 21.10.2019

- Rrenc

Relacion, projekt-vendim me nr. 17837 Prot. datë 21.10.2019

Në mbledhjen e radhës të datës 30.11.2019 , Projekt-vendimet e mësipërme nuk u morën në shqyrtim për shkak të ndërprerjes së mbledhjes. Shqyrtimi dhe miratimi i këtyre do realizohet në një datë që do përcaktohet nga Këshilli Bashkiak.

Për pjesën e mbetur të aplikimeve për paisje me AMTP , nga ASHK, ( ZVRPP, ALUIZNI ) nuk është kthyer përgjigje dhe i ka kaluar afati ligjor . Mbas dërgimit të përsëritur të kërkesave nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë ( nr.18417 Prot. datë 29.10.2019 , Nr. 18416 Prot. datë 29.10.2019 , nr. 19381 Prot. datë 11.11.2019 , nr. 21783 Prot. datë 17.12.2019 , dërguar dhe për dijeni Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ) përgjigjet kanë ardhur me datë 07.01.2020.



Theksojme se gjatë realizimit të këtij procesi është mbajtur korespondence e përjavshme me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si institucion përgjegjes për monitorimin dhe menaxhimin e ecurisë së këtij procesi.

**P04220. O4.A1** Trajtimi veterinar i kafsheve të rrugës

Në funksion të ushtrimit të detyrave funksionale të përcaktuara me ligj shërbimi veterinar i Bashkisë Shkodër ka si detyra kontrollin e thertoreve dhe tregjeve të tregtimit të bagëtive dhe plotësimin në çertifikata shëndetësore veterinarë. Për këtë është ushtruar monitorim dhe kontrole të vazhdueshme në tregjet e gjësë së gjallë dhe thertoreve. Janë kontrolluar, vulosur dhe shoqëruar me çertifikatë shëndetësore veterinarë 6309 therje në thertore. Gjithashtu ka pasur bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Veterinar Rajonal për kontrollin e perjavshëm në tregjet e gjësë së gjallë.

Në vijim të punës së saj Drejtoria e Bujqësisë, në bashkëpunim me strukturat e Inspektoriatit Shtetëror Veterinar Rajonal ka bërë të mundur gruposjen e kafshëve të ngordhura në mënyrë periodike sipas rasteve të paraqitura si dhe në bashkëpunim po me këtë inspektoriat dhe Agjencinë e Zonave të Mbrojtura, Policinë e Shtetit dhe Prefekturën Shkodër ka bërë të mundur evidentimin, gruposjen dhe dezinfektimin e një numri të konsiderueshëm shpendesh të ngordhur të hedhura në menyre abuzive në lumin Buna.

Bashkia Shkodër ka që nga viti 2016 dhe në vazhdim që trajton me seriozitetin maksimal problematikën e qenve endacakë, në territorin e Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me shoqatat e mbrojtjes së kafshëve ka bërë të mundur trajtimin e qenve endacakë. (Këtu përfshihet kapja, vaksinimi, sterilizimi, matrikullimi, dehelmetizimi si dhe trajtime të ndryshme antiparazitare të këtyre kafshëve). Dhe konkretisht për vitin 2019 janë trajtuar 255 qenë.

Aktiviteti	Buxheti fillestar në 000/lekë	Buxheti korrigjuar në 000/lekë	Realizim 12-mujori 2019 në 000/lekë
P04220.O1.A1-Krijimi i kadastres bujqësore dhe arshives së saj dhe futja në sistem e zonave të parilevuara	904	904	0
P04220.O1.A2-Database i dedikuar për të dhëna të kadastres rurale.	0	0	0
P04220.O1.A3-Mbeshtetja e regjistrimit të pronave me shpenzimet e Bashkisë	520	520	Ne proces
P04220.O2.A1-Krijimi i informacionit bujqësor	0	0	0
P04220.O2.A2-Sigurimi i mbeshtetjes së fermerëve për agroindustrinë, treg dhe marketing	0	0	0
P04220.O2.A3-Promovimi dhe krijimi i SHBB ose grupeve prodhuese e tregtuese	0	0	0
P04220.O2.A4-Promovim produktesh bujqësore dhe blegtorale nepermjet panairëve	0	0	0
P04220.O3.A1-Promovim dhe asistencë teknike në hartim projekte, plan biznesi për perthithje të granteve.	0	0	0
P04220.O4.A1. Trajtimi i qenve të rrugës.	1,000	1,000	972
<b>Totali</b>	<b>2,424</b>	<b>2,424</b>	<b>972</b>

## Programi 04240: Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit

Ky program përfshin institucionet:

1. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve
2. Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore

Qëllimet e programit:

2. Administrimi, shfrytëzimi dhe mirembajtja e infrastruktures së ujitjes dhe kullimit.

Objektivat e programeve buxhetore për përmbushjen e këtyre qëllimeve për 12-mujorin 2019 kanë qënë: P04240.O1 Permiresimi i sistemit te ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit.

Programi P04240	Paga+ Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencione	Transferta	Investime	Totali
<b>Plani fillestar 2019</b>	11,736	21,628		0	11,000	<b>44,364</b>
<b>Plani i rishikuar 2019</b>	11,685	21,628		51	25,510	<b>58,874</b>
<b>Realizimi 12-mujori 2019</b>	11,130	19,931		0	25,067	<b>56,128</b>

Realizimi i shpenzimeve ne programin P04240 duke e krahasuar me planifikimin është si më poshtë:

Shpenzime të personelit : 95.25 %

Shpenzime operative : 92.15 %

Shpenzime kapitale 98.26 %

**Totali i shpenzimeve realizuar : 95.3 %**



Realizimi i produkteve te performances.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2019-31.12.2019

Kodi i Programit	4240	Emertimi i programit:	Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit					Koment e
Qellimi 1	Administrimi, shfrytezimi dhe mirembajtja e infrastruktures se ujitjes dhe kullimit						.....	
	<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>						.....	
*Objektivat e politikës*:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Permiresimi I sistemit te ujitjes dhe kullimit. Ndertim ose organizim I sistemeve te kontrollit te permbytjeve, sistemeve te ujitjes dhe kullimit	O1.A3	Fuqizimi I strukturave menaxhuese ne funksion te ujitjes dhe kullimit te tokave bujqesore	6	9	9	0	0%	
	O1.A5	km kanale ujitjes mirembajtur	18	20	20	21.7	109%	
	O1.A5	Siperfaqe Ha permiresuar ujitja	680	750	750	780	104%	
	O1.A5	Km kanale kullues mirembajtur	106	175	175	147	84%	
	O1.A5	Siperfaqe Ha permiresuar kullimi	3003	4420	4420	4380	99%	

Realizimi i produkteve

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treqesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	.....	Kodi i Grupit	.....															
Programi	Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	Kodi i Programit	4240															
	ne 000/leke				I			II			III			IV	Luhatjet ne Koston per Njesi			
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesi a mate se	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne funde vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne funde vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne funde vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	Komente
A1	Menaxhimi dhe funksionimi i D.SH.B.P paga+sig.shoq	nr. punjones	19	11,242	592	20	11,736	587	20	11,736	587	20	11,209	560	-31	-26	-26	.....
A1/1	Menaxhimi dhe funksionimi i D.SH.B.P shpenz. Operative	liter	10,179	1,811	0.178	9,916	1,765	0.178	9,916	1,765	0.178	5,730	1,020	0.178	0	0	0	.....
A2	Permiresimi dhe fuqizimi I parkut te mjeteve te D.Sh.B.P	nr. Mjete	0	0	#DIV/0!	1	11,000	11,000	1	11,000	11,000	1	11,000	11,000	#DIV/0!	0	0	.....
A3	Nxitja e krijimit te Shoqatave te perdoruesve te ujit ne çdo Nj.A dhe trainimi i tyre	nr. Shoqata	0	0	#DIV/0!	9	306	34	9	306	34	0	0	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
A5	Pastrim kanalesh kulluese dhe ujitese ne Nj.A.	km	106	12,229	115	175	12,229	70	175	12,229	70	147	12,224	83	-32	13	13	
A6	Mirembajtje e skemes ujitese	km	8	6,721	840	20	7,328	366	20	7,328	366	22	7,041	320	-520	-46	-46	.....

Produktet për periudhen Janar-Dhjetor 2019 janë:

**P04240.O1.A5** Pastrim kanalesh ujitesë dhe kulluese për NjA

Gjatë vitit 2019 Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP dhe Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ( si institucion varësie) ka ushtruar veprimtarinë në realizimin e qëllimit :Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit:

Hartimi i projekteve të ndërhyrjes për pastrim/reabilitim të Kanaleve Kullues bazuar në Planifikimin e miratuar në Planin e Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit , ndërhyrje pastrimi dhe vendosje në gjënde funksionale të K.K. të dyta dhe të treta.

Sistemi i kullimit, si pjesë e rëndësishme e programit dhe objektivave, vazhdon të jetë prioritet i Bashkisë Shkodër në fushën e bujqësisë.

Mbështetur në Planin e Veprimit për ndërhyrje në sistemin kullues për vitin 2019 janë hartuar projektet teknike për 134 kanale kulluese dhe përfunduar ndërhyrja e pastrim/mirëmbajtje për 122 kanale kulluese Gjatësia totale e ndërhyrjes prej 147 km me një sipërfaqe të përmirësuar kullimi prej 4380 Ha dhe volum punimesh prej 149.768 m<sup>3</sup>, si dhe blerja dhe vendosja e 187 tombinave.

<b>Aktiviteti</b>	<b>Buxheti fillestar në 000/lekë</b>	<b>Buxheti korrigjuar në/000 lekë</b>	<b>Realizimi Viti 2019 në 000/ lekë</b>
P04240.O1.A1 - Menaxhimi dhe funksionimi i D.SH.B.P	13,501	13,501	12,150
P04240.O1.A2-Permiresimi dhe fuqizimi i parkut te mjeteve te D.Sh.B.P	11,000	11,000	11,000
P04240.O1.A3-Nxitja e krijimit te Shoqatave te perdoruesve te ujit ne çdo Nj.A dhe trainimi i tyre	306	306	0
P04240.O1.A5-Pastrim kanalesh kulluese dhe ujitesë ne Nj.A.	12,229	12,229	12,225
P04240.O1.A6- Mirembajtje e skemes ujitesë	7,328	7,328	6,686
P04240.O1.A7- Kanali Ujites KU-21	0	14,510	14,067
<b>Totali</b>	<b>44,364</b>	<b>58,874</b>	<b>56,128</b>

## Programi 04260 - Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

### Qëllimi i këtij programi është:

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
- Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;
- Administrim i fondit pyjor dhe kullor publik;
- Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh.
- Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
- Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;
- Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes;
- 

### Përshkrimi i objektivave

O1: Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullor brenda territorit administrativ të bashkisë.

O2. Hartimi / Rishikimi i Planeve të mbareshtimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullor 43.806 ha.


O3. Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore/kullorë ,të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni ( Projektim/Investim).

### Rezultatet e Programit Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

Programi 04260	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferime	Investime	Totali
<b>Plani fillestar 2019</b>	10,273	4,357		0	5,446	<b>20,076</b>
<b>Plani i rishikuar 2019</b>	10,230	4,357		43	5,446	<b>20,076</b>
<b>Realizimi 12 - mujorit të 2019</b>	9,133	4,078		43	0	<b>13,254</b>

Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për këtë program. Duke e krahasuar me planifikimin është:

Paga dhe Sigurime	89.2%
Shpenzime Operative	93.6%
Investime	100%
<b>Total</b>	<b>66%</b>



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

1. Shpenzimet operative të planifikuara janë duke ecur sipas planifikimit disa prej aktiviteteve janë në procedurë likuidimi kurse disa të tjera janë në proces.
2. Investimet janë duke ecur sipas planifikimit vjetor dhe janë në procedure.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

Periodha e Raportimit: 01.01.2019-31.12.2019

Kodi i Programit	4260	Emertimi i	Administrimi i pyjeve dhe kullotave					Komente
Qellimi	Administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.						.....	
<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>								
<b>*Objektivat e politikës*:</b>	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances**/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes 2018	Niveli i planifikuar ne vitin korent 2019	Niveli i rishikuar ne vitin korent 2019	Niveli faktik ne 12 mujor 2019	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<b>Objektivi 1</b>								.....
<i>Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullor brenda territorit administrativ të bashkisë</i>		Administrata funksionale per realizimin e mbrojtjes se	14	14	14	14	100%	.....
<b>Objektivi 2</b>								.....
<i>Hartimi / Rishikimi i Planeve te mbareshimit per te gjitha siperfaqen e fondit pyjor dhe kullor</i>		Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit/hatimit te Përgatitje e materialeve për Regjistrimi dhe inventarizimi i pyjeve	20%	28%	28%	28%	100.00%	hartuar dokumentacioni/nuk u paraqit asnje subjekt
			563	540	540	679	126%	Realizuar Inventarizimi I pyjeve miratuar me VKB 6 dt 04.02.2020
<b>Objektivi 3</b>								.....
<i>Rehabilitimi dhe pyllëzimi i siperfaqeve pyjore/kullorore ,te degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokes nga erozioni ( Projektim/Investim).</i>		Projektim/Investim, Rehabilitimi nga demtimi i siperfaqeve	1	1	1	1	100	
		Projektim/Investim pyllëzim i siperfaqeve	1	1	1	1	100	
		Projektim/Investim Mbrojtje e tokes nga	531	531	540	0	0	Hartuar projekti/ nuk eshte realizuar investimi
		Projektim/Investim pastrim /permiresim	11	12	12	12	100	Hartuar projekti/ realizimi ne proces
		Projektim/investim luftim i semundjeve ne	5	10	10	10	100	hartuar projekti/ realizimi ne proces
		Investime per menaxhim te fondit kullor (5300	2	2	2	0	0%	Hartuar projekti /nuk eshte realizuar investimi



**ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"**

<b>Emri i Grupit</b>	Bashkia Shkoder	<b>Kodi i Grupit</b>	141
<b>Programi</b>	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	<b>Kodi i Programit</b>	04260:

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit 2018)	Shpenzimet (sipas vitit 2018)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komentet		
					Kosto per Njesi (sipas vitit 2018)	Sasia (sipas planit te vitit 2019)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2019)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit 2019)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit 2019)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit 2019)	Kosto per Njesi Faktike (ne 12 muajt e vitit 2019)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III				
1	Administrata funksionale per realizimin e mbrojtjes se 43.800 ha pyje e kullota gjithesej	numer	14	8,028	573	14	9,217	658	14	734	52	14	8,723	623	50	-35	571	
2	.Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit/hatimit te Planit te menaxhimit per NJA Shosh /Postribe. ( Gjithesej 13765 ha)	%	20	0	0	28	0	0	20	0	0	28	0	0	-573	0	0	Realizuar procedura e tenderit. Nuku paraqit asnje ofertues. Buletini I PP nr 12/2019

3	Përgatitje e materialeve për Regjistrimi dhe inventarizimi i pyjeve dhe kullotave -NJ A Guri i Zi ,Rrethina Berdice 6.000 ha ose 27% e totalitt	numer	563	0	0	540	0	0	540	0	0	679	0	0	0	0	0	Realizuar Inventarizimi Miratur me VKB nr 6 dt 04.02. 2020
4	Projektim/Investim, Rehabilitimi nga demtimi I siperfaqeve pyjore . Gurore me siperfaqe rreth 10ha ( tarabosh).	numer	1	0	0	1	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0	
5	Ndertim prita malore ne zonat pyjore	m3	531	0	0	540	0	0	540	0	0	0	0	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	
6	Hartim projekte teknike per Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Pult ,Shale ,Shosh ( siperfaqet e djegura)	numer	0	0	#DIV/0!	1	0	0	1	0	0	1	0	0	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	
7	Projektim/Investim pastrim /permiresim parcela pyjore. (1500 ha)	ha	11	1,011	92	12	1,040	87	12	1,040	87	12	1,020	85	-7	-2	-2	
8	.Sinjalistike pyjore ne zonat pyjore te NJA	numer	10	174	17	10	208	21	10	208	21	10	106	11	-7	-10	-10	
9	Projektim/investim luftim i semundjeve ne pyje (2060)	ha	5	414	83	10	1,000	100	10	1,000	100	10	986	99	16	-1	-1	.....
10	Investime per menaxhim te fondit kullosor (5300 ha).	numer	2	817	409	2	1,075	538	2	1,075	538	0	0	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	.....

### **Realizimi i Produkteve të Programit.**

Për vitin 2019 në “Programin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar produktet si më poshtë:

#### **P04260.O1.A1 Administrimi i sherbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër.**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Shkodër, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5..

Në përmbushje të detyrimit ligjor Bashkia Shkodër gjatë vitit 2019 punon për konsolidimin e shërbimit të Administrimit të pyjeve /kullotave nëpërmjet formimit të strukturës për administrim dhe menaxhim të këtij fondi pyjor. Është plotësuar struktura e Sektorit të Pyjeve pranë DSHBP me specialiste/teknike në funksion të konsolidimit të shërbimit të Administrimit të pyjeve /kullotave.

#### **P04260.O1.A2.Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullimore/shërbimi pyjor.**

Realizimi i mbrojtjes së siperfaqeve pyjore/kullimore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullor, për këtë gjatë vitit 2019 janë parashikuar për tu realizuar Kontratat e Punës për 10 Vrojtues të cilët mbulojnë Ekonomitë Pyjore si më poshtë : 1 vrojtues NJA Shosh për EP Shosh 1,2, 2 vrojtues NJA Pult për EP Brucaj, Ugina e Kirit, 3 vrojtues për NJA Postribë ,EP Ura Shtrenjt, Prekal, DrishtNdermolla, Lodërtunë ,Vilzë , 2 vrojtues NJA Shalë , EP Shalë1 dhe Shalë 2 , “ Vrojtues për NJA Guri i Zi për EP Pruemos-Sheldi , Rosek-rrjoll Shllak1. Këto kontrata janë realizuar dhe aktualisht punonjësit janë në krye të detyrës. Deri në momentin që raportohet në territorin e Bashkisë Shkodër sipërfaqe pyjor/kullimore nuk ka pasur asnjë rast zjarri.

Janë ngritur njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve pranë NJA Guri i Zi, Postribë, Pult, Shosh , Shalë.

#### **P04260.O2.A1 .Mbledhje e informacionit / përgatitje materialesh për realizimin e rishikimit/hatimit të Planit të menaxhimit për NJA Shosh /Postribe. ( Gjithesëj 13765 ha)**

Gjatë vitit 2019 në bashkëpunim me kadastrën e sektorit të pyjeve pranë DSHBP janë parashikuar zonat pyjore të cilat nuk kanë qene pjese e Planit të menaxhimit të ish Komunes Shosh si edhe problematikat verejtura. Kështu është bërë gati informacioni për të rishikuar/hartuar Planin e ri të menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave të kësaj NJA.

U realizuan termat e referencës për hartimin e Planit të Menaxhimit të për NJA Shosh , për Ekonomitë Pyjore Shosh 1 dhe Shosh 2, me shkresën nr 858/b dt 06.03.2019 është bërë Marrja e angazhimit për kryerjen e shpenzimit publik të planifikuar, u bë shpallja publike në buletin e APP nr 12/2019 dhe nuk pati asnjë ofertues , ky njoftim u ripërsërit por përsëri nuk pati ofertues.

#### **P04260.O2.A2: Përgatitje e materialeve për Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit të Pyjeve dhe kullotave bashkiake.**

Janë rishikuar kufijtë e zonave pyjore të të gjitha Ekonomive Pyjore e Kullimore. Regjistrimi i pronave Pyje/Kullota referuar shkresës nr 5548/1 dat 06.07.2018 të K/Regjistruesit Tirane , ka filluar të kryhet në kuader të Projektit të BB për Sherbimet Mjedisore , projekt i cili administrohet nga MMT. Duke ndjekur këtë procedurë verifikimi për sejcilën parcelë u realizuar “ Lista e inventarit për pasuritë pyje dhe kullota që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Shkodër sipas listës bashkëlidhur me numër rendor 1 deri në 2302” , e cila do të shërbejë për ndryshimin e VKM 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë të Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”.

Referuar këtij azhurnimi janë shtuar 2 Ekonomi Pyjore/Kullimore për vec 14 Ekonomive që ishin transferuar me VKM 433/2016 , janë shtuar Ekonomia Pyjore Tarabosh dhe Ekonomia Pyjore Cukal. Gjithashtu janë shtuar rreth 28 parcela pyjore/kullimore të cilat mungonin në inventarin e mëparshëm.

Në total nga ky azhornim sipërfaqja e pyje/kullota arrin në 48.689,09 ha ndërkohë që sipërfaqja e mëparëshme ishte 43.806,80 ha, pra rezulton me një shtesë prej 4802.29 ha.

**Me Vendim të Keshillit të Bashkisë Shkodër nr 6 datë 22.01.2020 është bere miratimi i ketij inventarizimi dhe eshte derguar prane Ministrise Turizmit e Mjedisit.**

#### **P04260.O3.A1.Hartim i projektit " Rikualifikimi mjedisor/social i guroveve ne malin e Taraboshit.**

Projekti i Rehabilitimit Mjedisor të Gurores e cila ndodhet në zonën e Shirokës ul rrezikshmërinë e rrëshqitjeve masive të dheut, shton sipërfaqet e gjelbërta duke përmirësuar cilësinë e ajrit dhe duke krijuar edhe një fasadë të gjelbër për zonën.

Është realizuar Projekti i Zbatimit për “ Rehabilitimin mjedisor të Gurores” i cili parashikon të përmbajë punime të tilla si , hapje gropa me matrapik për mbjellje pemë kacavjerrëse ndërtim mure dekorative , vendosje rrjete peshku për instalimin e bimëve kacavjerrëse si nga poshtë edhe nga lart etj.

#### **P04260.O3.A2. Ndertim prita malore ne zonat pyjore**

Ne vijimesi të punës për luftimin e erozionit nëpërmjet ndërtimit të pritave me mur guri të thatë, të cilat parashikohen të ndërtohen kryesisht në përrenj malorë. Realizimi i projektit do të beje ruajtjen e tokes nga erozioni dhe ka ndikim ne permiresimin e situates mjedisore e sociale.

Është përcaktuar zona ku do të ndërtohen këto prita ( përroi i Bistallës) për të cilat është hartuar projekti. Nuk është kryer akoma marrja e angazhimit per realizimin e shpenzimit publik.

#### **P04260.O3.A3 Hartim projekte teknike per Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Pult ,Shale Shosh ( siperfaqet e djegura)**

Për vitin 2019 parashikohen projektet për Pyllezim/ripyllëzim të sipërfaqeve pyjore të cilat janë përshkuan nga zjarri në vitet e mëprshme. Është hartuar projekti pyllëzimit i gatshëm për investim.

#### **P04260.O3.A4 Pastrimi/permiresimi I parcelave pyjore.**

Me ane të permiresimit (Rrallime+ Krasitje, pastrim shkurre) arrihet ruajtja e objekteve të veshura me peme nga renia e zjarreve në pyje, ruajtja e filizerisë së re , si edhe përmirësimi i pyjeve në përgjithësi. Janë përcaktuar zonat e ndërhyrjes për realizimin e projektit. Projekti është realizuar .

#### **P04260.O3.A5 .Sinjalistike pyjore ne zonat pyjore te NJA .**

Janë realizuar specififikimet per realizimin e tabelave për sinjalistikën ku përfshihen tabela për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, llojin e pyjeve, ndalimin e prerjes se pyjeve etj. Aktualisht eshte realizuar shërbimi.

#### **P04260.O3.A6.Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne NJA.**

Ky shërbim parashikon ndërhyrje për luftimin e sëmundjeve në pyje si gjethpërdrerësja e cila dëmton drurët pyjorë, ndërkohë ky shërbim do te sjelle permiremiresimin e situates duke rritur fuqine vegetative te drurit. Aktualisht eshte realizuar

#### **P04260.O3.A7. Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota ne NJA**

Parashikohet projektim/ndertim i 2 lerave ekzistuese pra përmirësim i tyre , kjo per grumbullim dhe mbajtje uji te pijshem per blegtorine me kapacitet 205m3 , per te cilat sigurohet uji per nje numer prej rreth 163 krere te imta dhe 15 krere te trasha. Aktualisht është bërë përzgjedhja e vendeve ku do të kryhet ndërhyrja, nuk është realizuar akoma marrja e angazhimit për kryerjen e shpenzimit publik.

**Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.**

<b>Aktivitete/Projekte</b>	<b>Buxheti fillestar ne 000/Leke</b>	<b>Buxheti korrigjuar ne 000/Leke</b>	<b>Realizimi Viti 2019/000 Lekë</b>
P04260.O1.A1 Administrimi i sherbimit te pyjeve dhe kullotave ne Bashkine Shkoder	9,217	9,217	8,723
P04260.O1.A2. Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullosore/sherbimi pyjor	3,165	3,165	2,419
P04260.O2.A1 Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit/hatimit te Planit te menaxhimit për NJA Shosh /Postribe. ( Gjithesej 13765 ha)	1,146	1,146	0
P04260.O2.A2: Përgatitje e materialeve per Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit te Pyjeve dhe kullotave bashkiake.	0	0	Realizuar
P04260.O3.A1.Hartim i projektit " Rikualifikimi mjedisor/social i guroreve ne malin e Taraboshit.	0	0	Realizuar
P04260.O3.A2. Ndertim prita malore ne zonat pyjore.	3,225	3,225	0
P04260.O3.A3 Hartim projekte teknike per Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Pult ,Shale ,Shosh ( siperfaqet e djegura)	0	0	Realizuar
P04260.O3.A4 Pastrimi/permiresimi I parcelave pyjore	1,040	1,040	1,020
P04260.O3.A5 .Sinjalistike pyjore ne zonat pyjore te NJA	208	208	106
P04260.O3.A6.Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne NJA.	1,000	1,000	986
P04260.O3.A7. Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota ne NJA	1,075	1,075	0
<b>Totali</b>	<b>20,076</b>	<b>20,076</b>	<b>13,254</b>

## Programi 04520 - Rrjeti rrugor rural

Shkodra është porta hyrëse e korridorit Veri-Jug (të transportit rrugor), që lidh Shqipërinë me zonën e rrjetit të ardhshëm të korridoreve dhe lidhjeve të tyre të transportit rrugor për Europën Juglindore, ku përfshihen: Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, etj.

Krijimi i territorit të ri administrativ të bashkisë – shumë – qendërsh duke përfshirë qytetin e Shkodrës dhe fshatrat e 10 njësi administrative të tjera në programin e infrastruktures rrugore si funksion i veti do të jetë ndërtimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike të tij.

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

### I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2019 ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi:

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;

Objektivat për secilin funksion janë:

O1. Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve urbane

O2. Rikonstrukcion rrugë dhe sheshe urbane

O3. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

O4. Hartimi i projekteve sipas prioriteteve të përcaktuara në planet e investimeve kapitale të Bashkisë Shkodër

### II Rezultatet e programit 04520: Rrjeti rrugor rural

Programi 04520	Paga + Sigurime	Shpenzime operative	Subvencione	Transferta	Investime	Totali
<b>Plani fillestar 2019</b>	0	30,099	0	0	358,809	388,908
<b>Plani korigjuar 2019</b>	0	34,977	0	0	364,275	399,252
<b>Realizimi vitit 2019</b>	0	34,892	0	0	324,233	347,228

<b>Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit</b>									
Periudha e Raportim it: 01.01.2019-31.12.2019									
Kodi i Programit	4520	Emertimi i	Infrastruktura Rrugore						Komente
Qellimi 1	Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi								
<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>									
*Objektivat e politikës*:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektivi 1.1	Mirembajtja e rrugeve dhe shesheve urbane	P04520.O1.A1	Mirembajtje rruge e	5,216,000	11,519,000	11,519,000	11,434,000	99%	.....
Objektivi 1.2	siguruar lidhjen e te gjitha qendrave te banuara	P04520.O3.A1	Mirembajtje rruge rurale	12,438,444	18,580,000	23,458,000	23,458,000	100%	.....

<b>Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit</b>									
Periudha e Raportim it: 01.01.2019-31.12.2019									
Kodi i Programit	4520	Emertimi i	Infrastruktura Rrugore						Komente
Qellimi 1	Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi								
<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>									
*Objektivat e politikës*:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektivi 1.1	Mirembajtja e rrugeve dhe shesheve urbane								.....
Objektivi 1.2	Rikonstrukjon rruge dhe sheshe urbane	.....	.....	15	22	25	24		.....
Objektivi 1.3	siguruar lidhjen e te gjitha qendrave te banuara	.....	.....	14	19	26	26		.....
Objektivi 1.4	harmiti i projekteve sipas prorneteve te percaktuara ne planet e investimeve kapitale te	.....	.....	29	41	51	50		.....

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Enri i Grupit		Kodi i Grupit	141																			
Programi		Kodi i Programit	4520																			
ne 000/leke				I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente			
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III					
A	Siperfaqe rruge e rehabilituar	m2	12,370	294,915	0	40,852	358,809	0	41,938	364,275	0	36,473	356,123	0	0	0	0	.....				
B	KUB	ml	2,250		0	5,175		0	5,313		0	4,620		0	0	0	0	0	0	0	0	.....
C	KUZ	ml	2,035		0	2,865		0	2,941		0	2,558		0	0	0	0	0	0	0	0	.....
D	Ujesjelles	ml	945		0	2,800		0	2,874		0	2,500		0	0	0	0	0	0	0	0	.....
E	Ndriçim	m2	7,030		0	14,302		0	14,682		0	12,769		0	0	0	0	0	0	0	0	.....
F	Trotuare	m2	1,395		0	2,221		0	2,280		0	1,983		0	0	0	0	0	0	0	0	.....
G	Sinjalislike e plote	m2	31,205		0	58,800		0	60,363		0	52,498		0	0	0	0	0	0	0	0	.....
A	Mirembajtje rruge e trotuare ne qytet	m2	228,506	5,216	0.023	228,506	11,519	0.050	228,506	11,519	0.050	228,506	11,434	0.050	0.027	0	0	.....				
B	Mirembajtje rruge rurale	km2	449.8	12,438	28	449.8	18,580	41	449.8	23,458	52	449.8	23,458	52	24	11	0	.....				



Gjatë vitit 2019 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër

Punimet e mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve në qytet janë kryer në rrugët kryesore dhe dytësore të lagjeve të qytetit.

Me kontratën e shërbimit: “Mirëmbajtja e rrugëve rurale” është realizuar riparimi i shtresave asfaltike në njësitë administrative: Berdice, Dajç, Rrethina dhe Postribe.

Gjithashtu janë kryer punimet për mbrojtjen e rrugës:

- Mbrojtja e rrugës Berdice-Darragjat në njësinë administrative Dajç,
- Riparim I skarpatave të përroit në Qender Oblikë në njësinë administrative Ana e Malit.
- Ndertimi i murit mbajtjes në rrugën Guri i Zi -Vukatanë në njësinë administrative Guri I Zi.

Aktivitete/Projekte	Buxheti fillestar në mijë Lek	Buxheti korigjuar në mijë Lek	Realizimi I vitit 2019 në mijë Lek
P04520.O1.A1 Mirembajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës	11,519	11,519	11,434
P04520.O2.A2. Shpronësime	5,000	5,000	5,000
P04520.O2.A3. Rikualifikim Urban I Hyrjes se Qytetit te Shkodres dheParkutPerPushuesit	32,000	32,000	0
P04520.O2.A4. Rikonstruksion Rruga Mukej	2,762	2,762	2,118
P04520.O2.A5. Rikonstruksion rruga Udhakryq	15,437	15,437	15,355
P04520.O2.A6. Rikonstruksion Rruga Cen Broja	2,746	2,746	2,665
P04520.O2.A7. Rikonstruksion rruge Bahcallek	2,512	2,512	2,305
P04520.O2.A8. Rikonstruksion Degëzime Rruga e “Shirokës”	4,401	8,333	8,182
P04520.O2.A11. Rikonstruksion Rruga "Hoxha Tasim" (degezim)	457	433	410
P04520.O2.A12 Rikonstruksion Rruga "Hamit Gjylbegu"	8,576	8,576	8,419
P04520.O2.A13. Rikonstruksion Rruga "Zabelej"	8,613	8,613	8,391
P04520.O2.A20 Rikonstruksion Rruga “Qazim Hoxha”	5,956	5,956	4,533
P04520.O2.A21 Rikonstruksion Degëzime Rruga At Shtjefën Gjeçovi	3,077	-	-
P04520.O2.A22. Rikonstruksion Rruga “Brioti”	7,701	7,701	7,386
P04520.O2.A26. Rikonstruksion rruga "Lugoçesme"	24,783	24,783	24,783
P04520.O2.A27. Rikonstruksion i rrugës Vehbi Ismaili	1,934	458	383



P04520.O2.A28. Rikonstruksion i rrugës Hafiz Ali Ulqinaku.	1,866	1,504	1,456
P04520.O2.A31. Rikonstruksion Rruga "Kamilo Libardi"	9,937	9,937	7,143
P04520.O2.A32. Rikonstruksion Rruga "Shasi"	9,429	9,429	9,150
P04520.O2.A33. Rikonstruksion Rruga " Zef Kakarriqi"	7,444	6,832	6,693
P04520.O2.A37. Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Qemal Draçini" (pallatiPyjores)	9,696	9,696	7,732
P04520.O2.A38. Rikualifikim Urban blloqe banimi"Qemal Dracini" (tek Sahati)	13,204	13,204	13,194
P04520.O2.A40. Rikualifikim i bllokut urban, rruga Daut Boriçi.	1,878	1,878	1,781
P04520.O2.A44. Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Henrik Laca"	2,667	5,601	5,366
P04520.O2.A47. Rikualifikim urban i bllokut tek ish Divizioni	-	769	642
P04520.O2.A48. Zgjatim i rrjeteve K.U.Z, K.U.B dhe Ujësjellës i "Zef Kakarriqi"Për gjatë rrugës "Mirash Ivanaj"	-	4,023	3,805
P04520.O3.A1. Mirembajtja e rrugëve rurale	18,580	23,458	23,458
P04520.O3.A2. Rikonstruksion Rruga e Shirqit	4,476	4,476	4,475
P04520.O3.A3. Sistemim asfaltim Rrugë të brëndshme fshati "Samrisht i Vjetër".	6,580	6,580	6,181
P04520.O3.A4. Sistemim asfaltim Rruga "Dajçit te ri"-(Shkolla e Mesme Dajç)	6,223	6,223	6,086
P04520.O3.A12. Sistemim - Asfaltim i rrugës "Mollojsve", Bërdicë e Sipërme	4,995	4,995	4,866
P04520.O3.A13. Sistemim - Asfaltim i Rruges se Varrezave te Fshatit Mali –Hebaj	3,557	6,636	6,574
P04520.O3.A14. Sistemim - Asfaltim i rrugës Bërdicë e Sipërme	8,264	8,264	6,903
P04520.O3.A15. Sistemim - Asfaltim i rrugës "Ramoshaj" - Trush	-	729	615
P04520.O3.A17. Rikonstruksion Rrugë VelipojëPlazh	61,097	57,822	57,431
P04520.O3.A18. Sistemim Asfaltim Rrugë të Brendshme Fshati Reç i Ri	-	548	459
P04520.O3.A20. Sistemim Asfaltim Rrugë të Brendshme Fshati Reç-Pulaj	-	513	430
P04520.O3.A21. Sistemim Asfaltim RrugaPrekaj, Fshati Sektor Velipoje	-	619	520
P04520.O3.A22. Sistemim Asfaltim Rrugë te Brendshme Fshati Sektor Velipoje	-	566	475

P04520.O3.A23. Sistemim asfaltim rruga Hamidije, Shtoj i Vjeter	10,946	10,000	9,886
P04520.O3.A24. Sistemim asfaltim rruga nacionale Pika Ada – ByPass	8,778	8,000	7,921
P04520.O3.A25. Sistemim asfaltim rruga Myzyraj Dobraq	6,074	6,074	5,904
P04520.O3.A29. Sistemim asfaltim rruga e varrezave Bardhaj	-	551	475
P04520.O3.A38. Rikonstruksion i rrugës Oblike – Velinaj – Alimetaj, Loti 3	6,228	6,228	6,008
P04520.O3.A39. Sistemim - Asfaltim i rrugës Muriqan-Goricë	6,699	6,699	5,845
P04520.O3.A40. Sistemim - Asfaltim i rrugës Oblike Qender – Lagjja e Re Loti 2	5,737	5,737	4,843
P04520.O3.A45. Rikonstruksioni rrugës Rragam – Sheldi, (Loti 2)	6,308	6,308	5,498
P04520.O3.A46. Sistemim - Asfaltim i rrugës Përmes fshatit Ganjolle	5,000	5,000	4,173
P04520.O3.A47. Sistemim - Asfaltim i rrugëve të brendëshme, fshati Guri i Zi, (Rruga e Xhamise, Loti 1).	6,532	6,532	6,098
P04520.O3.A50. Sistemim - Asfaltim i rrugëve të lagjeve, fshatit Juban (Rruga “Rragame “, Loti 1).	-	713	617
P04520.O3.A58. Sistemim asfaltim rruga "Ura e mesit-Drisht".	6,960	10,500	9,924
P04520.O3.A59. Sistemim asfaltim rruga "Fshat i Rri - Dragoç"	6,516	1,016	738
P04520.O3.A60. Sistemim asfaltim rruga Qender Mes – Kullaj	3,330	3,330	2,119
P04520.O4.A1. Projektim Rikonstruksion rruge Shkoder Qender	500	-	-
P04520.O4.A3. Projekti PARK4SUMP-Veprimet....	1,433	1,433	380
P04520.O4.A4. Projektim Rehabilitim, shtrim dhe asfaltim i rrugëve në Njesi Administrative	500	-	-
P06220.O1.A1. (Kodi i Ministrise) Rikonstruksion I bllokut të Pallateve" Xhabije".	0	11,897	11,897
<b>Totali</b>	<b>388,908</b>	<b>411,149</b>	<b>359,125</b>

## Programi 04570 - Transporti publik dhe lëvizshmëria

Ky program përfshin institucionin e Bashkisë  
Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

-Qëllimi i programit të Transportit publik është:

Për të favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar një kulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik, ne do të përcaktojmë zonat me shpejtësi të limituar 30 km/orë.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2019 kanë qënë:

<b>P08130.O3.A11</b>	Mbështetje e ekipit Çiklizëm meshkuj të rritur.	1,250	1,550	1,514
<b>P08130.O3.A12</b>	Mbështetje e ekipit të Gjymnastikës femra të rritura.	850	850	848
<b>P08130.O3.A13</b>	Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur dhe te rinj.	363	363	351
<b>P08130.O3.A14</b>	Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj te rritur.	540	540	539
<b>P08130.O3.A15</b>	Mbështetje e ekipit te Notit te rritur dhe te rritura.	197	197	195
<b>P08130.O3.A16</b>	Mbështetje e ekipit te peshngritjes meshkuj te rritur.	700	700	682
<b>P08130.O3.A17</b>	Mbështetje e ekipit te Ping - Pong te rritur	137	137	135
<b>P08130.O3.A18</b>	Mbështetje e ekipit te Shahut te rritur.	537	837	828
<b>P08130.O3.A19</b>	Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/të rritura	800	800	796
<b>P08130.O3.A20</b>	Mbështetje e ekipit të boksit femra	200	450	450
<b>P08130.O3.A21</b>	Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja.	300	300	300
<b>P08140.O1.A1</b>	Projekti "Jeto me sportin", rikualifikim i terreneve sportive ne shkollen "Oso Kuka" B Shkoder," Ana e Malit" Oblike; dhe "At Gjon Karma" Gur i Zi	0	14,712	14,712
<b>Totali</b>		<b>116,283</b>	<b>147,496</b>	<b>140,078</b>



## **Realizimi i produkteve:**

### **P08130.O1.A2 : Festivali i Shahut**

Bashkia Shkodër me qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive në programin e rinisë 'Jeto me Sportin' ka parashikuar për vitin 2019 aktivitetin 'Festivali i Shahut në Shkodër' sipas programit P08130.O1A2. Ky aktivitet filloi me fazën e parë në muajin Shkurt (18-19-20) me përfshirjen e gjërë të shkollave 9-vjecare të Bashkisë Shkodër të organizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve ku morën pjesë rreth 120 nxënës. Fituesit sipas grupmohave u ftuan të merrnin pjesë për fazën e dytë të aktivitetit, atë mes shkollave të mesme. Faza e dytë i zhvillua në Qendrën Rinore Atelie në datat 25-26-27 Shkurt me nxënësit e shkollave të mesme ndërsa faza e tretë 'Kampioni i Qytetit' ku patën mundësi të konkurronin të gjithë shahistët pa dallim moshe u zhvillua më 14-15-16 Mars po në Qendrën Rinore Atelie.

Kampion i qytetit u shpall Franc Ashiku.

### **P08130.O1.A3 Beach Voley, volejbol**

Bashkia Shkodër me qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive në programin Sport dhe Argëtim ka parashikuar për vitin 2019 Aktivitetin Beach Voley, volejbol i cili mori emrin Volejpoja Beach Trophy sipas programit (P08130.O1.A3). Bashkia Shkodër organizoi për të katërtin vit rradhazi këtë aktivitet në Njësinë Administrative Velipojë në datat 26-27-28 korrik. Këtë vit morën pjesë 52 sportistë profesionist, amator dhe sportistë elitari nga klube të ndryshme të Shqipërisë si Erzeni, Vllaznia, Tirana, Partizani, Elbasani por edhe nga Kosova ekipe nga Prishtina Voley dhe nga Suhareka, Theranda Voley.

Në kategorinë e femrave u regjistruan 10 ekipe, ndërsa në kategorinë e meshkujve 16 ekipe. Aktiviteti u gjykua nga 10 gjyqtarë dhe 1 kryegjyqtar profesionist. Ditën e parë të aktivitetit u zhvilluan 10 ndeshje në dy fusha pasdite dhe kishte rreth 100 shikues, ndërsa ditën e dytë dhe të tretë u zhvilluan 35 ndeshje të tjera. Në total numërohen 45 ndeshje meshkujsh dhe femrash dhe interesi i pushuesve ishte më i lartë duke numëruar kështu rreth 1200 spektatorë.

### **P08130.O1.A5 Memoriali i Boksit**

Bashkia Shkodër në kuadër të aktiviteteve vjetore të 100 vjetorit të themelimit të Shoqnisë 'Vllaznia' ka organizuar turneun ndërkombëtar 'Memorial Vllaznia' 2019 në datat 4-7 Prill për disiplinën e boksit. Ky aktivitet u zhvillua në nderim të boksierëve të cilët ngritën emrin e Vllaznisë në majat e boksit Shqiptar përgjatë viteve e sot nuk jetojnë më. Shtetet si Bullgaria, Italia, Belgjika, Kosova, Greqia, Maqedonia e Veriut e Mali i Zi ishin pjesëmarrëse në aktivitetin 3 ditor. . Boksierët garuan në 7 peshë të ndryshme 56 kg, 64 kg, 69 kg, 75 kg, 81 kg, 91 kg dhe 91+ kg, ku u shpallën dhe fituesit përkatës.

### **P08130.O1.A7 Aktiviteti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", disiplina Xhudo**

Aktiviteti Ndërkombëtar 'Nënë Tereza', disiplina xhudo, u zhvillua në datën 9 mars 2019 në pallatin e sportit 'Qazim Dervishi' në Shkodër. Organizatorët e këtij aktiviteti ndërkombëtar ishin Bashkia Shkodër dhe Shoqata 'Judo Vllaznia'. Pjesëmarrësit ishin nga Kosova, Mali i Zi, Bullgaria, Bosnje-Herzegovina etj. Ditën e aktivitetit në orën 08.00 - 09.00, u be pritja dhe regjistrimi i klubeve të tjera pjesëmarrëse që vijne ditën e aktivitetit sic ishin Klubet sportive nga Mali i Zi dhe nga Kosova nga Komisioni zyrtar i tavolines. Më vonë u krye peshimi zyrtar nga arbitrat e certifikuar dhe u hodhën shortet përkatëse për secilën kategori (peshë) në mënyrë elektronike ndërkombëtare të Judo-s. Ndeshjet u zhvilluan në 2 fusha dhe në përfundim të aktivitetit u shpallën fituesit e peshave përkatëse.

### **P08130.O1.A8 : Aktivitet ndërkombëtar kupa ‘Agim Tafili’ disiplina Çiklizëm**

Bashkia Shkodër në programin e saj ‘Jeto me Sportin’ ka parashikuar për vitin 2019 Aktivitetin Ndërkombëtar në Çiklizëm sipas programit P08130.O1.A8. Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Çiklizmit, organizoi për të dytin vit rradhazi turneun ‘Agim Tafili’ në datat 27 dhe 28 prill 2019. Morën pjesë 40 çiklistë në kategori dhe nga klube të ndryshme si Vllaznia, Tirana, Partizani, Teuta, Burreli, Elbasani, Besa, Apollonia, Flamurtari dhe Skenderbeu. Në etapën e parë për kategorinë junior/kadet starti ishte në kthesën e Fushë Krujës 65 km ndërsa për kategorinë U23/elite, starti ishte në kthesën e Kasharit 90km. Finishi ishte në qendër të qytetit të Shkodrës. Ndërsa në ditën e dytë itinerari ishte Shkodër - Balldren - Fishte - Vau i Dejes - Gomsiqe - Shkodër 112 km për kategorinë U23/elite, dhe Shkodër - Balldren - Fishte - Vau i Dejes - Shkodër 74 km për kadet/junior.

### **P08130.O2.A1 Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia:**

Eshtë realizuar menaxhimi i Sport Klubit Vllaznia duke përfshirë, paga, siguracione, shërbime postare, shërbime internet dhe telefonie, energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu paisja e zyrave me materiale për zyra, si dhe kancelari, mundësimi i materiale të pastrimit. Është siguruar mbështetja për ekipin e ciklizmit me naftë për shoqërimin e sportistave gjatë stërvitjes me makinë.. Për sportistat janë siguruar materialet sportive për të zhvilluar stërvitjen në kushte të pranueshme.

### **P08130.O2.A2 Administrimi dhe Mirembajtje e Stadiumit Loro Borici**

Dorëzimi i munguar i stadiumit “Loro Borici” solli mospërdorimin e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Bashkia Shkodër ka filluar procedurën për marrjen në dorëzim të punimeve të objektit të Stadiumit “Loro Borici” dhe mirembajtjen e tij. Ka filluar shërbimi i rojeve dhe pagesat për shërbimet utilitare të tij..

### **P08130.O2.A3 Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia**

Eshtë realizuar administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shërbim të sigurimit të standarteve për drejtimin e tij dhe janë kryer transferta e planifikuara në mbështetje të tij.

### **P08130.O3.A1 Mbështetje të Ekipit i basketbollit meshkuj të rritur**

Ekipi i Basketbollit i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 9 herë në vitet 1967, 1969, 1990, 1993, 1994, 1995, 2000, 2014, 2015, 2016. Fitues i kupës së Republikës 8 herë në vitin 1957, 1959, 1965, 1989, 2001, 2008, 2013, 2014. Në vitin 2019 u rëndit në vend të pestë në Kampionat Kombëtar.

### **P08130.O3.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj.**

Ekipi i basketbollit të të rinjve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 7 herë në vitet 2005, 2006, 2008, 2010, 2013, 2017. Në vitin 2019 u rëndit në vend të tetë.

### **P08130.O3.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura.**

Ekipi i të rriturve për femra i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka arritur në vazhdimësi rezultate të larta në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Fitues i kupës së Republikës 2 herë në vitet 1962,1988. Sezoni sportiv 18-19 e mbylli në vendin e katërt.

### **P08130.O3.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja**

Ekipi i basketbollit të rinjve për femra SK “Vllaznia” përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Gjatë historisë së tij ky ekip ka zënë gjithnjë vende të kënaqshme në renditje në aktivitetet e zhvilluara. Kampion kombëtar në vitin 2016, vendin të dytë në 2017, kampion në vitin 2018. Në vitin 2019 u rëndit kampion.

#### **P08130.O3.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur.**

Ekipi i të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Fitues i kupës së Republikës 3 herë në vitet 1969, 1970, 1973. Kampion kombëtar për vitin 2017-2018 . Në vitin 2019 u rëndit në vendin e dytë .

#### **P08130.O3.A6 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura.**

Ekipi i volejbollit të rriturve për femra përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 3 herë në vitet 1947, 1957, 1960. Fitues I Kupës së Republikës 3 herë, në vitet 1962, 1963, 1964. Për vitin 2018 ekipi rënditet në vendin e fundit, ndërsa në 2019 në vendin e pestë

#### **P08130.O3.A7 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj.**

Ekipi i të rinjve i volejbollit të meshkujve Vllaznia përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka fituar tre kampionate kombëtare në vitet 1997, 2001, 2012. Në sezonin sportiv 18-19 ka zënë vendin e 5.

#### **P08130.O3.A8 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja.**

Ekipi i të rejave i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zënë vende të treta dhe të katërta në kampionatet kombëtare. Në vitin 2016, 2017, 2018.

Në vitin 2019 u shpall kampion kombëtar.

#### **P08130.O3.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur.**

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 20 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 22 herë, në vitet 1951, 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013; 2015 dhe 2019. Fitues i kupës së Republikës 20 herë në vitet 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013.

Në vitin 2019 ekipi u rëndit në vendin e 1 në kampionat dhe në kupë.

#### **P08130.O3.A10 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur.**

Ky ekip ka dalë kampion 18 herë në vitet 1993, 1994, 1997, 1998, 1999, 2003, deri në 2005, 2009 deri në 2017 kampion absolut. Fitues i Kupës së Republikës në 26 vitet e fundit në vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017,2018.

Kampion absolute për vitin 2019 duke marrë disa medalje të arta si në kampionat kombëtar, ashtu edhe në kupë të republikës.

#### **P08130.O3.A11 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur.**

Ekipi i ciklizmit të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zënë vende të para në kampionatet kombëtare (Rrethi ciklistik i Shqipërisë) 8 herë në vitet 1982, 1984, 1985, 1998, 1989, 1995, 1997, 2017,2018.

Në vitin 2019 u rëndit Kampion kombëtar dhe vend të parë në Kupë.

#### **P08130.O3.A12 Mbështetje e ekipit të Gjymnastikës femra të rritura**

Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ekipi i gjymnastikës i të rriturve për meshkuj ka zënë vendin e parë në vitet 1976-1977, ndërsa ekipi i gjymnastikës i të rriturve për femra ka zënë 10 herë vendin e parë në kampionatet në vitet 2005, 2006, 2008, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018.

Në vitin 2019 u rëndit në vendin e parë.

#### **P08130.O3.A13 Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur**

Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 1994. Ky ekip mbas vitit 1994 deri në vitin 1998 nuk merr pjesë në asnjë aktivitet për arsye financiare dhe fillon aktivitet në vitin 1999 e në vazhdim. Ekipi i të rriturve në vitin 2014, 2015, renditet në vendin e dytë dhe të tretë duke patur rezultate shumë të mira në aktivitetet kombëtare dhe merr pjesë disa here në aktivitetet miqësore ndërkombëtare.

Në vitin 2019 u rëndit në vend të dytë.

#### **P08130.O3.A14 Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj të rritur**

Ekipi i të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë N/kampion 2 herë në vitet 2009, 2010, nga vitit 2010 dhe deri 2015 renditet në e vendin e tretë. Gjithashtu për vitin 2019 është rënditur në vendin e tretë.

#### **P08130.O3.A15 Mbështetje e ekipit te Notit të rritur dhe të rritura**

Ekipi i notit për të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Në gara individuale ka pasur shumë rezultate të larta, gjithsej 30 medalje ari, argjendi dhe bronzi. Rënditet në vendin e tretë dhe të katërt për vitin 2019.

#### **P08130.O3.A16 Mbështetje e ekipit te peshngritjes meshkuj të rritur:**

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 3 trajnerë. Ky ekip ka daleë kampion 8 herë në vitet 1972, 1973, 1976, 1978, 1991, 2004, 2008, 2009.

Në vitin 2019 rënditet në vendin e katërt.

#### **P08130.O3.A17 Mbështetje e ekipit te Ping - Pong të rritur**

Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 6 here në vitet 1966, 1968, 1970, 1975, 1982, 1983.

Ky ekip, që në vitin 1990 merr pjesë rregullisht në kampionatin kombëtar dhe kupat e Republikës duke zënë vende të dyta dhe të treta.

Në vitin 2019 u rëndit në vend të 2 si në kampionat, ashtu edhe në kupë.

#### **P08130.O3.A18 Mbështetje e ekipit të Shahut të rritur**

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 2008.

Në vitin 2019 u rëndit në vend i dytë.

#### **P08130.O3.A19 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/të rritura**

Ekipi përbëhet nga 30 të rinj dhe të rritur dhe 3 trajnerë. Gjithsej ekipi Vllaznia është shpallur 12 herë kampioni Kupës së Republikës, dhe vazhdon të jetë kampion absolut dhe në vitin 2019.

#### **P08130.O3.A20 Mbështetje e ekipit të boksit femra**

Ekipi i Vllaznisë përbëhet nga 1 sportiste dhe 1 trajner. Kampione absolute në kampionat kombëtar si dhe medalje të arta në turne ndërkombëtare. Gëzon statusin e sportistit të nivelit të lartë.

#### **P08130.O3.A21 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja**

Ekipi përbëhet nga 40 kadet dhe 2 trajnerë. Gjithsej ekipi Vllaznia është shpallur 12 herë kampioni Kupës së Republikës, dhe vazhdon të jetë kampion absolut dhe në vitin 2019.

## Programi 08220 - Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

- 1- Aparatin e Bashkisë
- 2- Degën ekonomike të kulturës
- 3- Teatrin Migjeni.

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit Shërbimet kulturore është:

I. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

II. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

III. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për 8-mujorin e parë të 2019-tës kanë qenë:

O1: Vlerat e trashëgimisë kulturore të ruajtura dhe të promovuara si dhe institucione menaxhuese të mirëadministruara.

O2: Institucionet kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës të fuqizuara.

O3: Jetë kulturore të gjallëruar nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.

O4: Shërbime cilësore pranë Bibliotekës “Marin Barleti” përpromovimin dhe nxitjen e leximit si instrument edukimi.

O4: Fondi i bibliotekës “Marin Barleti” i mirë administruar dhe i pasuruar.

Rezultatet e programit Shërbimet kulturore:


Programi P08220	Paga+ Sigurime	Shpenzime operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
<b>Plani fillestar 2019</b>	43,819	32,544	0	6,380	1,870	84,613
<b>Plani i rishikuar 2019</b>	43,719	35,044	0	6,480	1,870	87,113
<b>Realizimi vjetor 2019</b>	40,387	30,685	0	6,475	1,542	79,089

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program duke e krahasuar me planifikimin është 90.8 % si më poshtë:

Shpenzime personeli 92,4%.

Shpenzime te tjera operative 87.6%.

## Realizimi ne % i shpenzimeve



## Realizimi i treguesve të performancës:

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2019-31.12.2019

Kodi i Programit	8220	Emertimi i programit:	Trashëgimi kulturore,eventet artistike dhe kulturore					
Qellimi	Menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturoro- artistike, asetëve të trashëgimisë kulturore, duke risjellur në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorin arkeologjik, etnografik, historik, te fotografise, muzikës, teatrit etj. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës. Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përcimi i vlerave kulturore dhe sportive do te jete nje nga politikat e programit. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.							
<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>								
<b>*Objektivat e politikës*:</b>	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<i>Objektivi 3</i>	O3 Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve te institucioneve kulturore dhe artistike te Bashkise se Shkodres							
	A	Nr. aktiviteteve	10	14	14	15	107%	
	B	Nr.perfituesave nga keto aktivitete.	10,000	10,500	10,500	12,500	119%	

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkoder	Kodi i Grupit	141
Programi	Trashëgimi kulturore,eventet artistike dhe kulturore	Kodi i Programit	8220

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia mates e	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi				
					Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
A	Nr. aktiviteteve	Nr. Aktiviteteve	10		0	14		0	14	0	14	0		-	-	-	
B	Nr.perfituesave nga keto aktivitete.	Nr. Qytetareve	10,500	4,260	0	10,500	6,360	1	10,500	6,360	1	10,500	6,360	1	0.20	-	-
A	Nr i titujve te ri te librave	Nr Tituj libra Rinj	400	1,000	3	430	1,100	3	430	1,100	3	430	1,100	3	0.06	-	-
B	Botime re reja te revistes Gegnia	Nr.Botimesh	3	378	126	3	378	126	3	378	126	3	378	126	-	-	-
A	Aktivitetete te zhvilluara nga Dega ekonomike e Kultures	Nr aktivite tesh	14	1,315	94	17	1,560	92	17	1,560	92	19	1,560	82	11.82	9.66	9.66
B	Vizitore ne muzeume dhe shtepite muze	Bileta te shitura	17,500	150	0	18,500	150	0	18,500	150	0	15,850	150	0	0.00	0.00	0.00
A	Pjesmarrja e i vizitoreve ne ekspozite	Nr i vizitoreve	1,500		0	1,500		0	1,500		0	1,850		0	-	-	-
B	Numri i lexuesve te rregullt ne Biblioteke	Nr.Kartela	6,200		0	6,350		0	6,400		0	6,108		0	-	-	-



### Realizimi i fondeve për periudhën 12 mujore 2019:

Per vitin 2019, ne programin Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, ne funksion te veprimtarise kryesore dhe permbushjen e objektivave te percaktuara, jane parashikuar aktivitetet e meposhtme:

Aktiviteti	Buxheti fillestar 000/lekë	Buxheti i korigjuar 000/lekë	Realizimi viti 2019 000/lekë	
P08220.O1.A1	"Java e Pavarësisë" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik	80	80	80
P08220.O1.A2	Mbështetje për funksionimin dhe shërbimin në vazhdimësi të Muzeut Historik.	670	670	510
P08220.O1.A3	Materiale promocionale për rrjetin muzeal	60	60	60
P08220.O1.A4	Blerje pajisje për Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës	360	360	247
P08220.O1.A5	Publikime promocionale, fletëpalosje e guidë për Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës	-	-	-
P08220.O1.A6	Cikël bisedash dhe ndërgjegjësim i të rinjve nën fokusin e librave me tematikë mbi të kaluarën komuniste	70	70	70
P08220.O1.A7	Mirëmbajtje e ndërtesës VDK	-	-	-
P08220.O1.A8	Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve	30	30	30
P08220.O2.A1	Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës	1,000	1,000	945
P08220.O2.A2	Administrimi dhe menaxhimi i Drejtorisë Ekonomike të Kulturës	21,525	21,525	18,955
P08220.O2.A3	Periodiku Gegnia	378	378	222
P08220.O2.A4	Festivali letrar i Shkodrës	50	50	30
P08220.O3.A1	Ditët e Kosovës	555	555	-
P08220.O3.A2	Mbështetje për menaxhim e Teatrit Migjeni	5,651	5,651	5,059
P08220.O3.A3	Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"	22,512	22,512	21,354
P08220.O3.A4	Administrimi dhe menaxhimi i qendrës kulturore Pjetër Gaci	3,614	3,614	2,891
P08220.O3.A5	Orkestra Frymore Honorare vjetore	4,532	4,532	4,532
P08220.O3.A6	Takim kombëtar bandash frymore në Shkodër	1,500	1,500	1,486
P08220.O3.A7	Çmimi "Pjetër Gaci"	1,309	1,309	1,285
P08220.O3.A8	"Ahengu Shkodran"	478	478	478
P08220.O3.A9	"Honorare " Grupi i Valleve"	720	720	720

P08220.O3.A10	Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”.	2,500	3,500	3,451
P08220.O3.A11	“Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore”.	234	234	234
P08220.O3.A12	“Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare”	320	320	-
P08220.O3.A14	Festival burimor	200	200	-
P08220.O3.A15	Dita ndërkombëtare e Jazz-it	200	200	200
P08220.O3.A16	Dramë	1,795	1,795	1,795
P08220.O3.A17	Komedi	2,150	2,150	2,114
P08220.O3.A18	Tragjikomedi	900	900	891
P08220.O3.A19	Variete	1,005	1,005	1,005
P08220.O3.A20	Shfaqje për fëmijë dhe Teatri i kukllave	1,000	1,500	1,100
P08220.O3.A21	Pranverë me këngë	650	650	594
P08220.O3.A22	Fjala artistike me nxënësit e shkollave të mesme në nderim të figurave të shquara	300	300	300
P08220.O3.A23	Dita e Luleve 6 Maj	500	500	500
P08220.O3.A24	Ndërmendje	1,080	1,080	1,080
P08220.O3.A25	Aktivitete me rastin e 2 Prillit	270	270	265
P08220.O3.A26	Festival Jazz-i	1,900	1,900	1,900
P08220.O3.A27	Koncertet e Verës	600	600	600
P08220.O3.A28	Karnavalet	500	500	500
P08220.O3.A29	Shkodra n'fest	300	300	300
P08220.O3.A30	Festa e Muzikës	500	500	495
P08220.O3.A31	Festa e trashëgimisë kulturore	1,000	1,000	1,000
P08220.O3.A32	Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik	200	200	158
P08220.O3.A33	Lëvizja e Postribës	30	30	29
P08220.O3.A34	Ekspozita “Salloni i vjeshtës”	565	565	228
P08220.O3.A35	Çmimi Idromeno	350	350	181
P08220.O3.A36	“Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës	20	220	69
P08220.O3.A37	Takimet publike –bisedat publike mbi artin dhe workshop me artistët e rinj	50	150	128
P08220.O3.A38	Aktivitete në partneritet me shoqata kulturore	100	100	29
P08220.O3.A39.	Rikonstruksion I sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër.	-	-	-
P08220.O3.A40	Muzeu i Arteve Pamore “Lin Delija”	-	-	-
P08220.O3.A41.	70- Vjetori i Teatrit	-	1,000	989
	<b>Totali</b>	<b>84,613</b>	<b>87,113</b>	<b>79,089</b>

## **Pershkrimi i aktiviteve:**

### **P08220.O1.A1** “Java e Pavarësisë” Ekspozitë me karakter historik dhe artistik

Trashëgimia materiale dhe dokumentare që ruan Muzeu Historik në rrafshin e historisë dhe arkivit është shumë disiplinuar. Qëllimi i aktivitetit ishte të promovojë dokumenta, artefakte, fotografi të cilat pasqyrojnë rreshtimin e Shqipërisë si fitimtare përkrah aleatëve të mëdhenj në Luftën e Dytë Botërore, kundër okupatorëve nazi-fashistë. Kjo ekspozitë pati interes shumë të veçantë të publikut.

### **P08220.O1.A2** Mbështetje për funksionimin dhe shërbimin në vazhdimësi të Muzeut Historik

Çdo vit Bashkia Shkodër, në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore investon në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të punës në rrjetin e saj muzeal. Këtë vit është realizuar mirëmbajtje në Muzeun e Kështjellës dhe në Banesën “Oso Kuka” si dhe ka vazhduar procesi i kartelizimit të fondeve, duke përmbyshur kështu edhe detyrimin ligjor të standarteve për dixhitalizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.

### **P08220.O1.A3** “Materiale promocionale për rrjetin muzeal”

Çdo vit rrjeti muzeal i Bashkisë Shkodër ka të domosdoshëm printimin e materialeve promocionale, të cilat shërbejnë për një prezantim dinjitoz dhe sa më të gjërë gjeografikisht, të objekteve tona të trashëgimisë kulturore. Këto materiale shërbejnë për promovimin e territorit të Bashkisë Shkodër, kryesisht tek turistët e huaj.

### **P08220.O1.A3** Blerje pajisje për Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës”

Çdo vit Bashkia Shkodër, në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore investon në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të punës në rrjetin e saj muzeal. Këtë vit është realizuar blerje e pajisjeve të domosdoshme të punës për Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës.

### **P08220.O1.A6** “Cikël bisedash dhe ndërngjegjësim i të rinjve nën fokusin e librave me tematikë mbi të kaluarën komuniste”

Janë realizuar tre takime, ku të ftuar ishin: Elena Zorba, Gjeto Vocaj dhe Zenel Drangu. Takimet janë realizuar me klasat e gjimnazit “28 Nëntori”, gjimnazit “Rrogacionistët” nga Lezha dhe me një grup nxënësish të përzierë nga shkolla të ndryshme të Shqipërisë, në bashkëpunim me IDMC. Në muajt në vazhdim do të zhvillohen edhe dy takime të tjera.

### **P08220.O1A8** “Dita ndërkombëtare e muzeumeve”

Në kuadër të Ditës ndërkombëtare të muzeumeve, rrjeti muzeal i Bashkisë Shkodër realizoi një aktivitet në Muzeun Historik, Banesa “Oso Kuka” dhe në Kalanë “Rozafat”, të titulluar “Fluturon... fluturon, balona”. Aktiviteti konsistonte në rikthimin e një tradite të humbur, ndërtimin e lojës së balonave, të cilat u krijuan nga vetë fëmijët e shkollave 9-vjeçare të territorit të Bashkisë Shkodër për disa ditë me radhë në Banesën “Oso Kuka”, duke e kulmuar këtë aktivitet në datën 19 Maj 2019 në Kalanë “Rozafat” me lëshimin e balonave. Aktiviteti pati impakt shumë pozitiv, kryesisht për fëmijët dhe median. Gjithashtu, i gjithë rrjeti muzeal i Bashkisë Shkodër hapi dyert e tyre falas për vizitorët në datën 18 Maj.

### **P08220.O2.A1** Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës

Bashkia Shkodër çdo vit mbështet Bibliotekën “Marin Barleti” në pasurimin e fondeve të saj. Në 2019 është hapur procedura standarte e prokurimit publik, por nuk është paraqitur asnjë subjekt. Për këtë arsye procedura është në fazë rihedhje në APP.

**P08220.O2.A2:** Administrimi dhe menaxhimi i Drejtorisë Ekonomike të Kulturës.

Dega Ekonomike e Kulturës ka strukturën e mëposhtme prej 28 punonjësish ku janë paguar Paga dhe Sigurimet Shoqërore për punonjësit e mëposhtëm: Në Bibliotekën Publike “Marin Barleti” 14 punonjës; Sektori i Librit dhe Mediatikës 8 punonjës, Muzeu Historik 6 punonjës.

**P08220.O2.A3** Periodiku “Gegnia”

Kjo revistë ka karakter kulturor dhe përfshin një gamë të gjërë artikujsh që kanë lidhje me gjuhën, letërsinë, artin, albanologjinë, historinë etj. Promovimi i kësaj reviste pati jehonë pozitive dhe interesi për të ishte i lartë. Revista “Gegnia” është e regjistruar me ISSN përkatëse, me orientim kulturor dhe është e hapur për të gjithë shkrimtarët e rinj dhe profesionistë. Në vitin 2019 u botuan edhe tre numra të rinj.

**P08220.O2.A4** Festivali letrar i Shkodrës

“Festivali letrar i Shkodrës” zhvilloi edicionin e njëmbëdhjetë të tij këtë vit. Ky festival, i konceptuar si një forum letrar, i dedikohet kryesisht shkrimtarëve shkodranë që jetojnë në Shkodër dhe jashtë saj, por gjithashtu synimi i këtij festivali është edhe të jetë një urë lidhëse me shkrimtarë të hapësirave shqiptare. Këtë vit festivali u zhvillua i ndarë në pesë takime me shkrimtarë të ndryshëm dhe target grupe të ndryshme në Bibliotekën “Marin Barleti”

**P08220.O3.A2** Mbështetje për menaxhimin e Teatrit “Migjeni”

Stafi i Teatrit “Migjeni” është i angazhuar të kontribuojë si përherë, në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit tonë.

Tradita dhe eksperiencat, prurjet e reja të talenteve, pritshmëria artistike e qytetarëve, janë një shtysë e rëndësishme për organizimin e aktiviteteve të reja dhe përmirësimin cilësor të tyre.

Për të realizuar në mënyrë sa më profesionale të gjitha aktivitetet, duke krijuar kushtet e nevojshme të punës, çdo vit Bashkia Shkodër financon të gjitha shpenzimet operative të nevojshme për menaxhimin e Teatrit “Migjeni”

**P08220.O3.A3:** Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit “Migjeni”

Institucioni i Teatrit “Migjeni” është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Struktura e tij përbëhet prej 37 personash. Kjo fishe ka të bëjë me pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë personelin e punësuar pranë Teatrit “Migjeni”.

**P08220.O3.A4:** Administrimi dhe menaxhimi i qendrës kulturore Pjeter Gaci.

Qendra e Kulturës “Pjetër Gaci” ka 4 punonjës, dhe janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore të tyre.

**P08220.O3.A5:** Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë, me fillimet e hershme që nga viti 1876. Bashkia Shkodër e mbështet çdo vit me honorare këtë formacion, i cili gjatë gjithë vitit është prezent në pothuajse të gjitha aktivitetet artisko-kulturore si dhe në datat e rëndësishme historike zyrtare kombëtare dhe lokale. Formacioni i Orkestrës Frymore të Bashkisë Shkodër, përbëhet prej 40 muzikantëve.

**P08220.O3.A6** Takim kombëtar bandash frymore në Shkodër

Në bazë të eksperiencës pozitive të vitit 2018, ku për herë të parë u zhvillua në Shkodër, në qytetin ku u lind Orkestra e parë Frymore Shqiptare, Takim Kombëtar i Orkestrave Frymore, Bashkia Shkodër edhe në vitin 2019 mbështeti dhe organizoi me Qendrën Kulturore “Pjetër Gaci” edicionin e dytë të këtij Takimi.

I konceptuar në formën e një gare, ky takim shërbeu në shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e një fryme bashkëpunimi mes artistëve dhe institucioneve kulturore që ata përfaqësojnë.

Ftesës tonë për të qenë pjesë e këtij aktiviteti ju përgjigjën orkestrat e mëposhtme:

1. Orkestra Frymore “Afërdita” – Bashkia Elbasan
2. Orkestra Frymore – Bashkia Durrës
3. Orkestra Frymore – Bashkia Berat
4. Orkestra Frymore – Komuna Tivat, Mali i Zi
5. Orkestra Frymore e shkollës “Çesk Zadeja” – Komuna Ferizaj, Kosovë
6. Orkestra Frymore e shkollës “Bësëlidhja” – Bashkia Lezhë
7. Orkestra Frymore – Bashkia Shkodër
8. Orkestra Frymore “Lekë Gjergji” – Shkolla “Prenkë Jakova”, Shkodër.

Aktiviteti u zhvillua në datat 11-12 Maj 2019.

#### **P08220.O3.A7:** Çmimi “Pjetër Gaci”.

Aktiviteti u zhvillua në datat 25-28 Prill 2019 në Teatrin “Migjeni”, Sallën “Gjon Kapidani” pranë shkollës artistike “Prenkë Jakova”, në ambjentet e Galerisë së Arteve dhe pranë Qendrës Rinore “Atelie”. Konkursi i interpretuesve të muzikës klasike është i përbërë nga 5 disiplina muzikore: Piano, Harqe, Instrumenta Frymore, Kanto dhe Kitara. Këtë vit morën pjesë rreth 200 studentë nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Në natën finale ishin të pranishëm rreth 250 spektatorë në Teatrin “Migjeni”.

#### **P08220.O3.A8** “Ahengu Shkodran”

Pjesë e traditës së këngës popullore shkodrane është dhe “Ahengu Shkodran”, i cili me të drejtë është shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare. Në ditën e trashëgimisë kulturore, me 29 shtator, organizohet aktiviteti tradicional “Ahengu Shkodran”.

Këtë vit, aktivitetet në kuadër të Ahengut Shkodran, u realizuan edhe me bashkëpunimin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale.

28-29-30 Shtator 2019 u zhvilluan aktivitetet në Shtëpinë muze të Pashko Vasës, në shtëpinë muze të familjes Çeka dhe në Muzeun Historik, Banesa “Oso Kuka”.

#### **P08220.O3.A9:** “Honorare ” Grupi i Valleve”

Grupi i valleve ka një traditë në vite me një numër të madh pjesëmarrësish dhe drejtuesish të njohur, të cilët kanë kontribuar në shumë aktivitete të ndryshme, duke na lënë një pasuri të çmuar në këtë fushë. Ky grup mori pjesë në shumë aktivitete që janë organizuar në Bashkinë Shkodër.

Grupi i Valleve përbëhet prej 12 personash, të cilët shpërblehen me honorare për 10 muaj të vitit.

#### **P08220.O3.A10** Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”

I kthyer tashmë në traditë prej katër vitesh, edhe këtë vit, Festivali solli në Shkodër krijime të reja të muzikës qytetare shkodrane, të cilat do të pasurojnë fondin e këngëve tona.

Festivali u zhvillua në datat 26-27 Tetor 2019 dhe pati një interes shumë të madh të publikut.

Me pjesëmarrjen e 16 autorëve, festivali u drejtua nga dirigjentët e mirënjohur Jetmir Barbullushi, Kujtim Alija dhe Ilir Zoga.

**P08220.O3.A11** Koncert Premierë i Orkestrës Frymore

Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër, çdo vit realizon një koncert premierë në muajin nëntor, në kuadër të festave të nëntorit. Për shkak të fatkeqësisë natyrore të 26 nëntorit, këtë vit, koncerti u shty, duke u zhvilluar në datën 7 Dhjetor 2019. I titulluar “Dëshirë e zemrës”, koncerti pati si tematikë muzikën shqiptare të përpunuar për formacion fryme. Ai u mirprit nga spektatori shkodran i madh në numër në sallën e Teatrit “Migjeni”.

**P08220.O3.A15** Dita ndërkombëtare e Jazz-it

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Jazz-it, me 30 Prill, edhe këtë vit u realizua një koncert i përmasave të mëdha. Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”, në bashkëpunim me producentët e “Swing Marathon”, realizuan një shfaqje pranë Kafes së Madhe dhe një koncert në Teatrin “Migjeni”, me grupe shqiptare dhe të huaja.

Numri i spektatorëve edhe këtë vit ishte i lartë, mbi 400.

**P08220.O3.A16** Dramë – “ Tre vetë në një varkë pa llogaritë Nik Prel Mujën”

Me tekst dhe regji nga Stefan Çapaliku.

Skenografia dhe kostumet Sadik Spahija

Koreograf Gjergj Prevazi, dhe me aktorët:

Jozef Shiroka

Nikolin Ferketa

Fritz Selmani

Rita Gjeka Kacarosi (Mjeshtër i Madh)

Vladimir Doda

si dhe Pëllumb Gjona.

Asistent regjisor Astrit Fani.

Drama u vu në skenë në datat 12-15 Dhjetor 2019 dhe u prit mirë nga publiku shkodran.

**P08220.O3.A17** Komedi “Kumarxhiu” nga Carlo Goldoni.

Komedia u realizua në datat: 3, 4, 5 Qershor 2019.

Përmbledhje, Përshtatje dhe Regjia: Michele Modesto Casarin

Maskat: Stefano Perocco di Meduna.

Kostumet dhe Skenografia: Adnan Kastrati.

Shqipërimi: Zija Vukaj.

Interpretojnë: Simon Shkreli, Linda Jarani, Indri Qyteza Shiroka, Fritz Selmani, Vladimir Doda, Jozef Shiroka, Merita Smaja, Zylia Miloti "Mjeshtër i Madh", Pjerin Vlasi.

Këngëtare: Rezarta Smaja. Fizarmonikë: Ilir Zoga. Klarinetë: Namik Jahja. Kitarë: Bled Doçi. Bateri: Fatmir Mesi.

Komedia u ndoq në të gjitha netët nga një numër i madh spektatorësh.

**P08220.O3.A18** Tragjikomedi “Zona e Pritjes”

Tragjikomedia u realizua në datat 20, 21 Prill 2019 në teatrin "Migjeni".

"Zona e pritjes" është komedi e zezë.

Autore : Marina Vučić  
Regjia dhe skenografia: Fatos Berisha.  
Kostumografia: Desantila Lika.  
Tragjikomedia u realizua nga aktorët e Teatrit “Migjeni” dhe pati sukses tek publiku.

**P08220.O3.A19** Variete “Frikacaku bahet trim”

Variete-ja u realizua në datat : 8 - 9 -10 -11 Prill2019 në teatrin "Migjeni".  
Autor: Qazim Çela  
Regjisor: Besnik Çinari.  
Skenografia: Hysni Halili.  
Intepretojnë: Anton Krosaj, Zyliha Miloti, Besnik Çinari, Ketlin Pjalmi, Vladimir Doda,  
Ergys Saraçi.  
Shfaqja pati shumë sukses tek publiku i pranishëm në sallë.

**P08220.O3.A20** Shfaqje për fëmijë dhe Teatri i Kukullave

Në vitin 2019 janë realizuar dy shfaqje Teatër kukullash, konkretisht: “Tre kecat dhe ujku”, e cila e pati premierën në datën 23.02.2019, duke realizuar 15 shfaqje gjithsej dhe “Tre derrkucët”, premiera e të cilit u shfaq në datën 08.12.2019, duke realizuar 12 shfaqje gjithsej. Teatri i kukullave me rikthimin e tij, shihet me shumë interes në qytetin tonë.

**P08220.O3.A21:** Pranverë me këngë;

Aktiviteti u zhvillua në datat 15-16 mars 2019. Me pjesëmarrjen e 20 këngëtarëve, të rinj dhe profesionistë, ky koncert solli për publikun këngë të muzikës së lehtë të përpunuara.  
Numri i spektatorëve ishte rreth 900 persona.

**P08220.O3.A22:** Fjala artistike me nxënësit e shkollave të mesme në nderim të figurave të shquara.

Aktiviteti u zhvillua në datat 9-10 Mars 2019. Ky aktivitet i dedikohet nxënësve të shkollave të mesme, të cilët në bashkëpunim me aktorë të përzgjedhur të Teatrit “Migjeni” realizojnë shfaqje artistike. Këtë vit morën pjesë 4 shkolla: “Jordan Misja”, “28 Nëntori”, “Oso Kuka” dhe Shejnaze Juka”, ku fituese u shpall shkolla “Oso Kuka”.

Numri i spektatorëve ishte rreth 600 persona.

Në Teatrin “Migjeni” edhe këtë vit u vendosën një numër shumë i madh shfaqjesh, teatrale, muzikore, letrare, argëtuese, shfaqje për fëmijë etj.

Me pjesëmarrjen e 27.563 spektatorëve që me interes ndoqën 10 premierat gjatë vitit 2019 , 117 shfaqjet, e 14 veprimtarive të ndryshme artistike dhe mbështetën 5 çmimet e fituara në festivalet teatrorë mbarëkombëtare.

Këtë vit Teatri “Migjeni” shënoi 70 vjetorin e krijimit të teatrit profesionist, i cili u festua gjatë gjithë vitit me aktivitete të ndryshme, duke kulmuar me datën 3 nëntor, në festën e madhe. Këtë ditë Presidenti i Republikës i akordoi Teatrit “Migjeni” titullin “Nderi i Kombit”.

**P08220.O3.A23** Dita e Luleve 6 Maj

Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Shoqata “Consulting and Development Partners”, i shpallur fitues nga Këshilli Artistiko-Kulturor i Bashkisë Shkodër.

Aktiviteti u zhvillua në datat 6 dhe 7 maj 2019.

**6 Maj** u zhvillua në Teatrin “Migjeni” konkursi i vallëzimit, konkurs i cili ishte pjesë e aktivitetit “Bilbilat e vegjël në Shkodër këndojnë” e organizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve. Në këtë konkurs morën pjesë rreth 16 shkolla.

**7 Maj** – Aktivitetet u zhvilluanë sheshin para Bashkisë Shkodër, në Sheshin “Nënë Tereza” dhe pranë vendit të quajtur “Lapidari”.

**“Panairi i luleve”**dedikuar qytetarëve; **“Parada e luleve”** –dedikuar fëmijëve të shkollave të territorit të Bashkisë Shkodër. U zhvillua parade dhe koncert gjatë paradites;**“Zanat e luleve”** -ideuar si ministudio fotografike për fotografimin e fëmijëve dhe të rriturve; **“Poezia e luleve”** – Konkurs i krijimit të Poezisë Gegë, kushtuar luleve; **“Lulet e qytetit tim përmes fotografisë”** – Konkurs fotografie, me tematikë lulet e Shkodrës; **“Miss biçikleta”** –konkurs për biçikletën e zbukuruar më bukur me lule të freskëta.

Mbasditja e 7 majit, përveç konkurseve, i’u dedikua edhe shkollave të mesme të cilët performuan më vallëzime dhe këngë gjatë hapësirave të konkurseve.

**“Koncerti i Luleve”** – Koncerti përmbyllës i kësaj dite, para sheshit të Bashkisë Shkodër.

Të ftuar ishin këngëtarët:

1. Niki Mjeda;
2. Viki Haxhi;
3. Aldo Prendushi;
4. Eugjen Marku;
5. Arnold Kallaçi.

Shoqërues të këngëtarëve ishte banda muzikore e përbërë nga: Antonio Fierza, Edison Ceni; Jetmir Mesi.

#### **P08220.O3.A24** “Ndërmendje”

“Ndërmendje”, është Koncerti i fundvitit, si pjesë e traditës më shumë se 10 vjeçare, i cili zhvillohet nga Bashkia Shkodër. Si një aktivitet që i dedikohet muzikës klasike, këtë vit u zhvillua me datë 29 Dhjetor 2019 në Teatrin “Migjeni”.

Me pjesëmarrjen e orkestrës simfonike të formuar nga artistë shkodranë, të përbërë prej 50 elementësh dhe me një repertor të përzgjedhur, koncerti u mirprit nga spektatori i pranishëm në sallë. Këtë vit të ftuar special ishin pianisti italian Paolo Marzocchi dhe sopranoja me origjinë nga Shkodra, e cila punon në Romë, Ana Lushi. Të ftuar të tjerë: Sopranoja kosovare me origjinë nga Shkodra, Adelina Paloja, violinisti virtuoz Lorenc Radovani, sopranot Rita Dervishi, Blerta Cina, Niki Mjeda dhe tenorët e rinj Semir Hoxha, Ervin Ahmeti dhe Serxho Toma dhe dirigjenti Kujtim Alija (Mjeshtë i madh). Këtë vit mori pjesë edhe kori polifonik “Prenkë Jakova”, i cili i dha një dimension të ri aktivitetit. Grupi organizativ artistik: Gjon Shllaku – Drejtor Artistik, Jetmir Barbullushi – Dirigjent, Alfred Çapaliku – Skenarist, Enkel Demi – Prezantues.

#### **P08220.O3.A25:** Aktivitete me rastin e 2 Prillit

Nëkuadërtëditëspërkujtimoretë “2 Prillit” në sheshin që mban edhe emrin e kësaj revolte, u organizua ceremonia e përvitshme e vendosjes së kurorave, në nderim të dëshmorëve të demokracisë. Homazhet u



shoqëruan nga Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër, nga tenori Riad Bashi dhe moderatorja Rajmonda Marku.

Në këtë ceremoni morën pjesë, Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, z.Lulzim Basha, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, Kryetarja e Qarkut, znj. Greta Bardeli, Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.Xhemal Bushati, përfaqësues të lartë të Partisë Demokratike, të shoqatave antikomuniste, familjarë të dëshmorëve dhe qytetarë të Shkodrës.

Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Shkodër hapi në orën 09:00 ekspozitën kushtuar ngjarjeve të “2 Prillit”. Ekspozita u hap në rrugën “13 Dhjetori”, ku qytetarët patën mundësi të shihnin edhe foto të rralla të kësaj ngjarje. Ekspozita qëndroi e hapur gjatë gjithë ditës.

Në ambjentet e Hotel Rozafa ishte rezervuar një koktejl i madh për të gjithë të pranishmit në ceremonialin përkujtimor.

Në pasditen e kësaj dite u organizua shfaqje e dokumentarit kushtuar ngjarjeve të 2 prillit 1991 në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie”, ku të pranishëm ishin të rinj dhe të reja.

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte rreth 1000 persona.

### **P08220.O3.A26 Festival Jazz-i.**

“Festival i Jazz-it” projekt i titulluar “Shkodra Jazz Festival” nga subjekti fitues, u zhvillua në datat 17 gusht – 1 shtator 2019.

Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër, Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj” dhe “Optional Music International”.

“Rrok Academy”, projekt i prezantuar nga Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj” prej tre vitesh, është shkolla e parë e këtij lloji në Shqipëri, e cila ka të bëjë me kurse të avancuara për muzikantë.

“Rrok Academy” u zhvillua në datat 17 gusht - 1 shtator 2019 në ambjentet e Galerisë e Arteve, Shkodër dhe në Qendrën Rinore “Atelie”.

Në të morën pjesë rreth 60 studentë, nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.

Leksionet me temë “Mbi gjuhën muzikore të jazz-it” u drejtuan nga Markelian Kapidani, ndërsa ato të këndimit nga Deborah J. Carter; të bass-it nga Marco Piccirillo, të baterisë nga Matteo Cidale.

Leksionet e zhanrit klasik me temë “Mbi studimin e teknikës orkestrale” u drejtuan nga Paçalin Pavaci, me orkestrën “Skanderbeg Chamber Orchestra”.

“Skanderbeg Chamber Orchestra”, e drejtuar nga Maestro Pavaci u prezantua me një koncert shumë dinjitoz "Shkodra Sounds" në Teatrin "Migjeni" në datën 1 shtator 2019.

Leksionet e Fizarmonikës klasike dhe ballkanike me temë “Mbi studimin e teknikës klasike dhe ballkanike” u drejtuan nga Bardh Jakova. Kjo degë u prezantua si risia e këtij viti në “Rrok Academy” me një koncert shumë të veçantë në 22 Gusht 2019 në zonën pedonale, pranë Jubanve.

Koncertet u zhvilluan në datat 22 Gusht Zona Pedonale, pranë Jubanve”– 24 Gusht, Muzeu Historik – 27

Gusht, tek Kafja e Madhe – 28 Gusht në Teatrin “Migjeni” – 29 Gusht, Muzeu Historik – 30 Gusht,

Sheshi “Nënë Tereza”– 31 Gusht Sheshi “Nënë Tereza” dhe 1 Shtator 2019 në Teatrin “Migjeni”.

### **P08220.O3.A27 Koncertet e Verës.**

Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe “Piano Bisha” shpk.

“Koncertet e verës” u zhvilluan në muajin Korrik - Gusht në datat:

26 Korrik 2019 në sheshin “Nënë Tereza” me pjesëmarrjen e grupit të mirënjohur “BRIOS”.

1 Gusht 2019 në sheshin “Nënë Tereza” me pjesëmarrjen e grupit “THE 4BAND”;

9 Gusht 2019 në sheshin “Nënë Tereza” me pjesëmarrjen e grupit “ALT”;

16 Gusht 2019, tek Sheshi “Nënë Tereza” me pjesëmarrjen e grupit “UNIT BAND”.

Të gjitha koncertet paten impakt shumë pozitiv tek publiku, i cili ishte prezent në numër të madh në çdo koncert.

#### **P08220.O3.A28:** Karnavalet.

“Karnavale 2019”, u zhvilluan në datat 2 dhe 3 Mars 2019 në sheshin para Bashkisë Shkodër dhe në sheshin “Nënë Tereza”. Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Shoqata Kulturore Teatrorë “Zef Jubani”. Karnavale 2019, të titulluara “20 vjet Karnival n’demokraci” me nëntitull “Karnival jo n’kazan” nga subjekti, përfshinë 14 shkolla të sistemit 9-vjeçar dhe të mesëm të territorit të Bashkisë Shkodër. Edhe këtë vit u ruajtën traditat e organizimit të Karnavaleve, duke përfshirë një sërë aktivitetesh, që nga Karvani Karnavalesk, i shoqëruar nga Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër, performancat artistike të shkollave, spektakli i madh me bejta tipike, butaforitë tipike dhe djegia e dordolecit.

I gjithë aktiviteti u transmetua live nga të gjitha mediat lokale.

Numri i pjesëmarrësve këtë vit ishte shumë i lartë, rreth 2500 persona.

#### **P08220.O3.A29** Shkodra n’Fest

Bashkia Shkodër , në vitet e fundit, për festat e fundvitit ka organizuar ambjente artistike, festive, dëfryese, gjatë muajit dhjetor.

Në qendër të qytetit janë vendosur lojëra argëtuese për fëmijë dhe të rritur dhe pista e patinazhit si një risi e dy viteve të fundit në Shkodër.

Gjatë këtij muajit dhjetor u organizuan edhe dy koncerte, me pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme muzikore, hapësira argëtimi për femijë, duke e kthyer qendrën e qytetit në një vend të vërtetë argëtimi.

#### **P08220.O3.A30** Festa e Muzikës.

Aktiviteti kulturor “Festa e Muzikës” solli në Shkodër spektaklin “Maratona e Këngës”, e cila u zhvillua në sheshin “Nënë Tereza” në datën 12 gusht 2019.

Organizatorët e këtij koncerti festiv veror ishin Bashkia Shkodër dhe Shoqata Artistike “PROMOTOR” e mbështetur nga Televizioni Kombëtar “Klan”.

Në këtë koncert morën pjesë shumë këngëtarë e grupe muzikore, të përzgjedhur si më të mirët nga e gjithë shqipëria, si më poshtë:

Eranda Libohova, Irma Libohova, Eli Fara, Shkodran Tolaj, Rovena Stefa , Magic 4, Lorenc Hasrama, Rovena Ibrahim, Erik Lloshi , Klajdi Musabelliu, Era Rusi, Revolt klan, Bujar Qamili, Mateus Frroku, Mukades Çanga etj.

#### **P08220.O3.A31** Festa e trashëgimisë kulturore.

“Festa e Trashëgimisë Kulturore”, u zhvilluan në datat 2-3-4 Gusht 2019 në Theth, i titulluar nga subjekti fitues “Za Fest”.

Organizatorët e këtij aktiviteti artistik janë: Bashkia Shkodër dhe “Iceberg Communications.”

“Za Fest” ishte një kombinim i muzikës, artit pamor, aktivitetit fizik dhe natyrës së bukur të Thethit si dhe nxitje te interesit te popullsisë për të vizituar vende të reja me oferta të pasura natyrore dhe kulturore, duke shndërruar sot turizmin në një ndërsektorët kryesor të zhvillimit ekonomik në botë.

Ky aktivitet pati si qëllim promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të zonës së Thethit, produkteve autoktone vendore të zonës mbi të gjitha diversifikimin e ofertës turistike. “Zâ-Fest” konsiston në organizimin e një koncerti të madh festiv me të ftuar nga Shqipëria dhënë gjërë; Lojra popullore; Panair i produkteve vendore të zonës dhe gatimit tradicional. Shëtitje e udhëhequr në atraksionet pikës turistike të Thethit.

Me pjesëmarrjen e artistëve:

Vlashent Sata/ Arben Bajraktaraj/ Elina Duni/ Grupi “Dont listen to your Neighbors”/ Piers Faccini etj.

#### **P08220.O3.A32** Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik.

Bazuar në VKM nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 121, datë 25.02.2005, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr. 1, datë 24.05.2005 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor”: VKB nr.27, datë 01.06.2016 “Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër” ; Bashkia Shkodër ka Këshillin Artistiko Kulturor, i cili përbëhet prej 7 anëtarësh dhe merr në shqyrtim në bazë të një procedurë të parashikuar në ligj, të gjithë projektet kulturore, artistike, rinore dhe sportive të Bashkisë Shkodër. Ky këshill paguhet në bazë të ligjit me honorare për 6 mbledhje në vit.

#### **P08220.O3.A33** Lëvizja e Postribës

“Lëvizja e Postribës” e njohur si lëvizja e parë antikomuniste në Shqipëri, e ndodhur më 9 shtator 1946, ishte lëvizja e atyre që nuk besuan kurrë tek komunizmi internacionalist shqiptar. Qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm, të cilët patën vetëdijen dhe e parashikuan se komunizmi do të sillte vetëm regres në vendin tonë, u ngritën kundër forcës së madhe të diktatorit më të egër që njohu Europa. Bashkia Shkodër çdo vit organizon aktivitetin përkujtimor të kësaj ngjarje të rëndësishme.

#### **P08220.O3.A34** Ekspozita Salloni i Vjeshtës

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 25, datë 18.04.2019 “Për shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër” dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Rajonit Emilia-Romanja dhe Bashkisë Shkodër, po zbatohet Projekti DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta” CSO-LA/2017/388-138, i cili financohet nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit Programi DEAR - EuropeAid/151103/DH/ACT/Multi. Projekti drejtohet nga Rajoni Emilia-Romanja në rolin e Liderit të Projektit dhe zbatohet në 10 shtete (8 shtete anëtare të Unionit dhe 2 shtete jo anëtarë), në një partneritet prej 18 entesh publike e private të përfshira. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e të kuptuarit kritik të roleve dhe përgjegjësi të autoriteteve lokale dhe të qytetarëve në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës 2030, si dhe rëndësinë e lokalizimit të Agjendës 2030 nga bashkitë dhe autoritetet vendore në hartimin e politikave lokale.

Bashkia Shkodër, si partnere e projektit të sipërpërmendur, ka nisur zbatimin e projektit sipas planit të punës të dakordësuar me liderin e projektit dhe bazuar në buxhetin përkatës të vënë në dispozicion për këtë qëllim. Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, si fazë e parë e projektit, janë realizuar të gjithë procedurat e nevojshme administrative për nisjen e projektit. Aktivitetet kryesore të realizuara përgjatë periudhës në fjalë përfshijnë: i) realizimin e një anketim në nivel lokal, mbi opinionin publik për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës 2030, migrimin dhe rolin e pushtetit vendor për zhvillimin e qëndrueshëm, me 478 të intervistuar dhe hartimin e raportit me gjetjet dhe rezultatet e anketimit; ii) pjesëmarrje në dy takime koordinuese (Itali dhe Poloni) me të gjithë partnerët e projektit, për të prezantuar rezultatet e arritura për periudhën dhe bashkërendimin e punës në vazhdim; iii) përgatitjen e aspekteve të vizibilitetit dhe planin lokal të komunikimit për projektin, si dhe integrimin e OZHQ-ve të Agjendës 2030 në aktivitetet e ekzistuese të Bashkisë. Aktivitetet e tjera që parashikohen të zhvillohen në vazhdim përfshijnë hartimin e një plani lokal për integrimin e politikave të Agjendës 2030

në politikat lokale, si dhe implementimin e fushatës lokale të komunikimit për Agjendën 2030 dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi OZHQ-të.

**P10430.O3.A9.** "Çdo fëmijë në shkollë".

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 7522 prot., datë 12.07.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot. datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor", Bashkia Shkodër ka institucionalizuar bashkëpunimin me nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me "Observatorin e për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve", në kuadër të projektit "Çdo fëmijë në shkollë", i cili mbështetet nga UNICEF dhe ka si qëllim identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve në moshë për arsimin e detyrueshëm që janë jashtë sistemit shkollor. Në sajë të këtij projekti është mundësuar mbështetja e dy fëmijëve për regjistrimin dhe integrimin e tyre në shkollë sipas nevojave të identifikuar nga strukturat e shërbimeve sociale të bashkisë. Identifikimi dhe përzgjedhja e fëmijëve është realizuar nga Njësia e mbrojtjes së Fëmijëve në bashkëpunim me stafin e Qendrës Komunitare Multifunkionale "Për familjen" dhe ZVA Shkodër. Familja dhe fëmijët janë përfshirë edhe në shërbimet sociale integruese si klasa passhkollore, seanca këshillimi dhe prindërimi si dhe aktivitet ndërgjegjësues që ofrohen në Qendrën Komunitare Multifunkionale me qëllim fuqizimin social ekonomik dhe sigurimin e qëndrueshmërisë dhe vijueshmërinë e fëmijëve në sistemin shkollor. Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.49 datë 24.06.2019, "Për Shtesë Plani në Buxhetin e Bashkisë Shkodër në shumën 88,000", të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, nr. Prot. 5750 datë 08.04.2019; dhe Urdhërit të brendshëm nr. 682 datë 7.8.2019 "Për ngritjen e Grupit të Punës për përzgjedhjen e 2 fëmijëve jashtë sistemit arsimor, për vitin shkollor 2019-2020", nga grupi i punës është realizuar identifikimi dhe përzgjedhja e fëmijëve përfitues. Mbështetja e dhënë konsiston në: Shpenzime për shërbime mbështetëse (veshmbathje, ushqime, materiale didaktike) për këto dy fëmijë për vitet 2019 – 2020.

**P10430.O4.A1** Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE "Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale" janë realizuar ndërhyrjet e planifikuara me qëllim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë komunitet. Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE "Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale" ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunkionale, për komunitetin rom dhe egjiptian. Qendra e re multifunkionale për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri i përfituesve të shërbimeve 270. 39 persona kanë marrë shërbim me nevoja administrative, 39 kanë marrë shërbim mjekësorë (26 rimbursim medikamentesh, 1 ndërhyrje kirurgjikale, 10 vizita të përgjithshme, 2 analiza gjaku komplet), 53 fëmijë janë pajisur me kartela personale vaksinimi, 40 persona me vaksina në qendër dhe pajisje me kartela vaksinimi, 1 mbështetje me minibiznes, 30 fëmijë mbështetje në qendër me vakt ushqimor, klasa passhkollore, këshillime dhe lojëra. 30 familje mbështeten çdo muaj me pako ushqimore.

Aktualisht ka përfunduar punimet ndërhyrja e tretë infrastrukturore, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE; rikonstruksioni i kopshtit "Guerrile".

**P10430.O4.A2** Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmoshave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Bashkia e Shkodrës në vitin 2017 ka aplikuar, fituar dhe zbatuar projektin për ristrukturimin e godinës së ish konviktit të shkollës pyjore, pranë MZHU, me qëllim strehimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira banimi për jetimët e dalë nga strukturat rezidenciale dhe që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme të qytetit. Aktualisht janë të gatshme 26 apartamente sociale për strehimin e jetimëve dhe grave kryefamiljare. Gjithashtu, në ndihmë të kësaj shtrese është dhënë shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale, me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.

**P10430.O4.A3** . Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ.

Autizmi është një sëmundje e cila karakterizohet nga çrregullime të marrëdhënieve sociale, të komunikimit dhe sjellje e lëvizje stereotipike. Autizmi është një sëmundje e cila po përhapet në mënyrë të shpejtë duke u shndërruar në një sfidë për shëndetin publik në mbarë botën për shkak të kostove shoqërore dhe ekonomike. Njohuritë për autizmin në shërbimin shëndetësor e më tepër në popullatën shqiptare janë shumë të pakta dhe nuk është e qartë se rritja e rasteve është rezultat i shtimit real të rasteve apo diagnostikimit më të mirë. Në Shqipëri shifrat janë në rritje, por nuk ka të dhëna të sakta. Specialistët e shëndetësisë bëjnë thirrje për sensibilizimin e opinionit publik për diagnostikimin e hershëm, përkrahjen ndaj fëmijëve autikë dhe integrimin e tyre në shoqëri. Aktualisht në Shkodër nuk kemi një shërbim të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm që të mundësojë mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve integruese në moshë sa më të hershme në shërbimet edukuese parashkollore dhe shkollore. Për këtë arsye janë vlerësuar ambjentet e mundshme për përshtatjen dhe ngritjen e shërbimit integrues për Fëmijët me Autizëm e cila do të ofrojë shërbime informuese, rehabilituese me synim integrimin e tyre në kopësht dhe në shkollë si moshatarët e tyre. Ka përfunduar faza e parë e punimeve për përshtatjen e ambjenteve fizike për ofrimin e shërbimeve.

Gjatë vitit 2019, Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës” në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nëpërmjet këtij projekti synohet të financohet nisja e ofrimit të shërbimeve dhe vënia në funksion e ambienteve të rikonstruara.

**P10430.O4.A4.** Plani i zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian.

Në zbatim të planit të zhvillimit janë realizuar dhe ofrohen shërbimet në mbështetje dhe fuqizim të komunitetit rom dhe egjiptian. Njëkohësisht është punuar për hartimin e raportit të parë mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Zhvillimit të Komunitetit (PZHK) Rom dhe Egjiptian të Bashkisë së Shkodrës për periudhën 2017-2020. Raporti ofron një analizë të evidencave ekzistuese në lidhje me ndryshimet në jetët e anëtarëve të dy komuniteteve, rom dhe egjiptianë, sipas gjashtë fushave prioritare të planit të veprimit, përkatësisht: regjistrimi civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë; arsimit dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; punësimi dhe arsimit dhe formimi profesional; kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimin urban; si dhe mbrojtja sociale. Duke marrë në konsideratë që monitorimi ndihmon aktorët vendor për të bërë ndryshimet e nevojshme në PZHK, ai ndër të tjera synon të ofrojë edhe rekomandimet e nevojshme për adresimin e sfidave dhe problemeve të identifikuar. Aktualisht 65 fëmijë rom janë të përfshirë në

klasa përforcuese, ndërsa 55 të tjerë të cilët janë më të rritur se mosha shkollore, janë përfshirë në arsim të pjesshëm dhe asistohen në Qendrën Komunitare multifunkionale ‘Për Familjen dhe Qendrën Komunitare “Për familjen” nr 5.

Gjithashtu në Qendrën Multifunkionale zhvillohen klasa përgatitore për 15 fëmijë të kopshteve për vitin shkollor 2018 – 2019, 60 fëmijë klasa passhkollore dhe klasa prindërimi ku përfitojnë 22 prindër rom dhe këshillime psikologjike për 56 fëmijë romë dhe secili prej fëmijëve përfitues kanë dosjet përkatëse të këshillimeve. Ndërsa klasat e analfabetizmit janë frekuentuar nga 9 të rritur romë. Gjithashtu, në qendrat komunitare po planifikohet të ofrohen klasa leximi për nënat rome.

#### **P10430.O5.A1.** Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare “Për Familjen”.

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 12 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare “Për Familjen”, janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Gjatë vitit 2019, në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, është arritur inagurimi dhe vënia në funksion e qendrës komunitare “Për Familjen” në njësinë administrative Rrethina, Shtoj i Vjetër. Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

#### **P10430.O5.A2.** Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.

Mbështetja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim; si dhe të drejtën për të jetuar e rritur në një ambjent familjar, qoftë ky familja biologjike apo familje alternative është një nga prioritetet që Bashkia Shkodër ka ndërmarrë duke bashkëpunuar edhe me organizata jo qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre janë sfida për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë këtij viti, janë identifikuar familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve të mundshme që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim, deinstitutionalizimin e tyre. Sa i përket shërbimit të kujdestarisë familjare, janë organizuar 5 takime informuese dhe ndërjegjësuere me komunitetin, mbi shërbimin e kujdestarisë familjare, ku janë shpërndarë materialet promociionale të përgatitura posacërisht për këtë shërbim. Gjithashtu kemi 12 familje kujdestare me lidhje gjaku, nga ku janë 5 fëmijë të deinstitutionalizuar, të marrë në kujdestari nga familjarët.

#### **P10430.O5.A3.** Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.

Me synim ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, Bashkia e Shkodrës po implementon shërbimet alternative të kujdestarisë për fëmijët pa përkujdes prindëror; shërbimin e kujdestarisë familjare me lidhje gjaku, shërbimin e kujdestarisë familjare pa lidhje gjaku dhe ofrimin e shërbimeve në shtëpi – familje. Ndërsa me synim parandalimin e institucionalizimit, po koordinohen shërbimet në territor për fuqizimin e familjeve në vështirësi socio-ekonomike, me krijimin e

qendra komunitare “Për Familjen”. Përveç kësaj, për të rinjtë të cilët tashmë kanë dalë nga strukturat rezidenciale janë planifikuar shërbime për mbështetjen e fuqizimin e tyre përmes përfshirjes në kurse profesionale me synim arritjen e autonomisë për kujdesin personal social, ekonomik, etj. Gjatë vitit 2019 ka përfunduar dhe pritet të vihet në funksion modeli i ri i Komunitetit Edukativ të së Ardhmes ose Shtëpi Familje për fëmijët pa përkujdes prindëror të Bashkisë Shkodër, si model i parë në vendin tonë i ndërtimit të shtëpive familje për fëmijët pa kujdes prindëror. Kjo strukturë është ndërtuar në kuadër të zbatimit të projektit “Komuniteti i të Ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës”, AID 10950, projekt i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS), dhe që po zbatohet nga Shoqata IPSIA, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, CODE PARTNERS, SHIS, Universitetin e Bolonjës, Universitetin e Shkodrës dhe Kooperativën Lybra, në të cilin është parashikuar që të mbulohen kostot e shërbimit dhe të stafit gjatë vitit të parë.

#### **P10430.O5.A4.** Park lojrash për fëmijë në lulishtet dhe parqet e qytetit të Shkodrës

Në vazhdimësi të nevojës për krijimin e parqeve dhe këndeve të lojrave për fëmijë dhe të rinj gjatë vitit 2018 Bashkia Shkodër për herë të parë krijoi për fëmijët e qytetit të Shkodrës 2 kënde lojrash. U ndërtua dhe u vu në funksion parku i lojrave në lulishten, në sheshin “Isa Boletini” dhe parku i lojrave në lulishten qendrore të qytetit pranë shatërvanit. Duke parë numrin e fëmijëve përfitues dhe nevojën e evidentuar për shtim të këtyre këndeve edhe në hapësirat e tjera publike, për vitin 2019 u planifikuan dhe u ndërtuan kënde të rinj të lojrave si dhe u realizua mirëmbajtja e atyre të ndërtuara në 2018. Këndet e reja janë vendosur tek blloku i pallateve në Xhabije, oborri i kopshtit Beb Tusha, oborri i kopshtit pranë ish konviktit të shkollës Pyjore. Në kuadër të rritjes së aksesit, gjithëpërfshirjes së personave me aftësi ndryshe u vendosën lojra të përshtatshme për fëmijët.

#### **P10430.O6.A1** Qendra Rinore "Po të Ardhmes" (Atelie).

Gjatë vitit 2019 pranë Qendrës Rinore Atelie u realizuan këto aktivitete:

Janë zhvilluar takime me gjithë senatorët e shkollave publike të Bashkisë Shkodër. Janë zhvilluar aktivitete kinematografike duke filluar me shfaqjen e një serie filmash edukativ, dokumentarësh dhe ëorkshop për të rinjtë në video-editing. Është bashkëpunuar në organizimin e Festivalit të Shahut “Çesk Jubani” në kuadër të programit “Jeto me sportin” të Bashkisë Shkodër. Në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” zbatuar nga Fondacioni Arte dhe Gruaja të grujave në bashkëpunim me Qendrën Rinore Atelie është realizuar ëorkshop-i 3 ditor mbi “Street Art” dhe Teater Social. Është zhvilluar bootcamp “One Day Entrepreneur” mbi sipërmarrjen me të rinjtë maturan të bashkëpunim me Metropolitan Incubator. Është zhvilluar aktiviteti motivues për sipërmarrjen “Histori suksesi me Rona Nushin” në bashkëpunim me Europe House. Filloi aktiviteti sensibilizues mbi shëndetin seksual “Sexual Health Education” organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe e Shëndetit Publik. Është zhvilluar takimi bashkëbisedues me znj. Merita Çoba, në kuadër të aktiviteteve të 8 Marsit të Bashkisë Shkodër “Gra të guximshme”. Është zhvilluar trajnimi “Puna me të miturit e pashoqëruar dhe viktimat e mundshme të trafikimit” nga Terre des Hommes në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, Shkodër, Korçë dhe Fier. Është zhvilluar takimi me nxënës maturan për orientim në studime me kolegjin e Biznesit, Universitetin Evropian të Tiranës. Është zhvilluar trajnimi mbi marketing-un në bashkëpunim me ArtisanOnline. Është zhvilluar takimi mbi Emigrimin dhe pasojat e tij në komunitet në bashkëpunim me fondacionin Mary Ëard Loreto. Është realizuar në kuadër të projektit ESERE, financuar nga Be në partneritet me MMSR dhe UNDP, trajnimi “Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror: për një qasje më gjithëpërfshirëse për minoritetet Romë dhe Egjiptianë”. Janë zhvilluar takime me organizatat e shoqërisë



civile për t'u informuar mbi hapjen e thirrjeve për projekt-propozime nga Ambasada SHBA. Janë zhvilluar takime formuese mbi aplikimin për punë ose kualifikim profesional nga Zyra e Dimak në bashkëpunim me [duapunë.com](http://duapunë.com). Janë organizuar dhe zhvilluar fushatat e vullnetarizmit me studentë të universitetit Luigj Gurakuqi – 150 të rinj. Bashkëpunim për realizimin e audicioneve për kitare të festivalit “Pjetër Gaci”. Në kuadër të Java e Evropës në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër është realizuar aktiviteti “Roli i bashkive në procesin e integritimit evropian” me 70 të rinj gjimnazistë dhe nga universitetit në bashkëpunim me kryetaren Voltana Ademi. Në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Familjes” është realizuar aktiviteti kinematografik. Në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar për Rininë dhe shkollën franceze të teknologjisë dhe informacionit Epitech Balkans u realizuar ëorkshop I programimit dhe kodifikimit. U realizua trajnimi 2 ditor mbi “Manualin mbi qytetarinë aktive – Forcimi i rolit të të rinjve në procesin e përafrimit të Shqipërisë në BE” i cili u mundësua nga Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Hanns-Seidel-Stiftung. Në aktivitet ishin 30 të rinj të pranishëm. U realizua në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar me mbështetje e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer aktiviteti: “Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhjet vendore 2019”. Në aktivitet ishin 40 të rinj të pranishëm. Qendra Rinore Atelie mundësoi hapjen e ekspozitës së piktorës Sara Prenci “Pranverë Art”. Në bashkëpunim me Qendresën Qytetare dhe Olof Palmë Centër u realizua diskutim me student të unversitetit “Luigj Gurakuqi”, me temë: Pakti për universitetin: premtimet, sfidat dhe problematikat studentore. Në bashkëpunim me Dimak Albania vazhduan sesionet informuese mbi mundësitë për migrim dhe praktika profesionale në Gjermani. Në bashkëpunim me EU Policy Hub – Communicating Europe u realizuar aktiviteti “Të rinjtë për Europën”. Në aktivitet ishin të pranishëm rreth 30 të rinjë. Në bashkëpunim me Shkodra Jazz Festival pranë Qendrës rinore Atelie u realizuan sesionet Rrok Academy me Mastro Bardh Jakova dhe Markelian Kapedani dhe artistë të huaj.

**P10430.O7.A1.** “Asnjë Fëmijë Jashtë”.

“Asnjë fëmijë jashtë” është një aktivitet social-kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Ky aktivitet përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të familjeve në vështirësi të theksuara social-ekonomike, gjithashtu përfshin aktivisht PAN-të, fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijët e ngujuar, fëmijë të institucioneve rezidenciale, fëmijë në situatë rruge duke përfshirë edhe fëmijë nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Fëmijët përgatiten dhe performojnë në fusha të ndryshme artistike si; muzikë, recitim, vegla muzikore, teatër, etj duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonistët. Aktiviteti “Asnjë fëmijë jashtë”, si një aktivitet artistik e kulturor gjithëpërfshirës me pjesëmarrje aktive të fëmijëve nuk është arritur të realizohet për shkak të shkresës nr.21920 Prot., datë 02.12.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet së cilës është përcaktuar prioriteti i pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore.

**P010430.O8.A1.** Pagese PAK dhe Invaliditeti.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar; Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit” të ndryshuar. Numri i personave të trajtuar me pagesë paafësie ka qenë: në muajin Janar 4113, në Shkurt 4166, në Mars 4209, në Prill 4207, në Maj 4203, në Qërshor 4216, në Korrik 4179, në Gusht 4236, në Shtator 4247, në Tetor 4269, në Nëntor 4297, në Dhjetor 4329.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempit ka qenë: në muajin Janar 3364, në Shkurt 3370, në Mars 3376, në Prill 3366, në Maj 3360, në Qershor 3370, në Korrik 3367, në Gusht 3372, në Shtator 3376, në Tetor 3384, në Nëntor 3387, në Dhjetor 3399.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:  
PAK : Janar-Shkurt 136 200 000 Lekë, Mars-Prill 130 645 000 Lekë, Maj-Qershor 128 870 000 Lekë, Korrik-Gusht 130 500 000 Lekë, Shtator-Tetor 129 740 000 Lekë, Nëntor-Dhjetor 62 310 000 Lekë. Nga të cilat për vitin 2019 janë realizuar: 718 254 601 Lekë.

Duhet të theksojmë faktin se detyrimi i papaguar në muajin Dhjetor 2019 për mungesë fondi, në vlerën 62 692 114 Lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2020.

#### **P10430.O8.A2. Ndhimja ekonomike.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 597, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfuturit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Përfutues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin janar 2117 familje, nga të cilat: 1881 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 236 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin shkurt 2079 familje, nga të cilat: 1847 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 232 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars 2103 familje, nga të cilat: 1870 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 233 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill 2114 familje, nga të cilat: 1880 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 234 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Maj 2114 familje, nga të cilat: 1881 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 233 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Qershor 2074 familje, nga të cilat: 1849 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 225 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Korrik 2018 familje, nga të cilat: 1799 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 219 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Gusht 1972 familje, nga të cilat: 1758 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 214 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shtator 1980 familje, nga të cilat: 1759 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 221 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Tetor 1896 familje, nga të cilat: 1686 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 210 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Nëntor 1877 familje, nga të cilat: 1672 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Dhjetor 1872 familje, nga të cilat: 1664 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 208 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:  
Ndhimja Ekonomike: Janar – Shkurt 35 400 000 Lekë, Mars-Prill 19 883 000 Lekë, Maj-Qershor 20 410 000 Lekë, Korrik – Gusht 21 340 000 Lekë, Shtator – Tetor 20 830 000 Lekë, Nëntor – Dhjetor 4 740 000 Lekë. Nga të cilat janë realizuar: 121 316 870 Lekë ( nga kjo 877 640 Lekë detyrim i muajit dhjetor 2018 i papaguar për mungesë fondesh).

### **P10430.09.A1. Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.**

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 5 çerdhe. Numri i foshnjeve që frekuentojnë këto çerdhe është 172.

#### **1. “Shpenzime për paga e sigurime“**

Fondi i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve në paga është 26.116 mijë lekë dhe realizimi i 12 mujorit paraqitet në vlerën 23.947 mijë lekë dhe fondi i planifikuar për sigurime shoqërore është 4.395 mijë lekë dhe realizimi paraqitet në vlerën 4.022 mijë lekë.

#### **2. “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera“**

Fondi i planifikuar për këtë zë është 9.541 mijë lekë dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet me vlerën 7.459 mijë lekë.

Në zërin **“Materiale zyre dhe të përgjithshme“** Fondi i planifikuar është 85 mijë lekë, për blerje kancelarie është realizuar dhe likuiduar në vlerën 84 mijë lekë.

Në zërin **“Materiale për pastrim ngrohje dhe ndriçim“** Fondi i planifikuar është 1000 mijë lekë për të blerë materiale pastrimi, gaz për ngrohje e gatim. Blerje gaz është realizuar dhe likuiduar për vlerën 351 mijë lekë.

Në zërin **“Furnizime me ushqime“** Fondi i planifikuar është 5300 mijë lekë. Për 12 mujorin është realizuar në vlerën 3.518 mijë lekë , likuidimi çdo muaj, është bërë dhe amendamet për zgjatje të kontratës deri me 31.03.2020 për vlerën 745 mijë lekë. Në zërin **“Blerjeve të materialeve të tjera”** si batanije, dyshek etj, fondi i planifikuar është 150 mijë lekë. Është realizuar dhe likuiduar në vlerën 130 mijë lekë.

Në zërin **“Shërbime nga të tretë“** fondi i parashikuar është 1846 mijë lekë. Kjo vlerë përfaqëson faturat e energjisë elektrike që janë realizuar për periudhën 12 mujore në shumën prej 963 mijë lekë, faturat e konsumit të ujit në shumën prej 547 mijë lekë dhe faturat e pagesës së internetit në shumën prej 42 mijë lekë.

Në zërin **“Blerje e lëndëve djegëse”** dru zjarri fondi i parashikuar prej 300 mijë lekë është realizuar dhe likuiduar plotësisht.

Shërbimi **për dezinfektimin** e ambjenteve të Çerdheve është parashikuar në vlerën prej 40 mijë lekë. Është realizuar për vlerën 39 mijë lekë.

Në zërin **“Shpenzime Transporti“** fondi i parashikuar përfshin vlerën prej 200 mijë lekë në të cilën përfshihen shpenzimet që janë bërë për blerje karburanti. Është realizuar dhe likuiduar.

Në zërin **“Mirëmbajtje e zakonshme”** fondi i planifikuar prej 580 mijë lekë përfaqëson realizimin e Mirëmbajtjes së ndërtesave (lyerjes me bojë) me shumën prej 500 mijë lekë si dhe vlerën prej 50 mijë lekë që përfaqësojnë shpenzimet që do të bëhen për mirëmbajtjen e aparateve dhe paisjeve teknike dhe 30 mijë lekë për mirëmbajtje të paisjeve të zyrës. Lyerja me bojë është realizuar dhe likuiduar plotësisht, ndërsa mirëmbajtja e aparateve e paisjeve teknike dhe të zyrës nuk janë realizuar.

Në zërin **“Shpenzime për sigurimin e ndërtesave”** fondi i planifikuar është 40 mijë lekë. Është realizuar dhe likuiduar për vlerën 40 mijë lekë.

3. Në zërin **“Investime”** fondi i planifikuar është 400 mijë lekë. Tek kjo vlerë përfshihet shuma prej 200 mijë lekë që janë përdorur për të blerë: lavatrice, kondicionerë etj. Është realizuar dhe likuiduar për vlerën 191 mijë lekë. Ndërsa vlera prej 200 mijë lekë të tjera është parashikuar për të blerë paisje për sistemin e sigurisë, nuk është realizuar.

Aktivitete/Projekte	Buxheti fillestar në 000/Lekë	Buxheti i korigjuar në 000/Lekë	Realizimi 2019 në 000/Lekë
<b>P10430.01.A1</b> Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.	100	100	90
<b>P10430.02.A1.</b> Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.	300	300	293
<b>P10430.02.A2.</b> Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	50	50	43
<b>P10430.02.A3.</b> Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë			Realizuar
<b>P10430.02.A4.</b> Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	200	200	172
<b>P10430.03.A1.</b> Tryeza 260erformances me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;			Realizuar
<b>P10430.03.A2.</b> Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	50	50	46
<b>P10430.03.A3.</b> Dita ndërkombëtare e fëmijëve, “1 Qeshori”			Realizuar
<b>P10430.03.A4.</b> Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	167	167	140
<b>P10430.03.A5.</b> Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.			Realizuar
<b>P10430.03.A6.</b> Bashkëpunimi me organizatën “Sos, Fshatrat e Fëmijëve.”			Realizuar
<b>P10430.03.A8.</b> DEAR EuropeAid/151103/DH/ACT/Multi “Modelimi I qyteteve te drejta.”	-	4,758	1,592
<b>P10430.03.A9.</b> “Çdo fëmije në shkollë”		40	40
<b>P10430.04.A1</b> Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian			Realizuar
<b>P10430.04.A2</b> Shpërblim për jetimët me rastin e 260erform të fundvitit	400	400	400

<b>P10430.O4.A3.</b> Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ			Realizuar
<b>P10430.O4.A4.</b> Plani I zhvillimit 261lokal për komunitetin rom dhe egjiptian	100	100	87
<b>P10430.O5.A1.</b> Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare “Për Familjen”	10,889	11,767	8,023
<b>P10430.O5.A2.</b> Shërbime alternative për fëmijet dhe familjen.	100	100	91
<b>P10430.O5.A3.</b> Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.			Realizuar
<b>P10430.O5.A4.</b> Park lojrash për fëmijë në lulishtet dhe parqet e qytetit të Shkodrës		1,600	1,582
<b>P10430.O6.A1</b> Qendra Rinore “Po të Ardhmes” (Atelie)		1,001	1,001
<b>P10430.O7. A1.</b> “Asnjë Fëmijë Jashtë”	266	266	Nuk është realizuar
<b>P10430.O8.A1.</b> Pagesë PAK dhe Invaliditeti .	800,000	718,265	718,255
<b>P10430.O8.A2.</b> Ndihma ekonomike	210,000	122,603	121,317
<b>P10430.O9.A1.</b> Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.	40736	40736	35842
A.3.1 Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	30511	30511	27968
A.3.2 Kancelari	85	85	84
A.3.3 Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	1000	1000	351
A.3.4 Furnizime me ushqime	5300	5300	4263
A.3.5 Materiale të tjera	150	150	130
A.3.6 Energji elektrike	1030	1030	963
A.3.7 Uji	770	770	547
A.3.8 Internet	46	46	42
A.3.9 Lëndë djegëse (dru zjarri)	300	300	300
A.3.10 Shërbime të tjera për dezinfektim	40	40	39
A.3.11 Shpenzime transporti	200	200	200



A.3.12 Mirëmbajtje e zakonshme (ndërtesa)	500	500	500
A.3.13 Mirëmbajtje e aparateve e paisjeve teknike	50	50	Nuk eshte realizuar
A.3.14 Mirëmbajtje të paisjeve të zyrës	30	30	Nuk eshte realizuar
A.3.15 Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	40	40	40
A.3.16 Transferta buxhetore për individë	284	284	224
A.3.17 Blerje paisje dhe orendi	200	200	191
A.3.18 Blerje paisje për sistemin e sigurimit	200	200	Nuk eshte realizuar

## Programi 10661 - Strehimi social

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “Strehimi social”.

- Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2019 kanë qenë:

- O1.Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.
- O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përbalueshëm dhe të përshtatshëm

Rezultatet e programit: të “Strehimi social”.

Programi	Paga	+ Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
10661	Sigurime	Operative			
<b>Plani fillestar</b>					
<b>2019</b>	-	1000	600	14,462	<b>16,062</b>
<b>Plani i rishikuar</b>					
<b>2019</b>	-	1000	600	22,267	<b>23,867</b>
<b>Realizimi i vitit</b>					
<b>2019</b>	-	513	-	22,265	<b>22,778</b>

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program duke e krahasuar me planifikimin është 95.44 % .

### Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

- Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 22/2018 “Për strehimin social”, dhe së fundmi me miratimin e akteve nënligjore, Bashkia Shkodër ka qënë në proces të hartimit të projekt vendimeve në përputhje me ndryshimet ligjore dhe paraqitjen për miratim në Këshill Bashkiak, për t`i hapur rrugë zbatimit të programeve sociale të strehimit.
- Për projektin Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr 6. Nuk është miratuar ndryshimi i destinacionit të godinës nga Këshilli i Ministrave. Meqënëse për shkak të mosmiratimit të sistemeve të pikëzimit nuk është realizuar përzgjedhja e përfituesve në këtë projekt në zbatim të ligjit të ri të strehimit, marrëveshja do i delegohet për zbatim Ministrisë së Linjës.

Realizimi i treguesve të performancës.

Kodi i Programit	10661	Emertimi i programit:	Strehimi social					
Qellimi 1	Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.							
		<b>**Treguesit e 264performances/Produktet:</b>						
<b>*Objektivat e politikës*:</b>		<b>Kodi i Treguesit te Performances/Produktit</b>	<b>Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit</b>	<b>Niveli faktik i vitit paraardhes</b>	<b>Niveli i planifikuar ne vitin korent</b>	<b>Niveli i rishikuar ne vitin korent</b>	<b>Niveli faktik ne fund te vitit korent</b>	<b>% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit</b>
<i>Objektivi Specifik 1</i>	<b>O1.Permiresimi i kushteve te banimit per shtresat në nevoje</b>							
		1	Nr. I banorëve përfitues;	3,000	3,000	3,000	3,000	100%
		2	Nr. I familjeve përfituese;	673	673	673	673	100%
		3	Numri I apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje;	26	26	26	26	100%
		4	Nr. I aplikimeve pranë Bashkisë për strehim social	2,006	100	100	38	38%
		5	Nr I aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	1	3	3	1	33%
		6	Nr i banesave ne rrezik shembje	0	20	20	25	125%
		7	Nr I familjeve perfituese	0	0	33	0	0%
		8	Nr I banoreve perfitues	0	0	142	0	0%



**Realizimi i produkteve:**

**ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"**

<b>Emri i Grupit</b>	Bashkia Shkoder	<b>Kodi i Grupit</b>	141
<b>Programi</b>	Strehimi Social	<b>Kodi i Programit</b>	10661

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia mates e	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	Luhatjet ne Koston per Njesi		
															V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
1	Nr. I banorëve përfitues;	Nr. Banoreve	3000	7933	3	3000	14462	5	3000	7289	2	3000	7287.259	2	0	-2	0
2	Nr. I familjeve përfituese;	Nr. Familjeve	673		0	673		0	673		0	673		0	0	0	0
3	Numri I apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrrahje;	Nr. Apartamente sh	26		0	26		0	26		0	26		0	0	0	0
4	Nr. I aplikimeve pranë Bashkisë për strehim social	Nr. Aplikimeve	2006	600	0	100	600	6	100	600	6	38		0	0	-6	-6
5	Nr I aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	Nr. Aplikimeve	1		0	3		0	3		0	1		0	0	0	0

6	Nr i banesave ne rrezik shembje	Nr. Banesash			#DIV/0!	20		0	20		0	25		0	#DIV/0!	0	0
7	Nr I banesave	Nr banesash			#DIV/0!			#DIV/0!	26	14978	576		14978	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
8	Nr I familjeve perfituese	Nr. Familjeve			#DIV/0!			#DIV/0!	33		0			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
9	Nr I banoreve perfitues	Nr. Banoreve			#DIV/0!			#DIV/0!	142		0			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!

Për vitin 2019 në Programin “**Strehimi social**”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara , janë parashikuar këto aktivitete.

**P10661.O1.A1** Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen".

Meqënëse për shkak të mosmiratimit të sistemeve të pikëzimit nuk është realizuar përzgjedhja e përfituesve në këtë projekt në zbatim të ligjit të ri të strehimit, marrëveshja do i delegohet për zbatim Ministrisë së Linjës. Sfida kryesore për këtë projekt mbetet zbatimi i marrëveshjes dhe përzgjedhja e përfituesve, që meqënëse nuk ka gjetur miratim në këshill bashkiak sipas ligjit të strehimit ti delegohet për zbatim ministrisë së linjës.

**P10661.O1.A2** Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara Bashkia Shkodër. Përmirësim I shërbimeve bazë (Ndertim rrjeti I ujit të pijshëm) .

Përmes ketij projekti është realizuar rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm, të zonës informale “Mar Lula”. Kjo zonë ndodhet në periferi të Shkodrës dhe projekti hap rrugën për procesin e formalizimit të kësaj zone me pjesët e tjera të qytetit. Projekti ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të zonës “Mar Lula” ka një vlerë totale prej 26.444.299 lekë. Kontribut i Bashkisë Shkodër është 4,048,800 lekë, kontribut për punimet e gërmimit. Nga ky projekt përfitojnë 3000 banorë të lagjes dhe rreth 100 banorë të komunitetit romë që banojnë në kampin e Zallit te Kirit.

**P10661.O2.A1** Strehim social sipas programeve sociale të strehimit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 22/2018 “Për strehimin social”, dhe së fundmi me miratimin e akteve nënligjore, jemi në proces të hartimit të projekt vendimeve në përputhje me ndryshimet ligjore dhe paraqitjen për miratim në Këshill Bashkiak, për t'i hapur rrugë zbatimit të programeve sociale të strehimit. Janë hartuar dhe dërguar për miratim pranë këshillit bashkiak tre projekt-vendime përkatëse:

1. “Për miratimin e formularit të kërkesës për të përfituar nga programet e strehimit social”
2. “Për miratimin e ngritjes , përbërjes dhe funksionimin e komisionit të strehimit”
3. “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit për vitin 2020”.

**P10661.O2.A2** Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara. Gjatë vitit 2019 është aplikuar për projekte të strehimit dhe është fituar projekti “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Godina Sociale, Shkodër).

**P6190.O1.A3.** ( Kodi i Ministrisë) P10661.O1.A3 Rikonstruksion i godinave në pronësi të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore për strehim social, Bashkia Shkodër.

Është aplikuar pranë Ministrisë së Financave Projekti “Godina Sociale Shkodër “ që ka synim sigurimin e kushteve të banimit për 142 Persona të komunitetit Rom që janë të regjistruar në Bashkinë Shkodër. Ky projekt është fituar dhe është në proces prokurimi referuar shkresës Nr. 610 Prot. Datë 14/01/2020.

KRYETAR  
Voltana ADEMI

Zv. Kryetar

*Arben Sauras*

Zv. Kryetar

*Felberoh Shegji*

Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor

*Ornela Hafaj*

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes se investimeve të Infrastrukturës

*Alfred Sulata*

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

*Bronilda Ueshi*

Drejtoria e Ndihtes Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe

*Aradete Ferej*

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

*Shkëlzen Haxhiu*

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP

*Alban Selço*

Drejtoria e Turizmit

*Genjiana Hoxha*

Zv. Kryetar

*Edi Hysaj*

Drejtoria e të Ardhurave

*Donat Hysaj*

Drejtoria e Financës

*Blerta Gjokaj*

Drejtoria Juridike

*Enxhet Duka*

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

*Sandra Zogaj*

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave

*Eda Sullaku*

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit të Investimeve

*Blerta Gjokaj*

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

*Edi Hysaj*

Administratori Njësia Administrative Postrribë

Altin Shabaj

Administratori Njësia Administrative Dajç

Jonas Dina Durgut

Administratori Njësia Administrative Kreshina

Abdullë Pjetri

Administratori Njësia Administrative Guri i Zi

Pjeter Marku

Administratori Njësia Administrative Pult

Jon Marku

Administratori Njësia Administrative Velipojë

Altin Koci

Administratori Njësia Administrative Bërdicë

Aleksander Peshku

Administratori Njësia Administrative Ana e Malit

Arben Cem

Administratori Njësia Administrative Shalë

Petrit Arza

Administratori Njësia Administrative Shosh

Idoc Ashta

[Signature]